



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 DHE 6 MAJ 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 05. I 06. MAJA 2014. GODINE**

**MAJ - MAJ
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2013 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,
10. Shqyrtimi i raportit të Zyrës Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2013,
11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013,
12. Emërimi i një anëtari në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës dhe
14. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Izjašnjavanja van dnevnog reda,
2. Poslanička parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prošle plenarne sednice,
4. Usvajanje amandmana na Ustav Republike Kosova, predloženih od Vlade Republike Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o kontroli duvana,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o antidamping i ontibalansirajućih mera,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o državnim penzijskim šemama,
8. Razmatranje izveštaja Komisije za privredni razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju o praćenju sprovođenja Zakona o civilnom vazduhoplovstvu,
9. Razmatranje godišnjeg izveštaja (2013), Agencije za upravljanje kosovskih memorijalnih kompleksa,
10. Razmatranje Izveštaja Kancelarije regulatora za vode i otpatke za 2013. godinu,
11. Razmatranje Izveštaja Državne agencije za zaštitu ličnih podataka za 2013. godinu,
12. Imenovanje jednog člana u Upravnom bordu Fonda penzijskih štednji Kosova,
13. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama zakona u vezi oružanih snaga Kosova, i
14. Formiranje ad hoc komisije za izbor članova Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupeve parlamentare pesë minuta, në emër të deputetëve tre minuta.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Më 2 maj, ditën e premte, siç e dimë, janë përmbyllur negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian pas gjashtë muajve negociatash të nivelit politik, por edhe të nivelit të ekspertëve, të cilët kanë qenë pjesë e këtyre negociatave.

Ashtu siç edhe është paralajmëruar më herët, këto negociata janë përmbyllur në pranverë, duke e krijuar kështu një rol të rëndësishëm për të ardhmen evropiane të vendit, si dhe pozicion të mirë të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Siç është deklaruar edhe në nisje të negociatave, marrëveshja përbën hapin e parë apo bashkëpunimin e parë kontraktual ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Si pikë tejet e rëndësishme e kësaj marrëveshje është fakti se do të promovohen interesat e ndërmarrësisë së Kosovës për arsye se Bashkimi Evropian menjëherë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit do ta hapë tregun e vet për produktet bujqësore dhe industriale dhe do të ofrojë kështu potencial për zhvillim ekonomik, si dhe për stimulimin dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e vendos Kosovën në pozicionin zyrtar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke e trajtuar kështu të barabartë, në bazë të njëjtë me të gjitha vendet e rajonit.

Në përmbyllje të negociatave, Kosova hyn në një proces të ri që është më shumë procedural dhe teknik dhe që i hap rrugë agjendës evropiane të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti i Lidhjes Demokratike, Xhafer Tahiri.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam këtu sot për ta shprehur shqetësimin e shumë pjesëtarëve të Shërbimit Civil të Kosovës, por edhe të anëtarëve të Administratës Shtetërore dhe shërbyesve të tjerë publik në këtë vend, të cilët që nga momenti kur kryeministri e ka filluar fushatën e pashpallur elektorale po u nënshtrohen një presioni të hatashëm nga titullarët e institucioneve, që nga ministrat e kryetarët e komunave, udhëheqësit e agjencive të pavarura e drejtorët e shkollave, që të krijojnë celula mbështetëse, qoftë për deputetët, qoftë për ministrat e kësaj mazhorance në ikje për të siguruar mbështetje dhe vota për ta, duke e shfrytëzuar autoritetin e tyre publik në mënyrë të kundërligjshme.

Dua t'ia rikujtoj kryeministrit të vendit, ministrave, kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të agjencive, por edhe titullarëve të tjerë publikë se shërbyesit civilë të Republikës së Kosovës janë të pavarur, po ashtu edhe pjesëtarët e Administratës Shtetërore Publike, arsimtarët dhe të gjithë shërbyesit e tjerë publikë në këtë vend janë të pavarur dhe nuk duhet t'i nënshtrohen këtij lloji presioni të paligjshëm, të padrejtë, sepse ata kanë parë punën tuaj, ata tashmë kanë vendosur dhe nuk duhet që vendi i tyre i punës të kërcënohet në asnjë mënyrë, ashtu siç janë duke bërë tani për të përfituar mbështetje, apo për të krijuar mbështetje për vete në zgjedhjet parlamentare, të cilat po vijnë.

Si deputet, personalisht kam marrë ankesa të tilla në Vushtrri dhe në shumë qytete të tjera nga qytetarë të ndryshëm, të cilët praktikisht janë duke iu nënshtuar këtij presioni.

Prandaj, unë dua t'i bëj thirrje kryeministrit, ministrave dhe titullarëve të tjerë publikë që të heqin dorë nga ky presion dhe dua t'i siguroj të gjithë këta qytetarë se Lidhja Demokratike e Kosovës do të rivendosë ligjshmëri dhe çdo kush që kërcënohet me vend të punës duhet ta paraqesë atë publikisht, sepse si Grup Parlamentar i LDK-së, si deputetë, do të angazhohemi që vendi i tyre i punës të jetë i garantuar, pavarësisht bindjeve të tyre politike. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Para 24 vjetësh, më 27 shkurt të vitit 1990, regjimi i Milosheviqit i largoi nga puna 912 punëtorë të Fabrikës së Gypave me arsyetimin se nuk kishin punuar 5 ditë me radhë. E vërteta është që ata shkuan në punë, por nuk i lejuan të hyjnë brenda. Punëtorët bënë ankesë në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, por nuk morën kurrë asnjë përgjigje.

Pas luftës ata e hodhën në gjyq menaxhmentin e fabrikës dhe kërkuan dëmshpërblim për rrogat që nuk i kishin marrë. Të gjitha instancat gjyqësore në Kosovë, deri te Gjykata Kushtetuese, e quajtën kërkesën e tyre të drejtë.

Gjykata Kushtetuese ka kërkuar dy herë nga Qeveria dhe AKP-ja dhe tri herë nga ky Kuvend i Kosovës që ky vendim të ekzekutohet. Herën e fundit me kërkesën e kryeministrit të Kosovës.

Me gjithë faktin që afati për ekzekutimin e vendimit ka kaluar më 19 prill 2014, punëtorët e Fabrikës së Gypave nuk i kanë marrë paratë e tyre.

Kjo Qeveri nuk do ta ekzekutojë kurrë këtë vendim, sepse është pjesë e lojës, pjesë e mashtrimit dhe pjesë e krimit të organizuar ekonomik, së bashku me AKP-në. Këtë e tregon më së miri loja e pingpongut ndërmjet Qeverisë dhe AKP-së me punëtorët e Fabrikës së Gypave, ku këta të fundit, në cilësinë e topit, goditen herë nga njëra anë, herë nga ana tjetër, e herë nga të dyja anët bashkërisht.

Kryeministri i Kosovës, në bisedimet me Serbinë, do të duhej ta kishte marrë qysh në fillim të bisedimeve llogarinë e punëtorëve të Fabrikës së Gypave dhe t’ia dorëzonte atë delegacionit serb për ta kompensuar dëmin e shkaktuar. Edhe punëtorët tjerë të Kosovës, të larguar padrejtësisht nga puna, do të duhej të kompensoheshin në të njëjtën mënyrë si punëtorët e Fabrikës së Gypave për shkak se u larguan nga puna për të njëjtat arsye dhe për të njëjtin qëllim.

Por, kryeministri dhe Qeveria e Kosovës nuk e kishin dhe nuk e kanë hallin e punëtorëve. Jo më larg se para dy muajsh, 46 punëtorë të Aeroportit “Adem Jashari” u larguan padrejtësisht nga puna nga kompania “Limak”, midis tyre punëtorë që punojnë aty për 14 vjet me radhë, madje edhe gra shtatzëna dhe në pushim të lehonisë. Largimi i tyre nga puna u bë në kundërshtim me nenet 49, 53 dhe 71 të Ligjit të punës.

Pas reagimeve të punëtorëve, medieve, të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe inspektorëve të punës, 18 prej tyre janë kthyer në punë, ndërsa pjesa tjetër prej 28 punëtorëve vazhdon të mbetet e papunë.

Nuk e di cili është kuptimi i propagandës për vendet e reja të punës, kur Qeveria dhe kryeministri edhe vendet ekzistuese po lejojnë të humbin.

Qëndrimi i Qeverisë karshi largimit të punëtorëve nga vendet e tyre të punës, në një ndërmarrje në të cilën Qeveria ka 25 % të fitimit, është një fakt më shumë që tregon se kjo Qeveri nuk e ka pasur kurrë dhe nuk e ka hallin e punëtorëve.

Kosova, nën drejtimin e kësaj Qeverie, është kthyer në një zonë të lirë nga ligji. Vendi është kthyer në një anarki totale. Qeveria nuk i respekton vendimet e Parlamentit, agjencitë nuk i ekzekutojnë vendimet e Qeverisë. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk vlejnë për Qeverinë dhe për organet tjera të vendit, ndërsa ministrinë e pengojnë punën e agjencive.

Prandaj, kjo Qeveri duhet të bjerë, jo nëpërmjet shpërbërjes së Parlamentit, por nëpërmjet rrëzimit të saj. Ky është ndëshkimi më i vogël që mund t'i bëhet një qeverie që e ka sjellë vendin buzë shkatërrimit.

Kryeministri deklaroi dje në Gjilan se, “Kosova nuk mund të qeveriset nga njerëzit që nuk i do Brukseli dhe Uashingtoni”.

Brukseli e Uashingtoni janë vende të mira për azil politik. Ju preferoj që kur të shkoni atje t'i respektoni ligjet e vendit sepse përfundoni në burg. E atje në burgje spitalet janë brenda tyre, e jo jashtë tyre.

Vendi ynë ka nevojë të qeveriset nga gra dhe burra që i do Kosova dhe që ndërtojnë marrëdhënie të mira dhe të shëndosha me Brukselin dhe Uashingtonin, por jo për hyzmeqarë. Këtë e vërteton më së miri praktika e atyre që i deshën në Stamboll dhe në Beograd.

KRYETARI: Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të premten e kaluar, tek po vija nga Gjakova në Prishtinë, pata fatin të takohem rastësisht me “Shtegtarët e Lirisë”, të cilët disa ditë më parë u nisën nga qyteti i Gjilanit në marshin e tyre drejt Brukselit, në udhëtimin që pritet të zgjasë 78 ditë nën moton ‘Pesë milionë hapa të vegjël për një hap të madh’, për të përçuar mesazhin e lëvizjes së lirë të Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Të gjithë jemi dëshmitarë që grupi prej pesë qytetarësh, i njohur i “Shtegtarët e Lirisë” për të përçuar mesazhin për lëvizje të lirë u sulmua në Graçanicë nga një grup huliganësh serbë, duke pësuar edhe lëndime trupore në dorë nga arma e ftohtë thikë, si dhe duke pësuar lëndime trupore, pasi janë grushtuar e shqelmuar nga turma serbe.

Gjatë takimit tonë të shkurtër, por shumë të përzemërt, të lënduarve u vëreheshin plagë në kokë, në dorë e në fytyrë.

Jahi Mustafa, njëri nga “Shtegtarët e Lirisë”, thotë se vetëm dorëza e ombrellës që e kishte me vete e kishte shpëtuar nga më e keqja, pra nga sulmi me thikë. Nërehej se ombrella ishte e këputur nga thika.

Lëndime gjithashtu kishte pësuar edhe Ekrem Avdiu, pasi ishte goditur me grushte e shqelma, duke e rrëzuar për tokë, ndërsa lëndime ka marrë në dorë nga arma e ftohtë thikë Nazim Ajdini.

Shqetësuese për mua është fakti se “shtegtarët” u sulmuan në përcjellje të Policisë, të cilët, sipas tyre, edhe i kishin ironizuar. Madje, siç më treguan “shtegtarët” e sulmuar, komandanti i Stacionit të Policisë në Graçanicë pas kësaj ngjarjeje ishte mjaft i disponuar.

E them me përgjegjësi të plotë se ky është rast i papranueshëm, sepse nuk ndodhi rastësisht. Ky sulm, para së gjithash, ishte i përgatitur mirë nga serbët lokalë, të cilët edhe ashtu asnjëherë nuk e pranuan shtetin e Kosovës.

Sipas zotit Ekrem Avdiu, Nazim Hajdini, Jahi Mustafa, Xhevdet Shabani dhe Liridon Basha, të cilët i takova rastësisht pra në Gjurgjicë, në autoudhën e kombit, zëvendëskryeministri Slobodan Petroviq, pas incidentit, u kishte premtuar atyre akomodim në Hotelin “Viktoria”, duke i mbuluar edhe shpenzimet. Mirëpo, ky ishte një mashtrim i zëvendëskryeministrit, i cili edhe ashtu i mashtroi dhe nuk u duk fare. Pra, të gjitha shpenzimet u desh t’i paguanin vetë.

Mirëpo, premtimi pra doli të jetë mashtrim i madh, ngase të gjitha shpenzimet ata u desh t’i paguanin nga xhepi i tyre. Vetëm një pjesë të tyre i pagoi një kamerier i hotelit.

Shtrohet pyetja se si mund t’i mashtrojë qytetarët një zëvendëskryeministër, madje pesë qytetarë që u sulmuan pa mëshirshëm nga një grup huliganësh gjatë një misioni tepër fisnik për vendin e tyre.

Qeveria e Kosovës mendoj se duhet të veprojë urgjentisht ndaj këtij akti kriminal, ndërsa autorët të nxirren para drejtësisë sa më parë që të jetë e mundur.

Organet tona kompetente e kanë shumë të lehtë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ishe në emër të grupit, apo në emrin tënd? Mirë, vazhdojmë! Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Shumë herë në Parlament kemi folur për privatizimin, për privatizimin shumë të keq, i cili i solli Kosovës papunësi, natyrisht me papunësi solli edhe varfëri; ndërrimin e destinacionit të ndërmarrjeve të privatizuara, bile-bile disa nga objektet e privatizuara tani edhe shiten për banesa dhe, siç thashë edhe më herët, meqë e solli papunësinë, solli mijëra e mijëra punëtorë të papunë, ku më vonë, për shkak të moshës 40 deri 65 vjet, nuk patën sukses të punësohen. Kjo ndodhi edhe me ndërmarrjen “Printeks” të Prizrenit, nga ku më kanë kontaktuar disa herë, sepse janë në gjendje shumë të keqe. Të njëjtit, si shumë punëtorë të tjerë të ndërmarrjeve të privatizuara, mbetën pa punë, moshë kjo e cila në shtetet tjera nuk do të kishte paraqitur problem, por te ne për shkak të mungesës së sanksionimit dhe të diskriminimit në moshë ndodh shumë shpesh.

Prandaj, unë në lidhje me këtë kategori të punëtorëve i drejtohem kryeministrit që ta trajtojë këtë çështje me urgjencë dhe jo vetëm ta trajtojë, por ta zgjidhë, sidomos në kohën e parafushatës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që në shtetet demokratike shprehja ‘sundim i ligjit’ paraqet një parim të qeverisjes, sipas të cilit të gjithë personat, institucionet dhe etnitetet, qofshin publike apo private, përfshirë edhe ato shtetërore, janë përgjegjëse dhe duhet të japin llogari konform ligjeve në fuqi.

Pra, sipas këtij parimi qeverisës, askush nuk është mbi ligjin dhe secili person është subjekt i juridiksionit, gjykatave të rregullta, pavarësisht nga pozita dhe rangimi i tij në shoqëri.

Vërtet shprehja ‘drejtësi dhe sundim i ligjit’ është një koncept që përfshin trajtimin fer, objektiv, të drejtë dhe të paanshëm të të gjithë personave. Për një trajtim të tillë shteti duhet ta ndërtojë një sistem gjyqësor profesional, efikas, të pavarur, që është i liruar nga çdo ndikim politik, material, apo nepotist. Ky është përkufizimi.

Mirëpo, në vendet me regjime jodemokratike, totalitare, që pretendojnë të shndërrohen në diktatura siç është në Kosovën e udhëhequr nga zoti Thaçi, i cili kohëve të fundit Kosovën dhe pasuritë e saj është duke i trajtuar si pronë të veten, që ia ka lënë trashëgim babai, drejtësia dhe sundimi i ligjit jo vetëm që nuk janë të pavarura dhe profesionale, por thjesht janë shndërruar në mekanizma për t’i mbrojtur interesat e Qeverisë, duke i shfrytëzuar ato për përndjekjen selektive të kundërshtarëve politikë, e në veçanti të atyre që vijnë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Se drejtësia, gjyqësori dhe policia vendore në Kosovë janë vënë në shërbim të politikës ditore, është duke përndjekur në mënyrë selektive anëtarët e LDK-së, për nevojat dhe interesat e Qeverisë Thaçi, tregon edhe rasti i fundit i javës së kaluar kur anëtarit të Kryesisë, përkatësisht kundër anëtarit të Kryesisë së LDK-së dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, zotit Naser Osmani, fillimi i hetimeve ndaj tij nuk kishte të bënte fare me drejtësi dhe sundim të ligjit, por ishte një farsë politike, spektakël i montuar, respektivisht njëherë tentim-goditje kërcënuese e kësaj Qeverie ndaj LDK-së dhe anëtarëve të anëtarëve të saj, e që fatkeqësisht po kryhen nga organet që në Kosovë duhet ta ndajnë drejtësinë për të gjithë personat.

Po jua rikujtoj se prej 6 anëtarëve të Bordit në AKP, që votuan pro një vendimi, kinse të kundërligjshëm, u seleksionuan dhe u morën dy dhe njëri nga ata, një zyrtar i lartë i LDK-së dhe deputet i këtij Kuvendi. Po ky është turp! Turp për arsyen e thjeshtë se është proces që shihet i motivuar qartë, me ndikime politike me qëllim të cenimit të imazhit të LDK-së dhe anëtarëve të saj në prag të zgjedhjeve nacionale të këtij viti.

Konkretisht, as prokurori e as Policia fare nuk e kanë ftuar e as njoftuar zotin Osmani për ta intervistuar lidhur me vendimin e ashtuquajtur kontestues, për votimin që është e drejtë e tij “për” apo “kundër” gjatë marrjes së këtij vendimi në AKP. Thjesht, kjo ka ndodhur para se ky të njoftohet, të dalë në media dhe të shndërrohet në një spektakël, por që ka

konsekuenca të caktuara. Urdhër-arrestin e tij më parë e kanë marrë vesh mediet se sa vetë zoti Osmani, një deputet i Parlamentit dhe ky është turpi i radhës.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto zhvillime, shkelje dhe inskenime gjatë këtij procesi shumë të qartë me ndikime politike ndaj deputetit dhe anëtarit tonë të Kryesisë, Grupi ynë Parlamentar kërkon nga kryeministri dhe Qeveria e Kosovës që të heqin dorë nga ndikimi politik ndaj organeve të drejtësisë në Kosovë, që të mos i përdorë këto metoda dhe këto forma për nevoja dhe qëllime politike ditore të partisë. Njëherësh nga organet e hetuesisë dhe të drejtësisë të Kosovës, Policia e Kosovës, Prokuroria i Shtetit, ne si grup parlamentar kërkojmë që të mos veprohet sipas kërkesave dhe nevojave për qëllime të pastra politike dhe partiake.

Ne e bëjmë këtë reagim si përpjekje jona dhe si obligim yni që të alarmojmë për gjendjen aktuale në sistemin tonë të drejtësisë. Pra, apeli ynë është që të ndërpriten ndërhyrjet dhe ndikimet politike në punën e organeve të drejtësisë, që çdokush ta bëjë punën e vet. Ne kemi qenë dhe jemi për sundim të ligjit, për hetime të pavarura dhe profesionale, por jo për hetime të tilla selektive, tentim-denigruese ndaj fytyrave dhe figurave politike, siç ka qenë rasti konkret ndaj zotit Osmani dhe Policia të mos e bëjë punën e gjyqësisë, por ajo dhe organet e hetuesisë punën e vet, e gjyqësia punën e saj.

Këtu ka ndodhur e kundërta dhe kjo lidhje nuk ka me sundim të ligjit. Ky është turp për atë se si funksionojnë organet e drejtësisë te ne. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Valbonë Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja të cilën dua ta ngre sot është vërtet shqetësuese. Siç edhe jeni në dijeni, Ligji i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nuk kaloi në seancën e kaluar, në mungesë të kuorumit. Kështu duket në shikim të parë, mirëpo prapa kësaj qëndrojnë marrëveshjet dhe manipulimet e Auditorit të Përgjithshëm, zotit Lage Olofsson, i cili ka bërë me disa deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe duke i vënë në lajthitje edhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian se kinse ne po e rrezikojmë pavarësinë e Zyrës së Auditorit Gjeneral.

Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve dhe manipulimeve, ai këmbëngul t'i realizojë shkeljet që është duke i bërë në vazhdimësi. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është organ kushtetues dhe e ka rolin kyç në kontrollin ekonomik dhe financiar, në krye të cilit është suedezi Lage Olofsson. Zoti Olofsson është duke e shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Ligjin e shërbyesve civilë dhe vetë kriteret të cilat i vendos duke aprovuar pozita të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe është duke e degraduar këtë zyrë çdo ditë e më shumë.

Dhe, çka është më shqetësuese - nuk jep llogari askund për shkeljet që është duke i bërë.

Këto shkelje të ligjit, në të gjitha format, është munduar t'i mbulojë me ligjin e ri, të cilin Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nuk ka lejuar në asnjë mënyrë që t'u përshtatet personave të caktuar siç edhe ka pretenduar zoti Olofsson.

Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe komisionet përkatëse janë të obliguara të bëjnë ligje të zbatueshme dhe konform rregullave të BE-së, e jo ligje të cilat rehabilitojnë persona të caktuar dhe në të njëjtën kohë mbulojnë paligjshmëritë, të cilat Auditori i Përgjithshëm është duke i bërë tash e tetë muaj. Por, fatkeqësisht këto shkelje të ligjit dhe përshtatje e ligjit personave të caktuar është duke i mbrojtur me këmbëngulësi edhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Ky shqetësim, të nderuar deputetë, duhet të merret seriozisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sepse ne nuk duhet të lejojmë për asnjë çmim shkeljen e ligjit dhe degradimin e këtij institucioni suprem të auditimit, por mbi të gjitha duhet t'ia bëjmë me dije Auditorit Gjeneral se askush nuk është mbi ligjin, e aq më pak udhëheqësi kryesor i kësaj zyre, i cili e auditon rregullsinë e shpenzimeve publike. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Po i afrohem 8 majit, data kur është, siç e dini, njëvjetori i kalimit të kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike nga pronësia publike në pronësi private. Pra, kontrata ishte nënshkruar më herët, por më 8 maj e ka marrë nën menaxhim KEDS-i, siç po quhet tash, apo më mirë thënë konsorciumi "Limak&Çalik", dhe po ashtu jemi në një moment kur edhe javën e kaluar, por edhe këtë javë, punëtorët e KEDS-it kanë paralajmëruar protesta për shkak të pakënaqësive të shumta që i kanë ata me mënyrën se si po menaxhohet kjo, e veçanërisht me trajtimin e tyre si punëtorë të kësaj kompanie.

Kur është privatizuar kjo kompani, edhe para privatizimit, por edhe pas privatizimit, të gjithë përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ishin përgjegjës pra për këtë privatizim, e arsyetonin me gojën plot privatizimin si domosdoshmëri të rritjes së ofiçiensës së kompanisë. Pra, thoshin se kur të kalojmë në pronësi private të këtij aseti jashtëzakonisht të rëndësishëm të vendit, atëherë furnizimi me energji elektrike nuk do të jetë më problem. Apo, jo? Madje-madje edhe premtonin se do të ketë rrymë 24 orë, reduktime nuk do të ketë fare, e kështu me radhë, ndërkohë që tash të gjithë jemi dëshmitarë se në fakt reduktimet, jo që janë ndalur, por në njëfarë mënyre edhe janë shtuar. Pra, më shumë kemi pasur furnizim me energji elektrike kur ka qenë kompania në pronësi publike sesa që kemi tash. Këto reduktime të energjisë elektrike, madje po vijnë në një kohë kur as nuk kemi pasur dimër për të thënë, dhe në një kohë kur edhe ashtu temperaturat po shkojnë duke u rritur.

Pra, efienca nuk është rritur, ndërkohë që kjo kompani qartë nuk po funksionon.

Në momentin kur është privatizuar, me marrëveshje me Qeverinë, kompania është dashur t'i trashëgojë diku rreth 2 320 punëtorë, ndërkohë që tash i ka afërsisht 2 600 punëtorë, që i bie se i ka 300 punëtorë më shumë. Sipas punëtorëve që punojnë në KEDS, rritja e këtij

numri të punëtorëve vjen si rrjedhojë e kushtëzimeve dhe si rrjedhojë e listave të partisë të dorëzuara aty. Pra, për t'i punësuar njerëzit të cilët Qeveria ka vendosur t'i punësojë, dhe shumica prej këtyre të punësuarave të rinj në këtë kompani janë në fakt pjesëtarë të menaxhmentit, pra të stafit që menaxhon, e jo punëtorë në KEDS, ndërkohë që po ashtu sipas punëtorëve aty, në periudhën prej orës 24:00 deri në orën 8:00 të mëngjesit, shumica e transformuesve prej 35 në 10 kW të kompanisë janë pa mbikëqyrje. Përveç një ekipi mobil i cili e bën mbikëqyrjen e tyre, nuk ka mbikëqyrje të përhershme në këta transformues dhe rrjedhimisht ky është një prej shkaktarëve që po e kushtëzon ndaljen e energjisë elektrike apo reduktimet e energjisë elektrike për shkak të pamundësisë për të intervenuar në çfarëdo nevojë në këta transformatorë.

Kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë janë që t'u rriten rrogat...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILJIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Zbog velikih i učestalih kiša koji su se zadesili našu zemlju zadnjih desetak dana, narušeno je bezbednost, odnosno sigurnost naših građana, koji iz okolnih prizrenskih sela svakodnevno putuju po nekoliko kilometara do grada. Konkretno govorim o geografskom prostoru, buduće opštine Rečane, odnosno deonici puta Prizren-Rečane, gde veliki odrani zemljišta, kamena direktno narušavaju živote naših građana.

Znamo da rekonstrukcija tog puta je zahtevna i potrebna su velika finansijska ulaganja, ali više od 15 000 građana Župskog kraja suočava se sa tim problemom tokom cele godine. Zamolila bih ministra za infrasktrukturu, kao i Ministra za financije u Vladi Kosova, ali i razne međunarodne organizacije da ovaj put uvrstaju u budžet kao prioritet, jer je od međuopštinskog interesa koji direktno povezuje Opštinu Prizren sa opštinom Štrpce, Fefizaj, kao i međurgionalno povezanost sa Republikom Makedonijom i Republikom Albanijom. Zahvaljujem!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Temën të cilën dua ta ngre këtu sot është e bazuar në çështjen e zhvillimit ekonomik. Unë si anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, kam përcjellë disa dhe jemi duke u angazhuar në transformimin e disa organizatave shoqërore në organizata publike, siç është "Trepça". Po ashtu, kam adresuar dhe vërejtjet që po keqpërdoren lidhur me këto organizata dhe kryesisht nga disa persona në koalicion, por edhe në oponencë dhe po ashtu, kam drejtuar dhe kërkesën që para se të kërkojmë të formojmë organizatat publike

të reja apo t'i monitorojmë ato ekzistuese siç është KEK-u, ne në Korporatën Elektroenergjetike sot kemi 7 njësi, të cilat janë privatizuar nga bordi i atëhershëm i drejtorëve dhe janë quajtur si organizata aksionare pa aksione, me asete të cilat janë asete shtetërore, ndërsa quhen organizatat aksionare dhe punëtorët në këtë mënyrë janë me një bazë juridike shumë fluide.

Unë kërkoj nga Qeveria dhe kërkoj nga Ministria e Sektorit përgjegjës që të shikohen me urgjencë çështja e Kosova Thëngjillit, çështja e In Kosit, çështja e mjekësisë së punës, të gjitha kanë mundësi këto e ushqimit shoqëror e auto transportit, e sigurimit dhe Metal Kosit do të thotë 7 njësi apo 8 njësitë së bashku të shikohen dhe të rikthehen prapë si organizata në kuadër të Korporatës Elektroenergjetike, sepse këto organizata nëse bëhet një analizë e mirë këto e mbulojnë veten financiarisht, se çka ka dashur UNMIK-u në atë kohë të arrijnë nuk e di sa kanë qenë të dobishme, por mendoj që personat përgjegjës në Republikën e Kosovës të Qeverisë që flasin për zhvillimin ekonomik të shohin organizatat ekzistuese se si po ecin dhe do të jenë efikase.

Ne sot kemi një laborator i cili është duke u stërkequr që quhet In Kos dhe në zhvillimin ekonomik në Ministri, po mendojmë për ta ndërtuar një laborator tjetër, pse të mos merret ai laborator me resurset humane që janë, resurset pajisjet të tjera janë të gjitha shtetërore, prandaj mund të fuqizohet edhe më shumë e jo të krijojmë disa ishuj të cilët nuk do të funksionojnë.

Po ashtu, Kosova Thëngjilli të ketë një liberalizim më të madh edhe të jetë një fuqizim më i madh për shitjen e produktit tonë që është qymyri, e cila është një vlerë monetare e gatshme, qoftë në aspektin e kërkesës në rajon, qoftë edhe ndërkombëtarisht...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Këtu edhe është harxhuar koha e paraparë për këtë pikë të rendit të ditës.

Vazhdojmë. Unë mund me ta jap fjalën veç tani ata kanë drejtë të të pyesin ende. Si të duash, urdhëro e ke fjalën. Ministri e ka fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryetar, nënkryetar
Kabinet qeveritar,
Ato që deputeti i theksoi është e vërtetë se në vitin 2005-2006 ka ndodhur diçka që UNMIK-u ka bërë gjoja një ristrukturim të KEK-ut që në të vërtetë është treguar i dëmshëm, plotësisht pajtohem me këtë.

Vetëm në segmentin e asaj që e përmende se Ministria e Zhvillimit Ekonomik po do të bëjë laborator tjetër përveç të atij të In Kosit, po të informoj që unë e kam gjetur një tender i cili ka qenë para përfundimit në këtë Ministri dhe e kam anuluar këtë tender prej 700 mijë euro para diku 2-3 javë ditë, mu për hir të kësaj, këtë desha ta jap si informatë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë,

Me shumë interesim e përcolla edhe diskutimin e deputetit Muja edhe reagimin e ministrit. Që të dy po t'i marrësh si temë, si projekt si qëllim është shumë i arsyeshëm, por është dashur të jetë para 7 vjetëve jo tash para zgjedhjeve. Dhe, meqë deputeti Muja vjen prej partisë në pushtet, kujtoj se këtë kontribut është dashur ta japë atëherë dhe brenda këtyre viteve jo tash kur reagohet që kjo e merr ngjyrën e votave.

Unë kisha preferuar jo vetëm deputetin Muja, por gjithë veten edhe gjithë tjerët që me këmbëngulje të kërkojmë një raport të detajuar prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik edhe të na jap një performansë të kësaj jo vetëm me një deklaratë të shkurtë, por të hartohet një raport i detajuar me të dhëna edhe me fakte. Përndryshe, kjo po i ngjason një fushatë elektorale edhe kurrgjë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Kush do replikë ? Deputeti Shaip Muja, replikë.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me gjithë respektin për deputetin Sadriu, unë mendoj që ata që më njohin, jo sot para fushatës, por edhe para fushatës edhe para disa viteve këto kritika unë i kam adresuar dhe këtu tregon që zoti Sadriu nuk është në dijeni ose nuk është në kontinuitet të problematikës, por e ngre si problem që është i politizuar.

Dhe, mendoj që të gjitha problemet në Korporatën Elektroenergjetike, po janë edhe faktet, janë bërë gjatë qeverisjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe unë nuk e përmenda këtë. Prandaj, këto gabime janë të mundshme për t' u evituar edhe përmirësuar në dobi të punonjësve dhe në rritjen e kapaciteteve të Korporatës Elektroenergjetike, unë nuk e di pse e more për çështjen e votave.

Më së paku unë e kam problem çështjen e votave, e më së shumti e kam profesionalizmin edhe vullnetin që realisht nuk e shprehin as deputetët, por edhe shumë përgjegjës të sektorëve për t'i ngritur disa institucione që na kanë mbetur publike eficiente në dobi të shoqërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Ali Sadriu.

ALI SADRIU: I kam veç dy momente. Të gjithë duhet ta dinë se deri në shpalljen e pavarësisë, Qeveria e Kosovës nuk ka qenë personi ose institucioni vendimtar i të gjitha çështjeve, e para.

Nuk po e arsyetoj kurrkënd, por nga ajo datë deri tash ka mundur për t'u ngritur shumë herë, mund të jetë ngritur unë nuk e kam parë. Por, reagimi im ka qenë edhe më i fuqishëm, sepse për çdo vit Ministria për Zhvillimin Ekonomik duhet të sjellë raporte të performansës për çdo kompani publike, se ne nuk i kemi. E keqja është që nuk është veç

KEK-u, por kemi edhe kompani tjera publike të cilat kanë nevojë për trajtim, rirregullim dhe për të sfiduar që performansa e tyre të jetë më e mirë.

Po ngritën tani në fund të mandatit kur pritet, sot apo nesër ta shpërndajmë Parlamentin, prandaj çdo fjalë që e thuhet këtu e merr atë ngjyrën, deshëm ose s'deshëm.

KRYETARI: Jo, jo s'ka më! Janë kryer! Vazhdojmë!

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 13 pyetje parlamentare. Po fillojmë me pyetjen e parë. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. A është këtu ministri? Po.

Deputet, mund ta bësh pyetjen.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër,

Çështja të cilën parashtroj domethënë, domethënë ka të bëjë prej datës 30 maj 2013, ka hyrë në fuqi Ligji i odave të profesionistëve shëndetësorë. Në nenin 2, te qëllimi i odave saktësohet roli i odave të profesionistëve shëndetësorë dhe në nenin 3 qëllimi dhe themelimi i odave të profesionistëve shëndetësorë, ku odat e profesionistëve shëndetësorë do të themelohen në mënyrë që t'u japin profesionistëve shëndetësorë pavarësinë profesionale muajve të fundit Inspektorati i Punës ua ka shqiptuar dy gjoba profesionistëve shëndetësorë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, për çështje krejt të natyrës profesionale shëndetësore e që aspak nuk kanë të bëjmë me shkelje të Ligjit të punës.

Pyetja i nderuar ministër ka të bëjë - në raportin e tyre inspektorët e punës nuk kanë gjetur shkelje të kontratës së punës në Qendrën Klinike Universitare dhe përkundër kësaj kryeinspektori Basri Ibrahim i ka shqiptuar gjoba për profesionistët shëndetësorë të Qendrës Klinike Universitare dhe vetë Qendrën Klinike Universitare sa i përket profilizimeve profesionale të mjekëve e që askund në Ligjin e punës nuk i përshkruhet kjo e drejtë Inspektoratit të Punës.

I nderuar ministër, a jeni në dijeni ju dhe Inspektorati i Punës për miratimin e Ligjit të odave të profesionistëve shëndetësorë, i cili u jep profesionistëve shëndetësorë pavarësinë profesionale, ndërsa Inspektorati i Punës në dy raste ka shkelur këtë ligj dhe ka shkelur Ligjin e punës duke shqiptuar masa për çështje kryekëput profesionale të profesionistëve shëndetësorë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Rashiq, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIČ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovani gospodine Haxhiu,

Ako se dobro sećam, imali smo još jednom ovako ovo pitanje, u vezi ovog slučaja, koji se desio. Ja ću samo ako bi mogao ukratko da vam objasnim samo sa tehničke strane, sa zakonske strane, kako to funkcioniše.

S odredbom člana 82 zakona o radu, predviđeno je da, pod 1 zaposlen u bilo koje vreme može podneti žalbu inspektorijatu za rad za svako pitanje koje spada u nadležnosti ovog organa i pod 2, inspektorijat za rad treba da donese odluke o žalbi u roku od 30 dana ili da obaveste podnosioca žalbe o produženju roka, u kojem odluka mora biti doneta.

Sa odredbom člana 4, zakona broj 2002/9 i 03/Z-017 o inspektorijatu za rad Kosova predviđeno je da glavni inspektorijat za rad upravlja autoritetom inspektorijata odgovorno za sprovođenje funkcija koje su im poverene.

Na osnovu odredbi zakona o radu, broj 03/Z-212 i odredbama zakona broj 202/9 i broj 03/Z-017, za inspektorijat za rad i nijednoj drugoj odredbi zakona a to se ne dešava ni u praksi. Glavni inspektorijat za rad, glavni inspektor za rad ne može da izreče kazne. On je deo panela, koji odlučuje o samim kaznama.

Što se tiče ovog posebnog slučaja, koji ste pomenuli, ja moram da vam kažem da je po svim ovim tačkama koje su predviđeni članom ovog zakona, kaže se da inspektorat za rad ... sproveden zakon o radu, koji uređuje odnose poslodavac - zaposleni, odnosno odnos rada i ne meša se u stručna medicinska pitanja.

Mi smo inače bili informisani da postoji poseban zakon o profesionalnim stručnjacima i mi se unutar tog zakona nikako ne mešamo. Zakon o komorama lekara ili zdravstvenim stručnjacima uređuje profesionalnu zdravstvenu materiju. Ni u jednom slučaju inspektorijat za rad nije ni na koji način hteo da kazni ni kaznio zdravstvene radnike, odnosno eksperti ovih zdravstvenih pitanja.

Inspektorijat za rad ... lica koje kaznu ovoj klinici kao poslodavcu i odgovornim na rukovodećim funkcijama za kršenje prava zdravstvenih radnika, što ukratko ja ću vam dostaviti ovo u pismenoj formi, pošto ima puno zakona, na koje se pozivamo. Inspektorijat ni na koji način ne kažnjava individualno...

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit ministër!

Është më se evidente që për çështjen e njëjtë për afërsisht ndërhyrjen e Inspektoratit të Punës në çështje profesionale shëndetësore është pyetja ime e dytë që e bëj. Pra, unë kam menduar shumë që pas pyetjes sime të parë do të kemi një reagim tuajin profesional dhe vetë Inspektoratit të Punës. Për fatin e keq që kryeinspektori Basri Ibrahim i ka futur duart në shëndetësi dhe pas këtyre përgjigjeve tuaja dhe reagimeve të Basri Ibrahimit dhe dënimit të drejtorit të Kirurgjisë dhe të Kardiologjisë, zotit Maxhuni, profesorëve me

përvojë 30-vjeçare, nuk mbetet asgjë tjetër pos Basri Ibrahimit dhe ndoshta me asistencën tuaj t'i bëjë edhe listën e operacioneve dhe të bëjnë edhe renditjen në Qendrën Klinike Universitare se kush, cili mjek do ta ketë orarin në sallën e operimeve.

Edhe kjo i ka mbetur të ndërhyjë Inspektoratit të Punës në Qendrën Shëndetësore, pas krejt këtyre ndërhyrjeve jo profesionale, jo etike dhe që janë në kundërshtim edhe me Ligjin e punës dhe me Ligjin...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Ja mogu samo jednu stvar da vas uverim, ukoliko dođete kod mene.

Ima... znam da je slučaj, ja sam ga video ali nisam mogao sve da prezentujem sada ovome. Ja mogu da vam garantujem da nijedan, da inspektori neće sigurno, niko, nemaju prava, nemaju osnovu, nemaju zakonsku bazu da bilo koga kazne tako svojevolljno nemaju prava, nemaju osnovu, nemaju zakonsku bazu da bilo koga kazne tako svojevolljno.

Kad se bilo koja institucija i više puta sam rekao da je to krajnji metod, mi obično prvo puno toga uradimo da bi se to korigovalo, što je najbitnije, a tek na kraju da eventualno nekome napišemo kaznu.

I u ovom slučaju ne kažnjava se pojedinac, nego poslodavac ili institucija ili vodeći taj menadžer neke određene institucije zbog toga što nije sproveo preporuke koje su bile predviđene.

Ali, evo još jednom vam kažem, ja sam slučaj video, možete da dođete kod mene još jednom o tome da popričamo. Ja mogu da vam garantujem da nikada i niko iz inspektorijata za rad ne sme i ne može da na bilo koji način određenog pojedinca kažnjava zbog toga što ono hoće. Glavni inspektor do sada je bio vrlo predan na svom poslu. Ja stvarno iskreno mislim da će tako nastaviti i dalje. I sve što ne bude bilo unutar njegovih kompetencija, mi ćemo apsolutno to sankcionisati, to vam obećavam. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Unë këtë pyetje parlamentare e kam paraparë për seancën e kaluar, po nuk ishte ministri këtu, edhe sot nuk është këtu. Unë do ta parashtoj pyetjen, ndoshta na dëgjon dhe na përgjigjet, qoftë nëpërmjet medieve, qoftë në mënyrë të shkruar, meqë nuk ka pasur mundësi që të jetë sot në seancë.

Çështja ka të bëjë tashmë me memorialin e UÇK-së në Marinë, i cili po bëhet një muaj që është i mbyllur, memorial ky unik në Kosovë, i cili përmban emrat e të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pyetja për ministrin është, cilat janë kompetencat e Ministrisë lidhur me këtë memorial, sepse pas deklaratës sime në një nga seancat e Kuvendit të Kosovës, unë kam marrë shumë ofendime, do të thosha, nga kryeshefi i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Memorialëve, zoti Blakaj, i cili në vazhdimësi e drejton gishtin nga ministri Dardan Gashi dhe ministria përkatëse.

Unë para se të ngre këtë çështje në Kuvend, domethënë kam kërkuar sqarimet prej ministrit Gashi dhe ai në takimet që unë kam pasur, më është referuar që do të thotë kompetencat i ka agjencia, ndërsa unë ende nuk e kam të qartë, pse po bëhet një muaj dhe ky memorial ende është i mbyllur?

Kjo është një kërkesë e qytetarëve të Skenderajt dhe unë pres një përgjigje të shpejt nga ministri Dardan Gashi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Në bazë të Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, personat e shurdhër kanë realizuar pension plot dhjetë vjet. Para pesë muajve kësaj kategorie ia keni ndërprerë pensionin dhe në bazë të të njëjtit ligj. Andaj, a ka mundësi të na sqaroni pse ua keni ndërprerë pensionin personave të shurdhër?

KRYETARI: Ministër Rashiq, e keni fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Ja stvarno moram da obratim pažnju na ovu terminologiju. Kad kažete da je zašto je penzija obustavljena gluvim osobama, ja još jednom podsećam, ovo pitanje je bilo pre dve nedelje.

Jasno sam rekao, opet ću da kažem, posle ću pročitati i uredbe na osnovu kojih se pozivamo i zakone. Nijedan, nijedna osoba, koja ispunjava uslove prolazi kroz komisiju i komisija lekarska odobrava to.

Gluve osobe nisu ni na koji način u posebnoj kategoriji. Oni su u kategoriji kao i svi drugi, kao sve druge osobe, sa ograničenim sposobnostima i njih utvrđuje lekarska komisija.

Ja sam prošli put i rekao, ukoliko na bilo koji način vi smatrate da je bilo čije pravo prekršeno, svako od njih ima prava da se žali, ali ne meni, treba da se žali doktorskoj komisiji, na onoj drugostepenu proveru. Zbog toga, što opet kažem, smatram da je

najverodostojnija, da je najkompetentnija je lekarska komisija da utvrdi ko i u stvari osoba sa ograničenim sposobnostima ko nije.

Nikakvo izdvajanje posebne kategorije gluvih nije bilo. Prema tome, kad kažete zašto smo toj kategoriji u ovom slučaju gluviha, zašto smo ih otklonili sa kategorije penzije, to apsolutno nije tačno, čak sam i spreman da ukoliko mislite da ste vi identifikovali jedan određeni broj gluvih osoba, koji su na po vašem mišljenju oštećenu u tom procesu, da organizujemo jednu dodatnu posebnu ad-hoc komisiju, koja bih mogla da utvrdi stanje na osnovu vaših pritužbi.

Inače, odgovorno tvrdim da lekarska komisija ne tretira gluve osobe posebno, nego ih tretira zajedno sa ostalima, zbog toga što je tako i predviđeno zakonom. A to je inače predviđeno zakonom od 2003/23 za penzije lica sa ograničenim sposobnostima na Kosovu i svi zakonski pod akti od tog njegovog usvajanja su bili formirani, a koji kaže takođe u slučaju ograničenih sposobnosti ili bolesti na druge organe i sisteme, koji uzrokuju potpunu trajnu invalidnost kod bilo koje zajednice, lekarska komisija sa profesionalizmom i korektnom odgovornošću je sposobna da za određivanje svih propisa zakona na snazi.

Prema zakonu 2003/23 procena invaliditeta vrši se od strane lekarske komisije i u zavisnosti od dijagnoze bolesti, ili ponovno procene određuje se od strane lekarske komisije jedna period penzija od jedan, tri i pet godina, ali samo do 65 godina starosti.

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

SUZAN NOVOBËRDALIU: I nderuar ministër!

Ju e dini, ju kemi ftuar në komision plot tri herë, nuk na keni ardhur për këtë çështje.

Disa herë u thirrët në komisionin profesional, i cili e trajton shkallën e paaftësisë, komision profesional ju nuk keni në ministri, komisionin e juaj e kemi pasur në komisionin tonë, nuk janë profesional domethënë, për çështjen e trajtimit të të shurdhërve.

Pastaj, ta zëmë, ju jeni në tre vjetët e fundit ministër aty dhe këta për plot tre vjet të fundit morën, domethënë dhjetë vjet kanë marrë pensione dhe tri vjetët e fundit që jeni ju aty, çka u bë tash muajve të fundit, pesë muajt e fundit u trajtuan të njëjtit dhe u përjashtuan nga skema pensionale?

Domethënë, këtu është një shkelje e ligjit. Edhe mohimi i të drejtës së të shurdhërve, sado që ju thoni që e keni me të drejtë, nuk e keni me të drejtë. Dhe, trajtoni mirë çështjen dhe nëse keni pasur nevojë për plotësim-ndryshim të ligjit, i cili është në fuqi plot dhjet vjet e plotë mangësi ka, merreni lexojeni, mos t'ju përmend më shumë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, mund të vazhdosh!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Gospodo poslanice,
Vi kad bi stvarno brinuli o prava gluvih, vi bi rekli OK, ajde da na pravimo posebnu ad-hoc komisiju da utvrdi dali su im oštećena prava ili ne.

Kad sam malo pre pročitao komisija utvrđuje penzije na godinu, tri i pet. Jedna od tih penzija ona se daje. Stanje je moguće promeniti a što se tiče profesionalnosti komisije, ja stvarno ne znam. Znam da su svi doktori tipa „specijalisti u svojoj oblasti“. I prema tome opet kažem, evo kao stvarno kao jedan kompromis, ako hoćete mogu da razgovaram sa članovima komisije, da napravimo jednu ad-hoc komisiju, koje vi koji mislite da su oštećeni, da uradimo još jedan ponovni predlog.

A ukoliko bi pravda u tom slučaju bila zadovoljena, ako vi mislite da su u pravu, onda verujem da će sve biti u redu. A nema nikakvih, kad kažete ima vrlo sa jednom tendencijom, koja po meni nije adekvatna, da ima toliko kršenja zakona, da toliko ima nepravilnosti, vi ste prvi koji to kaže.

Vi ste prvi, i ja mislim da to ono što vi kažete apsolutno nije na mestu. Hvala!

KRYETARI: Xhafer Tahiri ka pyetje për ministrin Ramë Buja.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Zoti ministër,

Gjatë vizitave që kam bërë në shkollat fillore të fshatrave Stanovc, Dumnicë, Strovç, Maxhunaj, Smrekovnicë, Druar, por dhe shumë shkolla të tjera në komunën e Vushtrrisë, përveç që kam parë një gjendje shumë të rëndë në inventarë dhe në gjendjen fizike të objekteve të shkollave, ajo që më ka rënë në sy dhe që më ka bërë shumë përshtypje, për të cilën jam brengosur, është fakti se dyshemetë e klasave janë të lyera me substancë të zezë, që mendoj se është ose bitolium, ose vaj katran, e që është për mendimin tim materie kancerogjene dhe tepër e dëmshme për shëndetin e nxënësit dhe mësuesit në këto shkolla.

Kjo gjendje në këto shkolla të fshatrave të komunës së Vushtrrisë është dëshmi për dështim në menaxhim jo vetëm të procesit mësimor, po edhe të mirëmbajtjes së objekteve shkollore, përkundër faktit se shpenzohen shuma të mëdha të parave të taksapaguesve kosovarë për këto çështje.

Pyetja ime është: si është e mundur, zoti ministër, që lejohet që dyshemeja e klasave në vitin 2014, në Republikën e Kosovës, lyhet ende me materie që për mendimin tim, është kancerogjene dhe çka ka bërë Ministria e Arsimit që kjo të mos ndodhë? A do të merrni masa për të eliminuar këtë gjendje në shkolla? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Buja, urdhëro!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër,
Kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Tahiri,
Bazuar në Ligjin e arsimit parauniversitar dhe Ligjin e arsimit mbi komunat, kompetencat për mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe menaxhimin e tyre dihet se janë përgjegjësi ekskluzive e komunave.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka hartuar normat dhe standardet për ndërtesat shkollore me ç'rast kemi kërkuar nga komunat që t'u përmbahen këtyre standardeve në mënyrë të saktë. Po ashtu, të gjitha shkollat të cilat ndërtohen apo rinovohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punohen me materiale të shëndetshme dhe sipas standardeve për ndërtesat arsimore.

MASHT-i ka bërë përpjekje që komunave t'u ofrojë asistencën aq sa lejon ligji për ta bërë atë që duhet bërë, po ashtu në kuadër të komunave janë edhe inspektorët e sferës higjeno sanitare, të cilat mund të bashkëpunojnë në nivel komunal, në mënyrë që kjo dukuri të parandalohet.

Kjo është përgjigja...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

XHAFER TAHIRI: Po, sigurisht që kam pyetje shtesë, sepse mendoj që fshehja pas, unë e di shumë mirë ligjin, dhe fshehja pas asaj që s'kemi kompetenca mendoj që është e padrejtë, sepse shëndeti i nxënësve është në pyetje dhe i mësimdhënësve në këto shkolla. Është tepër e rëndësishme, për të thënë që s'kemi kompetenca me ligj.

Pyetja ime konkrete është, në kuadër të standardeve të Ministrisë, a është e paraparë në mënyrë decitive, që dyshemetë nuk guxojnë të lyhen me substanca, çfarë janë duke u lyer në këto shkolla? A e di çfarë ere kundërmon në ato shkolla? Është e padurueshme.

KRYETARI: Ministër?

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar,
Unë nuk thashë që ne jemi të liruar nga kompetencat. Kemi kompetencat tona ligjore, që na i ka dhënë ky Kuvend me ligjin e aprovuar në këtë Kuvend dhe kemi përgjegjësitë tona dhe kemi përcaktuar standardet dhe kërkojmë vazhdimisht nga drejtoritë komunale dhe drejtorët gjegjës të shkollave, që në bazë të standardeve të përputhen edhe ato veprime që bëjnë në të gjitha shkollat që i kanë në Kosovë...

KRYETARI: Vazhdojmë! Deputeti Xhafer Tahiri, pyetje për ministrin Fehmi Mujota. S'është këtu, por mund ta parashtrosh pyetjen, deputet.

XHAHER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Unë e shoh që ministri nuk është këtu, përkundër që më 28 prill ka marrë pyetjen parlamentare dhe nuk e di arsyen pse, por çështja është një rrugë regjionale, e cila lidhë Vushtrrinë me komplet rrëzë Çyçavicën, e cila rrugë është në gjendje tepër të rëndë dhe mendoj që ka qenë shumë e thjeshtë për ministrin, që të informojë këtë Kuvend dhe qytetarët e asaj zone, se pse nuk ka ndërmarrë asgjë për sanimin e gjendjes së kësaj rruge, që shkon krejt rrëzë Qyçavicës dhe kur mendon që ta rregullojë këtë rrugë?

Kjo është e pashpjegueshme, që ajo gjendje e asaj rruge të jetë ende kështu, por unë do ta ruaj të drejtën që edhe në seancën tjetër t'ia bëj pyetjen ministrit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, lexoje pyetjen.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Ligji për personat e verbër i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2013 ka hasur në vështirësi për t'u zbatuar për arsye të mungesës së mjeteve financiare. Në gjysmën e dytë të vitit 2013, me rishikim të buxhetit kësaj kategorie i është ndarë një shumë e caktuar e të hollave me qëllim të realizimit të të ardhurave të cilëve u garantohet me ligj, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Personave të verbër gjatë kësaj periudhe u është dhënë vetëm pensioni në kuadër të personave me aftësi të kufizuar dhe nuk u është dhënë kompensimi për shkak të verbërisë.

Pyes ministrin: Kur do të bëhet kompensimi i pjesës së mbetur i të hollave ndaj personave të verbër, sepse në atë periudhë atyre Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u ka mbetur borxh pjesën e mbetur të kompensimeve për shkak të verbërisë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče, još jednom!

Da, kao što smo i ranije konstatovali sa zakonom o slepima bilo je finansijskih poteškoća koji su u toku rešavanja. Evo sada sam razgovarao sa gospodinom kolegom ministrom u vezi toga. Taj deo finansijskog sporazuma ili konstrukcije će biti regulisan što je pre moguće. Mi smo zahteve svoje poslali na vreme. Moramo da imamo jednu harmonizaciju sa Ministarstvom financija prema tome ovaj problem, ovaj dug što ste vi rekli koji smo ostali prema slepima mi ćemo regulisati u što skorije vreme. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

KYMETE BYTYÇI: Zoti ministër,

Duke qenë se tash po hyjmë në pjesën e dytë të vitit buxhetor, unë mendoj se kjo është mungesë e vullnetit nga ana juaj dhe Qeverisë për përkujdesjen e kësaj kategorie të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Ne, nije tačno. Nema nedostatka želje i volje za regulisanjem zakona o slepima. Bilo je određenih finansijskih poteškoća. Još jednom ponavljam mi smo naše zahteve o lociranje sredstava iz tog koda i na koji način treba biti transferisani u drugi kod je već pre nekih 3 meseca smo na jedan konstruktivan način i tehničkoj bazi već predali. Kao što sam i rekao, još jedan mali korak sa Ministarstvom finansijski moramo da napravimo da bi do tih ispunjavanja tih prava došli. Hvala puno!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeminsitritin Thaçi. Deputet, kryeministri s'është këtu.

FATON TOPALLI: Kryeministri s'ka edhe si vjen, për arsye se janë duke e ndjekur punëtorët e Fabrikës së Gypave, punëtorët e Aeroportit, të cilët i ka larguar nga puna dhe pyetja ime ka të bëjë pikërisht me këtë çështje.

Kryeministri, muajin e kaluar e ka nënshkruar një kontratë të përgjithshme kolektive, një dokument i cili është shumë i rëndësishëm dhe edhe pse kontratës së fundit i ka skaduar afati në vitin 2008, ai e ka bërë këtë kontratë tani në përfundim të mandatit të këtij Parlamenti, për fushatë zgjedhore.

Sot një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve, sidomos në sektori privat punojnë me orar të stërzgatur 10 deri në 12 orë, e ndonjëherë edhe më shumë pa kompensime shtesë. Atyre nuk u respektohet e drejta e pushimit vjetor dhe atij mjekësor e të mos flasim për beneficiumet që do të duhej të përmirësonin pozitën e të punësuarve në marrëdhënie të punës.

Pyetja ime ishte: si mendoni t'i realizoni detyrimet që dalin nga kontrata e përgjithshme kolektive, respektivisht cili është plani juaj për këtë çështje?

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Lumnije Morina, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

Po e shoh se ministri nuk është prezent, po pyetja parlamentare ka të bëjë me qytetarët e komunës së Vitisë, qytetarë që kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me gjendjen e rrugëve në komunën e tyre, gjendja e rrugëve është shumë e rëndë, sidomos e atyre të relacionit Viti-Gërllicë, Viti-Klllokot-Gjilan, Viti-Klllokot-Ferizaj dhe Viti-Ramnishtë-Letnicë.

Ky dëmtim i rëndë i këtyre rrugëve po e dëmton shumë xhepin e qytetarëve të komunës së Vitisë, por po paraqet njëkohësisht edhe rrezik për jetën e qytetarëve gjatë shmangieve nga ngasësit e automjeteve që janë të grupuara vazhdimisht këto rrugë të Vitisë.

Vitia i ka rreth 8 mijë automjete, të cilat paguajnë taksën rrugore, ndërkaq sipas një analize që ka bërë Lëvizja “Vetëvendosje” dëmet që po u shkaktohen automjeteve të qytetarëve dhe bizneseve të komunës së Vitisë, arrijnë shumën rreth 40 mijë euro në muaj, dëmtimet e gomave dhe amortizimi në përgjithësi i automjeteve.

Qytetarët e komunës së Vitisë vazhdimisht janë ankuar për këtë gjendje të rrugëve, por Qeveria asnjëherë nuk i trajtoi me seriozitet kërkesat e tyre.

Pyetja parlamentare për ministrin është: Pse nuk keni ndërmarrë deri tani asgjë në këtë drejtim dhe a keni ndërmend të ndërmerrni diçka, sepse çdo vonesë përpos pasojave të përmendura më parë mund të shkaktojë edhe humbje të jetëve të njerëzve që do të ishin të pakompensueshme.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Besim Beqar. Ministri është këtu.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër, para se të përgjigjeni në pyetjen - cilat janë arsyet që Byroja kosovare e sigurimeve nuk e ka rregulluar çështjen e kartonit të gjelbër, mendoj që duhet t’i keni parasysh disa çështje.

Prej përfundimit të luftës e deri më sot mijëra, dhjetëra e qindra mijëra mërgimtarë janë plaçkitur në kufi për arsye se kanë paguar dyfish kartonin e gjelbër, ndërsa edhe qytetarët e Kosovës që dalin jashtë vendit detyrohen të paguajnë çmime të dyfishta.

Në vitin 2000 dhe 2001 Këshilli i byrove të kartonit të gjelbër në Gjenevë ka rekomanduar që Kosova ta ketë kartonin e gjelbër.

Deri më sot, edhe pse e ngritur në vitin 2011, 2012 dhe në fund të vitit 2013 nga Lëvizja “Vetëvendosje” si temë, përkundër premtimeve të Qeverisë kjo çështje nuk është zgjidhur akoma.

Argumenti i përdorur se Kosova nuk mund të anëtarësohet për shkak se nuk është anëtare e OKB-së, e kanë demantuar dhe në korrik të vitit të kaluar në emisionin ‘Polis’, duke e sjellë argumentin që Zvicra është bërë anëtare e OKB-së në vitin 2002, ndërsa është anëtare e Byrosë së Kartonit të Gjelbër prej vitit 1949.

Në Këshillin e byrove të kartonit të gjelbër janë anëtarësuar 46 shtete, 34 prej tyre kanë nënshkruar marrëveshje multilaterale, ndërsa 12 bilaterale. Edhe Kosova e kishte mundësinë të nënshkruante marrëveshjet bilaterale, gjë që nuk e bëri.

KRYETARI: Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet që e ngrite çështjen,

Kjo nuk ka filluar as më 2012 kur ka kërkuar “Vetëvendosje”, por kjo çështje është trajtuar që nga paslufta e deri më sot. Janë duke u analizuar të gjitha mundësitë. Dua t’ju bëj me dije që Ministria e Financave nuk është përgjegjëse për lëshim të kartonëve të gjelbër, prandaj nuk jam personi përgjegjës për këtë çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë në asnjë rrethanë. Këtë punë ju e dini mirë.

Këto kompani të sigurimeve kanë një bord të vetin, pra janë si kompani të organizuar në shoqatën e tyre, të cilat i përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë si Kompanisë të sigurimeve të Bankës Qendrore dhe Banka Qendrore është institucion që nuk monitorohet nga Ministria e Financave. Megjithatë dua t’ju informoj që procedurat të cilat janë nisur në aspektin bilateral dhe multilateral janë në diskutim e sipër, jam i interesuar dhe besoj që kjo çështje do të gjejë zgjidhje, por, nuk është aq e lehtë siç po mendoni ju, sepse lehtë është të lexosh nganjëherë si t’i lexosh gazetat e si t’i lexosh letrat dhe për të shitur patriotizëm këtu.

Po ju them se asnjëherë taksa të dyfishta nuk ka nga qytetarët, po i keqinterpretoni qytetarët, sepse nuk ka taksa të dyfishta, paguhen për të marrë marrjen e sigurisë dhe përgjegjësi për dëmet të cilat mund të shkaktohen në gazë të trafikut. Pra, nuk është në asnjë rrethanë një tatim dhe gjobitje siç po e quani ju, sepse edhe qytetarët tanë kur dalin jashtë vendit dhe nuk janë pjesë e kartonit të gjelbër, janë të orientuar dhe të detyruar për të paguar, sikurse edhe makinat tjera të cilat hyjnë në Republikën e Kosovës.

Ju e dini që një vendim është marrë së voni që një pjesë e qytetarëve të cilët janë nga Lugina e Preshevës, ata janë të liruar me vendimet e Qeverisë, respektivisht duke marrë obligim jo të liruar, se Qeveria nuk mund t’i lirojë, por ka marrë vendim që Qeveria të paguajë për ta derisa të zgjidhet një çështje e tillë.

Pra, në këtë kontekst dua të them edhe një herë, nuk ka gjobitje, mos i keqinterpretoni, mos i mashtroni qytetarët. Janë procedura ligjore të nivelit ndërkombëtar të cilat nuk e di a i dini a s’i dini, nuk jam përgjegjës për atë, por janë në proces e sipër. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Zoti ministër,

Për 14 vjet kompanitë e sigurimeve kanë fituar 200 milionë euro dhe kanë paguar dëme vetëm 10%. Unë vetë kam udhëtuar shpeshherë nga Zvicra, e kam kartonin e gjelbër atje dhe sa herë vij në Kosovë, paguaj edhe një herë, për arsye se kjo çështje nuk është rregulluar.

Konferenca e sigurimeve në Prishtinë, e mbajtur më 28 mars 2013, tregoi se krimi ekonomik i organizuar nga Shoqata e Sigurimeve në Kosovë e kishte mbështetjen e plotë të politikës.

Në këtë takim byroja u lavdërua për punën e mirë nga zëvendëskryeministri Hajredin

Kuçi, zëvendësministri i Ekonomisë, Ramadan Avdiu, ministri i Punëve të Brendshme, Rexhepi, guvernatori i Bankës, Bedri Hamza, ndërsa organizatori i këtij evenimenti është vetë vëllai i kryeministrit. Mbiemrat Thaçi dhe Pacolli në rolet konkrete në Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës, dëshmojnë edhe koalicionin qeveritar, nivel të mashtrimit.

Pra, këto që i thatë ju nuk janë të vërteta. 200 milionë i kanë fituar këto kompani, 10% të dëmeve i kanë shpenzuar.

14 vjet pas luftës nuk është në rregull që kjo çështje të mos rregullohet për arsye se thjesht...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit! Po më vjen mirë që erdhe aty ku e kishe synimin, se nuk e ke hallin e qytetarëve, por e ke hallin e të bërjes politike.

Unë po ju them shumë qartë. Komunikimi... jo, për të bërë politikë të keqe, politikë të gabueshme, politikë të pa bazë, politikë e cila është degjeneruese për shtetin dhe për qytetin, prandaj në këtë kuptim, në këtë kuptim po ju them, Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta thërret edhe Bankën Qendrore edhe institucionet tjera për t'u informuar më mirë. Unë nuk mbaj statistika, se nuk jam kontabilist i asnjë shoqate të asnjë kompanie të sigurimeve, statistika nuk mbaj dhe më vjen mirë që ato mund t'i evitojnë, por po ju them edhe një herë, nuk është në neglizhencën e asnjë rrethane të shtetit. Neglizhenca e shtetit mund të matet vetëm atëherë kur nuk plotësohen normat ligjore procedurale për t'u trajtuar një proces i tillë. Por ju e dini mirë, sepse meqenëse po thoni jam shtetas i Zvicrës, e din mirë që mbrojtja e interesit nuk bëhet vetëm duke synuar vetëm një pikë në moment të caktuar, por në përgjithësi.

Fokusi juaj, deputet i nderuar, është shumë i ngushtë për t'i trajtuar problemet e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lumnije Morina, pyetje për kryeministrin Thaçi. Lumnije, do ta bësh pyetjen ? Fjalën e ka zonja Morina.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Pyetja parlamentare ka të bëjë me problemin e ish-punëtorëve të Fabrikës së Gypave IMK të Ferizajt, problem i cili menduam se u zgjidh në seancë, pasi në seancën e fundit, në seancën e 19 marsit të vitit 2014, u miratua vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e vendimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për pagesën e borxhit ndaj ish-punëtorëve të Fabrikës së Gypave IMK të Ferizajt.

Miratimit të këtij vendimi punëtorët e Fabrikës së Gypave shumë iu gëzuan. Në qendrën e qytetit të Ferizajt u organizua një festë e madhe. Punëtorët së bashku me familjarët e vet dhe me qytetarët tjerë. festuan, iu gëzuan këtij vendimi dhe kërcyen së bashku me tupanë.

Gjithashtu për këta punëtorë u shtrua edhe një darkë. Dhe ky gëzim nuk zgjati shumë. Afatet kohore për realizimin e këtij vendimi erdhën dhe nuk u realizuan. Edhe pse u përcaktuan këto afate, afati kohor prej 30 ditësh për pagesën e parë ka kaluar dhe ajo nuk u realizua.

Pyetja për kryeministrin e Republikës së Kosovës është: Pse zoti kryeministër nuk u realizua pagesa e parë që ka qenë e përcaktuar brenda afateve kohore prej 30 ditësh?

KRYESUESI: Faleminderit, Lumnije! Zoti Beqaj dëshiron t'ju përgjigjet. A jeni dakord? Zoti Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Dua ta bëj të qartë edhe një herë se konform vendimit të Kuvendit, Qeveria ka qenë e obliguar që t'i ndërmarrë të gjitha masat e saj ligjore për ta zbatuar vendimin. Vendimi i Kuvendit është shumë i qartë, ai thotë: "Obligohet AKP-ja për ta paguar borxhin, ndërsa Qeveria obligohet për t'i kryer të gjitha obligimet e saj ligjore".

Ne, javën e kaluar, realisht para disa ditësh, ia kemi dërguar një shkresë AKP-së ku i kemi thënë që Qeveria heq dorë nga fondet tepriçë konform ligjit për AKP-në dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike. Prandaj, është çështje e AKP-së dhe e Kuvendit. Pra, Qeveria i ka ndërmarrë të gjitha masat e veta ligjore dhe ne besojmë që shumë shpejt ajo çështje duhet të përfundojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Morina?

LUMNIJE MORINA: I nderuar ministër,

Në seancën e 19 marsit, e përsëris, u miratua vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ju e dini që vendimi i Gjykatës Kushtetuese i bën përgjegjëse edhe Qeverinë, edhe AKP-në për ekzekutimin e këtij vendimi. Nuk mund të jetë përgjegjës Kuvendi i Republikës së Kosovës së bashku me AKP-në, por përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit për këta punëtorë të Fabrikës së Gypave është Qeveria, së bashku me AKP-në. Kështu është në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Edhe një herë dua ta ritheksoj - vendimi i Gjykatës Kushtetuese, respektivisht vendimet e Gjykatës Komunale, të cilat i kanë paraprirë këtij vendimi thonë që janë obligime të AKP-së, sepse AKP-ja është prioritare dhe obligimet ligjore që dalin nga Qeveria për këtë zbatim të këtij vendimi.

Pra, flasim për obligime, të cilat janë të AKP-së, sepse Qeveria nuk mund t'u paguajë mjete drejtpërdrejt qytetarëve në asnjë rrethanë pa kaluar nëpërmjet AKP-së. Qeveria,

meqë ka marrë vendim para disa ditësh, i ka njoftuar që ne nuk kërkojmë që mjetet tepricë, fondet tepricë, të cilat i mbeten nga procesi i privatizimit të AKP-së ka nevojë t'i kthejë, sepse sipas Ligjit të AKP-së, më duket pika 3.1 e ligjit thotë në mënyrë shumë të qartë: "Mjetet të cilat mbeten si fonde tepricë, AKP-ja ka për obligim t'ia kthejë Qeverisë dhe Qeveria konform Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe me vendim të Kuvendit, ato mjete mund t'i shfrytëzojë për zhvillim ekonomik".

Vendimi i Kuvendit ekziston, Qeveria ka hequr dorë nga fondet tepricë për t'i rikthyer dhe me këtë bazë ne presim që zbatimi i vendimit të monitorohet nga Kuvendi për AKP-në. Pra, AKP-ja i ka mjetet, e ka vendimin e Kuvendit. Qeveria i ka marrë të gjitha masat e veta ligjore dhe ne presim që ai vendim është çështje ditësh, të cilin ata duhet ta zbatojnë. Është vendim i Kuvendit dhe për këtë e ftoj Kuvendin që të merret tani me zbatimin e institucioneve, të cilat drejtpërdrejt i përgjigjen Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Vërtet s'do të doja të kyçem në këtë, por zoti ministër po flitni diçka që s'është e vërtetë.

Kuvendi e ka kryer obligimin e vet. Ju e keni thënë, Qeveria e ka thënë: Le të marrë vendim Kuvendi, ne i kryejmë obligimet. Kryejini obligimet që i keni marrë dhe ju ka autorizuar ky Kuvend. Të tjerat janë lojë fjalësh. Punëtorët e fabrikës këtë e kërkojnë.

KRYESUESI: Zoti Beqaj, urdhëro!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Edhe një herë, i nderuar deputetë, të falënderoj për ta ringritur këtë çështje.

Kuvendi ka marrë vendim për ta obliguar AKP-në që ta zbatojë vendimin, dhe Kuvendi ka marrë obligim, gjithashtu e ka obliguar Qeverinë për t'i kryer përgjegjësitë e veta ligjore. Ne kemi marrë vendim që nga fondet tepricë dhe kjo çështje tani pritet nga AKP-ja. Dhe, po e them edhe një herë, shikojeni Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për privatizimin, Ligjin për menaxhimin e financave publike, do ta shihni që në mënyrë shumë të qartë është specifikuar që Qeveria, konform Ligjit për menaxhimin e financave publike, mund t'i përdorë fondet tepricë me vendim të Kuvendit.

Kuvendi e ka marrë vendimin dhe mbi këtë vendim tani pritet që AKP-ja ta zbatojë vendimin. Dhe, po e them, Kuvendi duhet në mënyrë automatike ta monitorojë zbatimin e një vendimi të Kuvendit, nga një agjenci e cila është drejtpërdrejt përgjegjëse para Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Çështja ka të bëjë me një shqetësim të banorëve të kryeqytetit, por jo vetëm të kryeqytetit - ngecja e punimeve në rrethrotullimin të Vetërnikut, në rrugën magjistrale Mitrovicë-

Prishtinë-Ferizaj është bërë shqetësim për shumicën e banorëve të Kosovës, të cilët frekuentojnë në atë pjesë.

Rrethrotullimi i Veternikut është shndërruar në makth për qytetarët e Kosovës. Punimet në këtë projekt kanë filluar në vitin 2012 dhe bazuar në intensitetin e dinamikën e punimeve, përfundimi i tyre nuk pritet të ndodhë shpejt. As udhëheqja e atëhershme, as kjo e tanishmja e Komunës së Prishtinës duket të mos e ketë profesionalizmin e duhur që ky projekt të përmbyllet, pasi kjo rrugë vazhdon të jetë edhe sot e mbyllur dhe qytetarët detyrohen t'i shfrytëzojnë rrugët alternative dhe të kenë vështirësi në qarkullim.

Edhe pse në fillim është premtuar që kjo rrugë do të jetë e mbyllur vetëm për 45 ditë, është më se evidente që udhëheqja e kaluar komunale e Prishtinës është karakterizuar me kotësi, ndërsa kjo e tanishmja edhe me mungesë të njohurive elementare për zhvillim dhe mbikëqyrje të projekteve.

LDK-ja dhe "Vetëvendosje" së bashku për afro dy vjet nuk po arrijnë ta përmbyllin një projekt të vetëm të rrethrotullimit të Veternikut, sepse LDK-aj ka menduar t'i menaxhojë projektet me duar në xhepa, ndërsa "Vetëvendosje" duke qenë edhe kundër SHBA-ve, duke treguar kështu një padituri të theksuar, jo vetëm në agjendën e projekteve ekzistuese, por edhe në bllokim të tërë qytetit në sektorin e ndërtimeve.

"Vetëvendosje", në emër të vlerësimit të lejeve ndërtimore, e ka bllokuar tërë ndërtimin në kryeqytet, duke lënë pa punë hiç më pak se afro 60 mijë punëtorë të sektorit të ndërtimeve.

Pakënaqësitë e kompanive ndërtuese dhe të punëtorëve janë të mëdha për shkak të bllokadës anarkike që është vënë në kryeqytet nga udhëheqja aktuale e Komunës së Prishtinës edhe në sektorin e bllokimit të ndërtimeve publike, por edhe atyre private.

Ata që nuk i plotësojnë kushtet sa i përket bllokadës së ndërtimeve, sigurisht që do të duhej të merreshin në përgjegjësi. Pyetja ka qenë për ministrin, kur pritet të përfundojë ndërtimi i rrethrotullimit në Veternik dhe...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Mujota nuk është këtu. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Fadil Ismajli.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Së pari, mendoj që nuk ishte as në përputhje me Rregulloren, e as në rregull, që brenda pyetjeve parlamentare të bëhen pastaj edhe replika. Nuk është kjo praktikë. Po qe se është praktikë, atëherë duhet t'u jepet mundësia të replikojnë të gjithë, e jo vetëm një grupi parlamentar.

E dyta, ju e thatë, zoti Mujota, nuk ishte këtu për përgjigjen në pyetjen e Bekim Bexhiut. Fatkeqësisht, nuk është as Shpendi këtu për t'ia kthye përgjigjen, sepse ky ngriti edhe

çështje të Komunës që s'kanë të bëjë fare këtu me punën tonë si Kuvend dhe e kuptuam edhe një gjë që rrethrotullimi s'po u rregulluak për shkak se s'i paskemi punët mirë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por, po vazhdojmë me pyetjen, ta shikojmë tash si i ka punët Qeveria me Turqinë në këtë drejtim.

Më 8 maj bëhet një vit që kur kompania për distribuim edhe furnizim me energji elektrike ka kaluar në menaxhim privat, natyrisht pas një procesi jotransparent dhe jashtëzakonisht të diskutueshëm të privatizimit.

Edhe siç është thënë disa herë nga zyrtarët qeveritarë, e veçanërisht nga pararendësi juaj, zoti ministër, por edhe zoti Besim Beqaj, konsorciumi "Limak-Çalik" obligohet të investojë 300 milionë euro në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes për 15 vjet.

Po ashtu, atëbotë na është thanë se konsorciumi e ka pranuar në tërësi dhe është zotuar ta zbatojë planin për investime, të përpiluar nga ekspertët e KEK-ut, në kohën kur distribucioni ishte në pronësi publike. Kjo na është thënë në dëgjimet që i kemi pasur në komisionin hetimor për faturat e dhjetorit dhe të janarit.

Pyetja ime ministër është se a i keni mbikëqyrur investimet e kësaj ndërmarrjeje për këtë vit që po kompletohet tash dhe sa e ku kanë investuar ata gjatë këtij viti të menaxhimit?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar deputet!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Visar Ymeri,

Është e vërtetë se me rastin e privatizimit të Distribucionit dhe Shpërndarjes, ndër të tjera, ka qenë edhe kushti që në 15 vjetët e ardhshme do të investohen diku rreth 300 milionë, ndërsa i bie që të investohen diku rreth 20 milionë në vit.

Kompania e re private që e bëri privatizimin ka startua më 8 maj 2013 dhe gjatë vitit 2013 investimet e drejtpërdrejta nga kompania janë bërë diku 12,5 milionë, që domethënë ata kanë startuar diku në pothuajse gjysmën e vitit. Dhe, investimet e tërësishme, domethënë vazhdimi i investimeve që ka filluar edhe nga KEK-u për vitin 2013 janë diku 16 milionë, gjithnjë po flas me të dhënat dhe shënimet preliminare të marra nga KEDS-i, por shënimet të cilat sigurisht do t'i dëgjoni në raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, që së shpejti duhet të përfundojë, sepse ajo zyrë gjithashtu e ka për obligim ta përcjellë, monitorojë dhe kontrollojë performansën e operatorëve të sektorit të energjisë.

Ne, për hir të ndjeshmërisë së këtij procesi të privatizimit, kemi kërkuar nga ITC-ja që të vazhdojë monitorimi i implementimit të privatizimit për një vit dhe ne e kemi edhe njësinë, e cila po e përcjell në mënyrë që maksimalisht ta japim mbështetjen e duhur që ato kritere të cilat kanë qenë të parapara të përmbushen në tërësi.

Dhe, kjo sa u përket investimeve, domethënë jemi në linjë momentalisht. Sigurisht që këto investime do të ndikojnë edhe në zvogëlimin e humbjeve teknike, të cilat janë goxha të mëdha.

KRYESUESI: Deputet, pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, pjesa e dytë e pyetjes ishte sa dhe ku janë investuar, sa e dhatë, si përgjigje nga shënimet preliminare. Ku janë investuar ato, sepse sipas informatave që i kam unë, shumica e investimeve që janë bërë nga KEDS-i gjatë vitit 2013, pra në pjesën kur ai e ka pasur në menaxhim, janë me fakt investime që janë bartur prej KEK-ut, pra sikur ndryshimi i njehsorëve, sikur madje edhe ato kutitë ku janë vendosur njësorët kanë qenë tashmë të blera nga KEK-u, dhe ata i kanë gjetur aty të gatshme.

Investimi i vetëm, sipas punëtorëve tash po them, domethënë që është material i ri i blerë nga KEDS-i janë këta dryna me logon e KEDS-it, të cilat disa prej tyre i kanë vendosur nëpër trafostacione, dhe mbase këta dryna i zvogëlojnë humbjet, edhe pse mua nuk po më duket që do ta kenë një rol shumë të madh në zvogëlimin e humbjeve teknike, por ajo është çështje e një pyetjeje të dytë që e kam për ju.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit!

Vërtet nuk e kam listën e investimeve, por unë prandaj i theksova dy shifra. Domethënë, në tërësi investimet janë 16 milionë, që do të thotë pjesa prej 12,5 deri në 16 është pjesa e investimeve vërtet të KEK-ut, ato që kanë qenë të kontraktuara dhe ato që kanë qenë në implementim e sipër. Ndërsa 12,5 milionë janë investime të reja të drejtpërdrejta nga kompania private. Më jepni kohë që unë ta kërkoj edhe listën e saktë, edhe me fotografi, pse jo, të atyre që janë investuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, pyetje për ministrin Fadil Ismajli.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pyetja e dytë lidhet me një çështje të ngjashme. I përmendët, është thënë po ashtu në momentin e privatizimit, se gjatë vitit të parë kompania obligohet që t'i reduktojë humbjet për 3% dhe pastaj për çdo vit nga 2%. Kështu ka qenë plani i cili lidhet natyrisht edhe me skemën e investimeve, sepse humbjet nuk do të mund të reduktohen pa investuar në rrjet, kryesisht në transformatorë, kur e dimë që është problemi kryesor që i shkakton humbjet.

Pra, në këtë drejtim, a keni informata të na thoni nëse janë reduktuar humbjet teknike për 3% gjatë vitit 2013, ose më mirë thënë deri sot në momentin kur po flasim, me gjithë faktin që mund të mos i keni shënimet për këtë pjesë të vitit, pra për këta 4 muajt e vitit në të cilin kemi hyrë.

Po ashtu, për t'ia shtuar pyetjes mendoj që natyrisht që këtu do të vijnë të gjitha të raportuara në raportin vjetor që e sjell Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kuvend, mirëpo po ashtu mendoj që do të kishte qenë, ose do të duhej të ishte edhe obligim i Qeverisë, përkatësisht ministrisë suaj për ta mbikëqyrur funksionimin e kësaj kompanie sipas kontratës, kur e dimë që kushtëzimet që i janë vënë në kontratë kompanisë janë vënë nga Qeveria dhe rrjedhimisht Qeveria do të duhej të ishte mbikëqyrëse e zbatimit të kësaj kontrate.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit për pyetjen!

Po, është e vërtetë, siç e theksove, që kjo pyetje në esencë, adresa shumë më e saktë do të ishte Zyra e Rregullatorit të Energjisë, sepse ata edhe me ligj i kanë edhe kompetencat, edhe obligimin për ta përcjellë performansën e ndërmarrjeve.

Sidoqoftë, për hir, prapë po them, të asaj që ne kemi mbajtur mbikëqyrjen për një vit të implementimit, i kemi të dhënat.

Kjo nuk është që nga viti i parë. Vendimi i rregullatorit është i vitit 2011, që në esencë fillon të implementohet edhe për vitin 2012 dhe ajo është që në tre vjetët e para shpërndarja e furnizimi duhet t'i zvogëlojnë humbjet në tërësi nga 3%, ndërsa në tre vjetët pas kësaj nga 2,5%. Nëse kjo vlen diçka, unë kam qenë kundër kësaj. Personalisht ia kam dërguar edhe me shkrim se do të duhej të jetë e kundërta nga 2,5 pastaj në 3, po ky është vendim, të cilin e ka zbatuar.

KEK-u normalisht në vitin 2012 nuk e ka përmbushur si duhet këtë obligim dhe kjo pastaj përcillet edhe pas privatizimit, kështu që është e vërtetë se humbjet nuk janë plotësuar. Por, këtu ka një dallim. Cili është dallimi? Dallimi është se tani kompania private diferencën e mospërmbushjes së performansës e paguan nga paratë e freskëta nga ta, e jo ato para të merren nga konsumatori, e aq më pak, siç ka qenë përpara, shpeshherë edhe ky Parlament ka marrë vendim ta subvencionojë KEK-un, ndoshta edhe për joperformansën e duhur. Kështu që, kjo është.

Gëzon fakti se nëse e krahasojmë periudhën maj-dhjetor 2013 me periudhën maj-dhjetor 2012, humbjet janë zvogëluar 0,46 më shumë se në vitin 2012, që mund të konsiderohet një sinjal të themi i mirë relevant. Do të jetë viti 2014 sa do të jetë, a do ta arrijë cakun e duhur kompania private në KEK, apo jo.

Dhe, normalisht këtu i përmendët edhe investimet. Sigurisht që investimet ndikojnë dukshëm në zvogëlimin e humbjeve, por jo të humbjeve në tërësi, ndikojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe humbje shumë më të mëdha janë në linja se sa në transformatorë. Edhe këtë desha ta them. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Po, pyetja ime shtesë ka të bëjë me të njëjtën çështje. Meqenëse u përmend këtu sjellja e kapitalit të freskët, apo jo nga kompania, të gjithë e dimë që kjo nuk do të ndodhë, sepse kushtet e privatizimit, në njëfarë mënyre e kanë drejtuar një trajtim të tillë, meqenëse kompania do ta ketë mundësinë për shembull që 15 për vjet t'i bëjë këto investime dhe ato do të vijnë mbase nga një pjesë e profitit që realizohet këtu, por jo që është kapital i freskët që vjen nga jashtë në Kosovë, por do të jetë i gjeneruar nga brenda.

Dhe, e kemi tash të njëjtin problem, meqenëse e përmenda unë në deklarinimin jashtë rendit të ditës, kur rritja e pagave kushtëzohet me rritjen e të hyrave maksimale të lejuara nga kompania, gjë që është thënë edhe publikisht, mbase edhe jozyrtarisht nga kompania, vetëm desha të përmendi që për shembull për vitin 2013 kompania i ka diku 203 milionë euro të inkasuara, prej 217 milionë eurove të...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit!

Visar, t'i e di që ne mund të ulemi këmbëkryq dhe të bëjmë muhabet për këtë sa të duash dhe t'i sqarojmë bashkërisht. Po më vjen mirë shumë që je mirë i informuar për krejt këto.

Prapë po kthehem te ajo, po flet për investime. Nuk janë vetëm investimet ato që ndikojnë në zvogëlimin e humbjeve. Diferencë edhe sa i përket sjelljes së kapitalit të freskët. Ka një dallim: në qoftë se themi për 1% ose 2% humbjet, qofshin teknike, qofshin komerciale, duhet të mbulohen nga kapitali i freskët. Kjo vërtet qëndron, sepse askush nuk guxon të veprojë ndryshe. Do të thotë, edhe nëse kompania do të marrë kredi mbi bazën e rregullave të Rregullatorit për tarifën, nuk do t'i njihet në atë kredi. Po e zëmë se 20 milionë, ose 10 milionë nuk ka performuar në humbje kompania, nuk do t'i njihet, edhe në qoftë se merr kredi në bazë të elementit të ponderuar për çmimin e kapitalit.

Atëherë nuk do t'i njihet as interesi, as elementet tjera për këtë. Prandaj, është kapital i freskët, do të thotë ato humbje i mbulon vetë, gjë që nuk ka ndodhur përpara.

Në anën tjetër, është shumë më e rëndësishme që të zvogëlohen humbjet komerciale, ato të cilat vijnë nga abuzimi i njehsorëve, që vijnë nga abuzimi ose lidhjet ilegale, e kështu me radhë, dhe aty performansa do të vjen, se me investime normalisht që humbjet teknike do të zvogëlohen deri në kufirin e mundshëm teknik, por humbjet komerciale janë shumë më të rëndësishme dhe ato gjithashtu do t'i paguajë kompania nga kapitali i freskët, se s'ka nga i merr tjetër, nuk i pranohen tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! U krye çështja e pyetjeve. Zoti Haxhiu për procedurë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Pyetja ime ishte e qartë dhe kishte të bënte me një shqetësim të qytetarëve për problemin rreth rrotullimit të Vetërnikut. Ishte e drejtuar për ministrin Fehmi Mujota, e jo për shefin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”. Nuk e kam ditur që shefi i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” është zëdhënës i Fehmi Mujotës dhe është më se e qartë se edhe LDK-ja, edhe “Vetëvendosja” e kanë humbur rrugën në rrethrotullim.

KRYESUESI: Edhe ti, edhe Ismeti, ‘ma lëshuat mjekër’ për çështje të procedurës. Replikë, zoti Ymeri!

VISAR YMERI: Me gjasë, deputeti nuk më paska dëgjuar mirë. Unë i thashë që nuk është as Shpendi këtu për të të dhënë përgjigje për çështjet që i ngrite për Komunën. Nuk u bëra zëdhënës i askujt, madje as i Komunës, siç e kemi pasur praktikën me grupet tjera parlamentare kur bëhen zëdhënës të kryetarëve të komunave, që vijnë nga radhët e tyre.

E nëse do për rrethrotullimin, ti e di shumë mirë çka ka qenë problemi rreth rrethrotullimit - mosshpronësimi dhe refuzimi për ta rrëzuar pompën e ‘Kosova Petroll’, që pronësohet nga anëtari juaj, dhe tash ajo është rrëzuar dhe rrethrotullimi do të përfundojë, meqenëse po kërkon përgjigje.

KRYETARI: Po e lëmë, se është pika e pyetjeve dhe përgjigjeve, dhe besoj që e keni krye. Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Edhe zoti Isufi, besoj edhe ky si këta të dytë e ka procedurën. Zoti Isufi, e ke fjalën për procedurë, jo për replikë.

AHMET ISUFI: Tash vërtet për procedurë, zoti kryesues!

Kam propozim që pika e 13-të e rendit të ditës Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës të kalojë në pikën e pestë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju e keni si propozim të Grupit Parlamentar për pikën e katërt, pastaj kur të hyjmë te çështja e rendit të ditës. Ta miratojmë procesverbalin, pastaj i diskutojmë këto çështje që i kemi t’i diskutojmë.

Sipas informatës, në sallë janë 87 deputetë. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 10 prill 2014 dhe 17 prill 2014 dhe dy seancat e mbajtura më 23 prill 2014? Nuk ka vërejtje. Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 10 prill 2014 dhe më 17 prill 2014 si dhe të dy seancave të mbajtura më 23 prill 2014. Faleminderit!

Tani është radha e të paraqiturve, të cilët kanë kërkesa në emër të grupeve parlamentare. Është për rend dite. Është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Grabovci, ashtu siç u paraqit edhe zoti Isufi me mocionin e partisë...

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë propozoj për shkak të nevojës për të pasur konsultime të mëtutjeshme, për pikën 4 dhe pikën 13 të rendit të ditës, të hiqen sot dhe të mbeten për nesër për t'u shqyrtuar.

KRYESUESI: Domethënë pika 4 dhe pika 13. Atëherë për pikën 13 patëm realisht 2 mocione, një në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tani edhe zoti Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Unë kërkoj fjalën e zotit Jusufi nëse është dakord me propozimin e zotit Grabovci, që të mos i futim në votim të dyja me radhë. Faleminderit!

AHMET ISUFI: Zoti kryesues!

Meqë ka ndërlidhje pika 4 me pikën 13, nuk mund të ndahen si çështje të ndërlidhura ndërmjet tyre, atëherë nëse jemi për shtyrje duhet që të dyja pikat të shtyhen, ose të dyja pika të jenë të radhitura njëra pas tjetrës. Nëse është disponimi i deputetëve që të shtyhen, edhe ne jemi për, por, megjithatë, unë kërkoja që mos të jetë në pikën 13, sepse nuk ka kuptim të jetë në këtë pikë kjo temë.

KRYESUESI: Atëherë unë ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare që të deklarohen në emër të grupeve lidhur me propozimin e zotit Grabovci. Zoti Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Unë edhe sot po e përsëris qëndrimin e Grupit tonë Parlamentar që kurdo që të vihet të votohet për Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, ne do të votojmë dhe, nëse ka nevojë, siç u tha, të ketë konsultime, meqë unë normalisht nuk flas në emër të tjerëve, ne nuk kemi asgjë kundër që kjo të shqyrtohet nesër dhe ne do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Është shumë e qartë pse po kërkohet kjo të tërhiqet. Është diskutuar disa herë, është diskutuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për këtë mundësi. Pra, tërheqja po vjen si rrjedhojë e kushtëzimit që po e bëjnë veçanërisht dhe po më duket vetëm këtë herë deputetët që e përfaqësojnë pakicën serbe në Kosovë, dhe kjo po e pamundëson pastaj amendamentimin e Kushtetutës, për të cilën të gjitha forcat politike në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë dakorduar dhe janë shprehur për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, të cilat do ta mbronin sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit.

Mendoj se është momenti dhe natyrisht duhet të thuhet edhe nga të tjerët, do të kisha shpresuar të thuhet, se sa problematike po na paraqitet kjo vota e dyfishtë që na është imponuar dhe që po e dëshmon që në fakt ka rrezik ta bëjë tërë Kosovën jofunksionale për shkak se po i bën institucionet e Kosovës jofunksionale. Pra, ajo që po e nxit këtë jofunksionalitet, këtë pamundësi të institucioneve të vendosin për një çështje të rëndësishme jetike për vendin, është vota e dyfishtë, me të cilën po kushtëzohen amendamentet kushtetuese sot dhe me të cilën fatkeqësisht do të kushtëzohen edhe nesër.

Pra, këtë duhet ta kemi parasysh. Nuk po flas për ditën e nesërme, për të martën, që vendos të mbahet ose që u propozua të mbahet edhe një seancë, por që do të na ndjek gjatë tërë viteve për sa kohë që e mbajnë si kategori kushtetuese këtë padrejtësi që na është imponuar.

Çështja tjetër është pastaj që e keni parë edhe ju nëpërmjet medieve, deputetët e pakicës serbe, për këtë vendim të tyre po konsultohen edhe me Qeverinë në Beograd, që i bie në fakt që Beogradi po vendos nëse Kosova duhet t'i ketë forcat e veta të armatosura, apo jo. Pra, a po e shihni se këto aranzhime institucionale dhe politike, të cilat i keni mbrojtur me ngulm, edhe ju këtu në Kuvend, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe për të cilat keni thënë që nuk do të paraqesin kurrfarë problemi për Kosovën dhe për ndërtimin e saj si shtet të pavarur dhe sovran, se si po e bëjnë gradualisht Beogradin faktor vendimmarrës në institucionet e Kosovës, duke e bërë faktor vendimmarrës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kosova nuk mund të përparojë kurrë, as të ndërtohet si republikë, nëse për këtë duhet ta marrë lejen nga Beogradi, sepse e dimë që Beogradi këtë e kundërshton kategorikisht dhe, rrjedhimisht, ne duhet si institucione të insistojmë që amendamentimet kushtetuese të bëhen nga Kuvendi, e nëse ato nuk bëhen nga Kuvendi, atëherë ekziston referendumi ku me votë popullore do t'i bëjmë ato amendamente kushtetuese për të cilat ka interes jetik për vendin dhe të cilat i kërkojnë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pra, kjo është mundësia që na lejohet me Kushtetutë dhe ne si forca politike duhet të insistojmë në këtë. Pra, të mos bëjmë pazare me Forcat e Armatosura të Kosovës si një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për vendin dhe, në anën tjetër, me vendet e rezervuara që e cungon dhe e lufton pikërisht idenë e republikës si barazi të qytetarëve pranë institucioneve dhe pranë ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Siç u tha edhe më përpara, kjo temë është diskutuar më herët. Mua më duhet të them se për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës është jashtëzakonisht e rëndësishme që të kemi forca të armatosura dhe ushtri. Është tepër e qartë që sot nuk ka kushte që të votohet, dhe kjo mund të jetë arsyeja kryesore pse po shtyhet.

Me siguri se aranzhmanet kushtetuese janë goxha të zorshme, por nëse votojmë tani, këto janë ato rregulla, sipas të cilave votojmë dhe sot nuk mund të votojmë. Duhet të shpresojmë që nesër mund ta bëjmë një gjë të tillë. Edhe në mbledhjen e Kryesisë, ku të gjithë kolegët kanë qenë të pranishëm, e dinë se kam kërkuar që të ketë komunikim dhe të ketë harmonizim paraprak për shkak se nuk mund të ndodhë që një kuvend i cilësdo republikë që po përmendet ta ndryshojë Kushtetutën e vet vetëm duke e nxjerrë një letër para deputetëve.

Kushtetutat nuk ndërrohen lehtë dhe duhet tepër shumë punë paraprake për të mbërri deri te ndryshimi i Kushtetutës. Nuk e di nëse Qeveria me partnerët e vet të koalicionit e ka kryer një punë të tillë.

Sidoqoftë, edhe një herë po them - nuk mund të hidhet në votim sot dhe ne nuk kemi as çka diskutojmë. Nëse e hedhim në votë, bie ndryshimi i Kushtetutës, kështu që e lëmë për nesër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për Qeverinë dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se është e dyta herë që këto amendamente të Kushtetutës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Forcën e Armatosur vijnë në Kuvend dhe tërhiqen, unë nga këtu apeloj te liderët e partive politike që njëherë të bëhet marrëveshja ndërmjet subjekteve politike dhe subjekteve të minoriteteve, se u fol edhe nga parafolësi Gjini që nuk është e lehtë të ndryshohen amendamentet e Kushtetutës, kur dihet se na duhen 2/3 e minoriteteve, vota e dyfishtë e tyre, dhe në rast se ne hyjmë në këtë lojë, po e shtyjme sot, votojmë nesër, unë po ju them këtu publikisht se as nesër nuk do t mund të votohet. Mund ta luajmë lojën ‘pingpong’ sot nesër dhe të shohim se si po shkon procedura.

Jemi që sot të tërhiqet nga rendi i ditës, mirëpo po ju them nuk mund të shtyhet kjo pa një marrëveshje të tillë ndërmjet liderëve.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Başkan vekili, değerli Bakanlar, Sayın Milletvekiller

“6+” Parlamenter Gurubu olarak daha önce de ifade ettiğimiz gibi, Kosova açısından son derece önemli olan Kosova Silahlı Güçlerinin kurulması nı desteklemekteyiz. Fakat, sizin de bildiğiniz gibi topluluklar olarak bir dönem daha yedek yerlerin devam etmesi için Anayasal değişikliğin yapılması gerekiyor. Madem ki bu değişiklikler gerekecek önerilen teklif de önümüzdeki günlerde bunun oylanması bizim yine talebimiz devam edecektir. Biz hiçbir şekilde pazarlık yapmıyoruz, biz tamamıyla Kosovanın orduya sahip olmasını destekliyoruz, fakat bunun karşılığında yine toplulukların talebi olan yedek yerlerin de tüm partiler tarafından bir dönem daha desteklenmesini beklemekteyiz. Bu hiçbir zaman bir pazarlık sözkonusu değildir. İster yarın, ister önümüzdeki hafta istediği tarihte bu yasayı topluluklar olarak destekleyeceğimizi ifade ediyorum. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. E hedh në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, të bërë nga zoti Grabovci, në mbështetje pothuajse të të gjitha grupeve parlamentare për t’i shtyrë pikat 4 dhe 13 për nesër ose pasnesër. E shohim në Kryesi, kur ta marrim vendimin.

Në sallë janë 92 deputetë. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se me 83 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së që të shtyhen pikat 4 dhe 13 për nesër.

Vazhdojmë me pikën e pestë, siç ka qenë e renditur në rendin e ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit

Ky projektligj është propozuar nga iniciativa qytetare, e mbështetur nga mbi 10 000 qytetarë. Nënshkrimet e qytetarëve për këtë listë legislative janë verifikuar nga KQZ-ja konform Ligjit për nismat legislative.

Qeveria e Kosovës brenda afatit të përcaktuar e ka dërguar mendimin lidhur me këtë projektligj dhe ka shprehur qëndrimin kundër ndryshimit dhe plotësimit të paragrafit 2 dhe nenit 9 të Ligjit për kontrollin e duhanit. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Të nderuar deputetë,

Pas paraqitjes së projektligjit, hap projekt debatin për diskutim në parim. Sipas radhës, kryetari i Komisionit Funkcional për Shëndetësi dhe Punë dhe Mirëqenie Sociale, zotit Damka.

Ju kisha lutur për qetësi në sallë, meqë besoj që jemi në punë, e jo në Pazar!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2014, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 45 të Rregullores të Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit. Plotësim-ndryshimi i këtij projektligji ka të bëjë me nenin 9, paragrafi 2 të ligjit, i cili nen ka ndaluar ekspozimin e produkteve të duhanit në pikat e shitjes. Shqetësimet pas aprovimit të këtij ligji kanë qenë të shumta, si nga shoqëria civile, bizneset, po ashtu edhe nga odat ekonomike, të cilat operojnë në Kosovë. Ne si grup parlamentar konsiderojmë se ky nen e ka dëmtuar konkurrencën e lirë, nuk mundëson dhe pengon shitjen e rregullt të duhanit nëpër pikat e shitjes.

Duke marrë për bazë këta faktorë shqetësues, ne si grup parlamentar i japim përkrahje këtij plotësim-ndryshimi të ligjit dhe njëherësh ftojme edhe deputetët që ta miratojnë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Të nderuara deputetë!

I nderuari kryesues,

I nderuari ministër,

Ne me kujdes të posaçëm e kemi lexuar iniciativën apo nismën qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit, si dhe shkresat përcjellëse që i janë bashkangjitur kësaj iniciative, e që janë përpiluar nga zyrtarët ligjorë të ministrive përkatëse, si një lloj kundërpërgjigje ndaj kërkesës së qytetarëve.

Nga leximi i këtyre shkresave mund të kuptohet se mbështetësit e nismës apo qytetarët që e përkrahin këtë iniciativë kërkojnë që të ndryshohet paragrafi 2 i nenit 9 të Ligjit për kontrollin e duhanit, duke propozuar që ky paragraf, ndër të tjera, ta përmbajë edhe këtë formulim: “Shitësit të cilët nuk e kanë të ndaluar për të shitur duhanin, mund t’i ekspozojnë këto produkte në hapësirën e veprimtarisë tregtare për të vazhduar më tutje me një lloj restriksioni të ekspozimit të këtyre produkteve me dispozitën: Produktet e duhanit do të vendosen në shitje në një mënyrë që ato mos të jenë të dukshme për publikun e gjerë jashtë pikës së shitjes dhe atë vetëm një pako nga secili lloj i produkteve”.

Përkrahësit e nismës, propozimin e tyre, ndër të tjera, e arsyetojnë edhe me faktin se sipas legjislacionit aktual të Bashkimit Evropian, konkretisht me direktivën 2001/37ec, nuk rregullohet fare mënyra e shfaqjes së produkteve të duhanit në pikat e shitjes. Sipas propozuesit, direktiva mbulon disa fusha të tjera nga kjo sferë, si për shembull: etiketimin, përshkrimi i produkteve, lista përbërëse e tjera.

Në anën tjetër, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë, në përgjigjen e vet lidhur me këtë propozim, jep përfundimin, sipas të cilit kjo ministri shpreh qëndrimin kundër ndryshim-plotësimit të paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit mbi kontrollin e duhanit.

Kjo ministri arsyeton se reklamimi dhe shfaqja e produkteve të duhanit në pikat e shitjes ka efekt direkt në shëndetin publik. Pastaj arsye tjetër që e theksojnë është se sipas tyre reklamat në pikat e shitjes rritin eksperimentimin dhe fillimin e përdorimit të duhanit tek të rinjtë.

Sipas mendimit tonë të Grupit Parlamentar të LDK-së, këto arsye nuk janë aq bindëse për ne që të mos aprovohen propozimet për ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit mbi duhanin, sepse, nëse vërtet kjo ministri brengoset aq shumë për shëndetin publik, dhe nëse shfaqja e produkteve të duhanit paska efekt direkt në shëndetin publik, atëherë pyes se çfarë efekti ka e gjithë ajo papastërti nëpër klinikat tona, duke filluar nga tualetet, banjat, korridoret e deri te dhomat, shtretërit dhe mbulesat e pacientëve. Dhe, vërtet, nëse brengoset kaq shumë për shëndetin publik, fillimisht le t'i eliminojë këto të meta dhe papastërti në objektet tona shëndetësore, e më pastaj ta ndalojë ekspozimin e duhanit.

Çështja tjetër është se në shkresën e propozuesit përdoret shprehja “ekspozim i duhanit”, kurse në shkresën e ministrisë shprehja “reklamim”, që mendoj se këto dy shprehje dallojnë ndërmjet veti, se me reklamë zakonisht synohet t'i tërhiqet vëmendja dikujt që nuk është i interesuar, kurse me ekspozim të njoftohet dikush që dëshiron të dijë nëse ka ndonjë lloj duhani apo jo.

Dhe, çështja e fundit sipas Ministrisë të Shëndetësisë, nëse duhani reklamohet në pikat e shitjes, rritet fillimi i rritjes së duhanit te të rinjtë. Ky arsyetim nuk më duket aq bindës, sepse të dhënat dhe studimet e ndryshme tregojnë se numri i narkomanëve në Kosovë po rritet dita-ditës, ndërsa droga dehëse nuk ekspozohet, respektivisht nuk reklamohet askund. Andaj, ky fakt më shtyn të dyshoj në një arsyetim të tillë se ekspozimi po ndikua në rritjen e numrit të duhanxhinjve, sepse, sipas mendimit tim, janë faktorët tjerë që ndikojnë në rritjen e kësaj dukurie, e jo ekspozimi i duhanit.

Pikërisht për këto dhe arsye të theksuara më lart, ne si grup parlamentar do ta votojmë propozimin e iniciativës së qytetarëve për ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit mbi kontrollimin e duhanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Jam pak i habitur me qëndrimin e zotit Demolli për arsye se në komision, kur kemi diskutuar për këtë çështje, përfaqësuesit e LDK-së kanë qenë kundër këtij vendimi. Megjithatë, konsideroj që nisma legjislative e shoqatës së tregtisë me pakicë në Odën Ekonomike të Kosovës është një shembull në kuptimin e marrjes së iniciativës - një shembull i mirë. Kjo iniciativë shqyrton dy çështje kryesore: ekspozimin apo reklamimin e duhanit, që është e njëjta gjë, dhe qëllimi tjetër është përfitimi i klientëve të rinj nga industria e duhanit.

Arsyetimi për humbjet ekonomike të shitësve me pakicë përdoret si një prej argumenteve kryesore, me shpresë që për shkak të situatës së popullsisë në Kosovë, numri i përkrahësve të kësaj iniciative do të jetë më i madh. Në mungesë të studimeve të sakta,

hipoteza se ndalimi i ekspozimit të duhanit ul vendet e punës nuk është e vërtetuar. E para, nuk ka studime për këtë çështje dhe, e dyta, koha prej hyrjes në fuqi të ligjit e deri më sot është tepër e shkurtër për të bërë studime të tilla.

Po ta marrim për një moment se hipoteza qëndron, pavarësisht se nuk ka hulumtime, nëse votojmë kundër reklamimit të duhanit, disa qytetarë ndoshta do të mbeten pa punë. Unë kam parasysh një mik timin, i cili shet vetëm duhan në shitoren e tij, e kur hyn aty duket sikur ai po shet perde, e jo duhan.

Sigurisht që në rastet e tilla kur shitoret shesin vetëm duhan, kjo mund ta rrezikojë ndonjë vend të punës, por nëse e shikojmë kështu me saktësi situatën, deri më sot asnjë qytetar në Kosovë, me gjithë gjendjen e rëndë ekonomike, nuk ka vdekur për shkak të urisë apo të papunësisë, por ajo që dihet është që shumë qytetarë në Kosovë kanë vdekur për shkak të pirjes së duhanit. Ndërmjet mbetjes së papunë të pak qytetarëve për shkak të ndalesës së reklamimit të duhanit dhe vdekjes të shumë qytetarëve për shkak të pirjes së duhanit, unë votoj për të parën.

Humbjet ekonomike, nëse të tilla ka, nuk duhet shikuar vetëm nga interesi i një grupi, por duhet shikuar nga interesi kombëtar. Në të gjitha studimet, kudo që janë bërë në botë tregojnë se për shkak të konsumimit të duhanit, E kemi një rritje enorme të kostos për shërbime shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Vetëm një përkujtim - para disa muajsh, kur kemi diskutuar për këtë Ligj, paTa thënë se ndalimi i ekspozimit të duhanit do ta ketë një efekt, do t'i diskriminojë ata që paguajnë taksa për këtë produkt dhe do t'i favorizojë ata që nuk paguajnë taksa.

Domethënë është krejt e qartë për ta kuptuar qëllimin e ministrit, edhe të deputetëve, që sa më pak njerëz në Kosovë të konsumojnë duhan. Duhet të pajtoheni se ky është një qëllim fisnik, një qëllim për të mirën e vendit, por kur bëjmë ligje duhet të shohim pak më gjer se sa vetëm çka po duam të bëjmë dhe të kuptojmë që të vendosim një cak është krejt ndryshe prej rrugës të cilën duhet bërë deri te arritja e atij caku.

Pse kam thënë kështu? Ju lutem, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, zoti ministër, dilni rreth e rreth Kuvendit! Vetëm dilni dhe shëtitni rreth e rreth kuvendit, shiheni sa njerëz shesin duhan me kuti! Dilni në cilindo kafeteri ose bar në Kosovë edhe shiheni sa fëmijë ju ofrohen me ato kuti që shesin duhan! Silluni nëpër gjithë Kosovën dhe shihni se qysh shitet duhani në Kosovë! Edhe atëherë para kërkuar, nuk mund të ndalohet ekspozimi nëpër dyqane dhe supermarkete ku paguhet taksa, pa qenë në gjendje për ta eliminuar stërshitjen e duhanit, se nuk është në rregull, se ajo çka po bën Kuvendi, me një qëllim të mirë, është që po i diskriminon ata që po paguajnë taksë, e po i favorizon

këta që nuk po paguajnë takse për një produkt që esencialisht nuk është i ndaluar në Kosovë.

Duhani nuk është i ndaluar që të shitet. Është i lejuar të shitet dhe kjo është ajo për të cilin kemi fol më herët dhe kjo është ajo për të cilin po flas edhe sot. Domethënë është evidente që duhet ta mbështetim këtë iniciativë, jo vetëm pse ka ardhur prej shumë njerëzve, por për shkak se nuk kemi qenë të aftë, ose nuk kemi rrethana në Kosovë që këta fëmijë që shesin duhan me kutia, t'i punësojmë diku tjetër ose t'u krijojmë kushte tjera për jetë në mënyrë që në Kosovë të mos ekspozohet duhani askund.

Ajo që kemi arritur të bëjmë deri tash është ta mbyllim ekspozimin nëpër supermarkete të mëdha edhe ta lejojmë për t'u shitur rrugëve. Domethënë, nuk ka individ në Kosovë, prej moshës minore deri tek pleq që nuk është i ekspozuar ndaj produkteve të duhanit për shkak se ato ekspozohen gjatë gjithë kohës. Dhe nuk guxojmë ne tash të pretendojmë që Kosova është diçka abstrakte ose hipotetike. Kosova është reale kjo që e kemi, duhet të synojmë ta bëjmë më të mirë, por nuk guxojmë të pretendojmë se kemi bërë diçka të mëdha përderisa po e shohim se çka po na ndodh.

Ne do ta votojmë ndryshimin e këtij ligji, në lexim të parë sot do të shohim se cilat variante mund të gjenden prapë që ky ligj të jetë më i mirë. Ju kujtohet se në diskutimin tim për këtë ligj ju kam pas propozuar që edhe zonat ku pihet duhani të jenë të caktuara dhe të paguajnë taksa më shumë ose baret ose restorantet. Është hedhur poshtë nga Kuvendi ky propozim, zoti ministër po ju tregoj diku 80% të restoranteve dhe të barëve në Kosovë pihet duhani, është e pamundshme për inspektorët ta ndalojnë duke pasur parasysh të gjitha rrethanat jo veç pse pihet edhe prapë edhe ky provizion ka pësuar kolaps për shkak se ne kemi pretenduar të bëjmë diçka shumë më tepër se sa që realisht mundemi.

Do të thotë e kemi vendosur cakun që është i mirë, një cak fisnik, por nuk e kemi gjetur rrugën qysh të shkojmë prej këtu ku jemi deri te caku po shihet që ka pësuar kolaps. Nuk ka qenë dëshirë e jona të pësojë kolaps, po ka qenë ndoshta jo profeci, por diçka që e kemi pasur të qartë se do të ndodh duke i pasur parasysh rrethanat të cilat ekzistojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zoti Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar

Fillimisht para se t'i shpreh shqetësimet e mija të Grupit Parlamentar për këtë iniciativë dua t'iu informoj edhe juve edhe Kuvendin e Kosovës, edhe opinion e gjerë se një iniciativë e tillë e cila ka ardhur për ndryshimin e këtij neni të këtij projektligji, neni 9, paragrafi 2 nuk është iniciativë e qytetarëve.

Qysh në fillim e shohim se është bërë manipulim dhe synohet të vihen në lajthitje deputetët e Kuvendit të Kosovës, qytetarët s'e kanë marrë këtë iniciativë. E ka marrë

industria e duhanit këtë iniciativë dhe nuk e ka pasur vështirë t' i mbledhë 10 mijë nënshkrime duke pasur parasysh se kemi sot në tregun e Kosovës, shumica e dyqaneve edhe shitësve merren me shitje të duhanit. Prandaj, kjo është manipulim që bëhet me Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, nuk është iniciativë qytetare, është iniciativë e industrisë së duhanit.

Dhe, kjo është lajthitja që synohet të bëhet këtu në Kuvendin e Kosovës, e para, e dyta pa dyshim që edhe kur e kemi votuar këtë për herë të parë këtu në Kuvendin e Kosovës i cili ka hyrë ky ligj në fuqi askush nuk ka vë dilemma se është një ligj i mirë dhe mbron shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës dhe nuk e cenon shitjen e duhanit, produkteve të saj në Kosovë.

Por, do të shihni se kurrkund në botë, kurrkund në rajon nuk e kemi një gjë të tillë se pasi ka hyrë një ligj në fuqi pas 2 muajve ende pa filluar të zbatohet mirë ky projektligj i cili ka vështirësi kërkohet të ndryshohet ky projektligj. Kjo është absurde çka ndodh në Kosovë, do të thotë hala pa u bërë 2 muaj.

Ne të gjithë e dimë se ka filluar me hapa të mirë, drejtë zbatimin e këtij projektligji e shihni se shumë markete të ndryshme, shumë dyqane jo vetëm që i kanë mbuluar, por kanë vendosur pengesa metalike në formë të perdes e cila e mbulon produktet e duhanit dhe kjo është duke ngritje e sipër duke u zbatuar ky projektligj dita ditës dhe më mirë.

Por, po e them prapë implikimi i industrisë së duhanit, implikimi i shitësve, qoftë legal dhe jo legal ka bërë që ne edhe Kuvendi të lajthitet, ka bërë fatkeqësisht që ky ligj të mos jetë funksional në tërë territorin e Kosovës dhe tash së fundi do të kërkojnë që të ndryshojnë përmes procedurës së tyre ligjore.

Shpeshherë ne si Kuvendi i Kosovës thirrmi në legjislacionin e Bashkimit Evropian, praktikat e Bashkimit Evropian. Nëse jemi për praktikat e Bashkimit Evropian, mirë po e bëjmë qysh e ka Bashkimi Evropian të rregulluar, ta rregullojmë edhe ne.

Të jemi të bindur se nëse një praktikë të tillë Bashkimit Evropian në Kosovë e sjellim do të pësojë kolaps industria e duhanit në Kosovë. Pse? Nuk kanë të drejtë dyqanet ushqimore, marketet e ndryshme të shesin duhan. Te ne nuk ka dyqan që nuk shet duhan përveç në furra të bukës nuk kam parë. Në çdo dyqan, çdo pompë e benzinës, çdo dyqan tjetër, rrugë dhe jashtë rrugës kanë që shesin duhan dhe me këtë projektligj nuk iu është ndaluar shitja atyre, çka po doni më tepër. Ata kanë të drejtë të shesin, por janë përcaktuar disa masa që në të mirë të shëndetit publik që të pengohet ekspozimi i tyre.

Jemi të vetëdijshëm që në shumë zona rurale ka dyqane e markete dhe për t'ua lehtësuar qytetarëve, banorëve të atij vendbanimi iu është mundësuar shitja e tyre dhe nuk iu është ndaluar shitja e duhanit, ndërsa në vendet e Bashkimit Evropian në dyqane te tilla nuk shesin duhan.

Janë dyqanet e specializuara që shumica prej jush e keni parë janë Tubaco Shop, do të thotë dyqanet e duhanit. Nëse ne e bëmë një praktikë të tillë, atëherë çka do të bënë industria e duhanit.

E tjetra çka është mjaft shqetësuese, është se paradoksi i madh që shumë disa deputetë bien pre e kësaj iniciative të një industrie të duhanit e cila, qëllim kryesor e ka edhe përfitimin material të saj asgjë tjetër nuk ju intereson këtyre. Ne si deputetë kur i kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës këtë projektligj e kemi pasur bazë një parim edhe ai duhet të vlejë gjithmonë, shëndeti publik i qytetarëve të Kosovës i cili përmes këtij projektligji synohet, të ruhet, të mbrohet dhe të promovohet.

Mos të harrojmë se kategoritë ma të rrezikuara nga ky nen i cili po synon të ndryshohet dhe qëllimi është i qartë, është përfitimi duhanpirësve të rinj e kryesisht ata më të rrezikuarit janë moshat e reja, adoleshentet, e shkollave fillore dhe të mesme të cilët në momentin e hyrjes së markete të ndryshme për produkte ushqimore do t'u ekspozohen drejtpërdrejtë produkteve të duhanit dhe deshtë e pa deshtë e blejnë.

Pse lypin këta ta reklamojnë këtë? Është e qartë, mos harroni se kokakola është produkti më i shitur në botë, por ajo vazhdimisht vazhdon të jetë aktuale në tregun e botës me reklama ma të fuqishme se reklama e bënë të veten, edhe këta dëshirojnë që me reklamat e tyre të jenë vazhdimisht prezent edhe te moshat ma të rrezikuara të adoleshentët dhe te gratë shtatzëna. Prandaj, është e papranueshme ne si Kuvend i Kosovës të bëmë në lajthitje me këtë, të bëmë pre kësaj lajthitje të industrisë së duhanit e cila në emër të qytetarëve të Kosovës synon ta ndryshojë këtë projektligj i cili ende nuk ka filluar t'i marrë këmbët e veta, nuk ka ma shumë se dy muaj që ka filluar të zbatohet në praktikë dhe duke zbatuar dita-ditës edhe ma mirë e ma shumë.

Prandaj është e papranueshme si Kuvend i Kosovës të biem pre e një iniciative të industrisë së duhanit e cila parim kryesor e ka përfitimin material dhe fatkeqësisht e shkatërron shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës. Ne si grup parlamentar do ta votojmë kundër ashtu sikur edhe herën e parë kur ka kaluar ky projektligj, kur është votuar në Kuvendin e Kosovës, prandaj ftoj të gjithë deputetët që të mendojnë vetëm për shëndetin e qytetarëve të Kosovës, ngase pasojat e trajtimit vetëm të një pacienti janë sa përfitimi disamujor i disa bizneseve të vogla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Industri të duhanit nuk ka në Kosovë por tregtarë të duhanit. "6+" nuk ka kërkuar fjalë. Fjalën e ka ministri, në rregull përfaqësuesi i qeverisë.

MINISTRI FERID AGANI:Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë sikur e ka shprehur edhe përmes përgjigjes për Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, është kategorikisht kundër çfarëdo ndryshimi të Ligjit për kontrollin e duhanit nr. 04/L-156 dhe u bënë thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos i nënshtrohem presionit të industrisë së duhanit për të ndryshuar nenin 9.2 dhe 9.3 të këtij ligji, i cili ndalon paraqitjen apo ekspozimin e produkteve të duhanit në pikat e shitjes.

Ligji për kontrollin e duhanit, i cili hyri në fuqi më 22 maj 2013 ka sjellë një ndryshim pozitiv në politikat e mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës duke e mbrojtur atë nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të tij.

Ligji për kontrollin e duhanit i cili hyri në fuqi, më 22 maj 2013 është një ndryshim pozitiv në kulturën qytetëruese të vendit tonë, arsyetimet e iniciativës qytetare për ndryshim dhe plotësimin e paragrafit 2 dhe 3 të nenit 9 të Ligjit për kontrollin e duhanit se ky paragraf qenka në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, janë të pabazuara, për arsye se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore përfshirë edhe lirinë komerciale kur ajo është në interes publik të përcaktuar me ligj.

Për më tepër, kjo nismë për ndryshimin e një neni që të gjithë jemi dëshmitarë se po zbatohet me korrektësi të madhe nga ana e bizneseve për Ministrinë e Shëndetësisë, por edhe për koalicionin anti- duhan dhe përfaqësuesit tjerë të shoqërisë civile ku ka një përfaqësim shumë të mirë edhe të organizatave ndërkombëtare, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në veçanti, të cilat veprojnë në Kosovë, e paraqet një kthim prapa dhe kjo duhet të jetë e qartë për gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, se votimi i këtij projektligji që është në vullnetin e juaj politik, e paraqet qartë një kthim prapa në politikat e kontrollit të duhanit dhe të mbrojtjes së shëndetit publik në çfarëdo arsyesimesh që mund t'i përdorni.

Përfundimisht nuk ka asnjë argument të qëndrueshëm që mund të rrëzojë interesin për shëndetin publik të qytetarëve, dhe si i tillë nuk duhet të pranohet në asnjë mënyrë nga ju të nderuar deputetë, sepse ishit po ju ata që vetë një ditë më parë, në miratimin e këtij ligji i dhatë mundësi qytetarit vendit që të frymojnë lirisht dhe të jenë të mbrojtur nga tymi i duhanit në hapësirat e tyre të punës, në shkolla, në kafe-bare edhe restorante dhe në vende tjera publike.

Përfundimisht është e pavërtetë se në kafe-bare dhe në këto hapësira konsumohet duhani 80%, mua më vjen shumë keq për ata të cilët kanë pritur një gjë të tillë që të ndodhë, por jemi dëshmitarë të përditshëm që veçanërisht në qendrat e mëdha rajonale dhe në kryeqytet, kjo nuk është e vërtetë, pjesën më të madhe të tyre dhe për këtë duhet të jemi të gjithë krenarë, sepse kemi arritur që të realizojmë një synim qytetërues, një synim evropian.

Jam i bindur se ju si deputetë dhe Kuvendi i Kosovës si tërësi, nuk do të lejoni që të preket një ligj kaq i mirëpritur nga të gjitha shtresat shoqërore në vend, bazuar në një nismë kryekëput të lidhur për interesa komerciale të industrisë së duhanit, kjo duhet të jetë e qartë. Çfarëdo retorike politike që e përdorni për të arsyetuar një mënyrë ose tjetër është e kotë, sepse bëhet fjalë kryekëput për interesat komerciale të industrisë së duhanit, e cila pa u bërë as dy muaj të plotë prej hyrjes në fuqi të ligjit, iu drejtua Kuvendit për ta ndryshuar këtë ligj, pa e kryer asnjë hulumtim rreth efekteve të këtij neni dhe pretendimet e paargumentuara se ndalimi i ekspozimit të duhanit gjoja i paska dëmtuar bizneset.

Ju lutem, të nderuar deputetë, keni parasysh këtë fakt, vetëm 2 muaj pasi që ka hyrë në fuqi ligji, është bërë nisma, pa bërë asnjë analizë, ky fakt nuk guxon që të anashkalohej nga ana e juaj. Unë pres që ju do të jeni në nivelin e detyrës suaj, ashtu siç keni qenë në nivelin e detyrës së juaj edhe në rastin e votimit të këtij amendamenti vitin e kaluar, kur ju e keni votuar një amendament i cili nuk e kishte propozuar Komisioni Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky amendament nuk ka qenë i propozuar nga komisioni parlamentar dhe ju si deputetë e keni votuar, e keni treguar shkallën e lartë të pjekurisë suaj politike dhe përgjegjësinë e juaj ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mendoj që këtë do ta bëni edhe sot me refuzimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Dëshiroj të shpreh shqetësimin tim personal sa i përket ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për kontrollin e duhanit. Ligji aktual paraqet avancim sa i përket politikave të kontrollit të duhanit dhe mbrojtjes së shëndetit të popullatës në përgjithësi.

Megjithatë vërejtjet e mia serioze mbeten tek implementimi jo i plotë, gjegjësisht mosrespektimi i ligjit, posaçërisht sa i përket tymosjes së duhanit në objekte publike e sidomos nëpër kafiteritë anë e mbanë të Kosovës.

Lidhur me kërkesën e nismës së qytetarëve për ndryshimin e ligjit, të përbërë kryesisht nga anëtarët e shitësve me pakicë duke u referuar gjithnjë në dokumentacionin që ma kanë ofruar, në arsyetimin e tyre vërejtja kryesore ishin humbjet që kanë pësuar ata për shkak të rënies së shitjes e cila sipas tyre ka shkuar në favor të shitësve të ambulant ilegal.

Prandaj konsideroj se Shoqata e shitësve të vegjël do të duhej të fokusohet dhe të kërkonte nga organet kompetente që të mos lejojnë veprimtarinë ilegale të shitësve ambulantë. Shitësit ambulantë kanë vepruara edhe para implementimit të këtij ligji, nuk është se ata duken më shumë apo kanë filluar të veprojnë vetëm pasi është implementuar ky ligj. Prandaj, kam përshtypjen se diçka jo e sqartë shihet prapa kësaj kërke.

Nga pikëpamja ime mosekspozimi i duhanit në vendet e shitjes është një ndër masat për zvogëlimin e konsumit të duhanit e veçanërisht për të rinjtë, gjegjësisht duhanpirësit e rinj eventualë.

Përndryshe, kjo masë nuk është shpikur për herë të parë nga ne, kjo ka filluar më herët edhe në vendet tjera dhe gjithsesi është bërë pas hulumtimeve me numër të madh respondentësh.

Duke qenë mbështetëse e një rinie dhe popullate të shëndoshë, do të përkrah çdo procedurë ligjore, që shkon në të mirë të kësaj. Prandaj, në funksion të gjithë kësaj që thashë unë do të votoj kundër amendamenteve të propozuara nga kjo nismë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU – KODRA: Faleminderit, kryesues!

Pajtohem plotësisht me kolegen Bakalli meqë ne vitin e kaluar do të thotë kemi aprovuar ligjin për kontrollin e duhanit dhe pothuajse shumica e deputetëve në Kuvend jemi shprehur pro dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit publik e në veçanti sa i përket ndalesës së konsumit të produkteve të duhanit në hapësira të mbyllura publike.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit ka pasur edhe polemika dhe do të thotë edhe debate të shumta nga tregtarët lidhur me nenin 9.2. të ligjit, që ka të bëjë me ndalimin e dispozitave të produkteve të duhanit nëpër pikat e shitjes.

Nëpër kutitë postare, besoj që shumica e deputetëve kanë marrë do të thotë tri letra nga tregtarë dhe njëren, më duket që është nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, përfaqësues të së cilëve thonë që bizneset e tyre, do të thotë janë dëmtuar, konkretisht me nenin 9.2. të ligjit.

Të gjitha këto institucionet thonë se janë dëmtuar nga ky nen dhe se për këtë është bërë edhe peticioni me dhjetëmijë nënshkrime, që i është drejtuar Kuvendit të Kosovës.

Në anën tjetër ne kemi edhe koalicionin anti-duhan të Kosovës, që përfaqësohet në më shumë se 20 subjekte qeveritare dhe joqeveritare, si dhe përfaqësues të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, të cilët janë shprehur kategorikisht kundër ndryshimit të Ligjit për kontroll të duhanit. Ata po vlerësojnë se ky ndryshim do të jetë në dëm të shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Meqë jam në Komisionin për Integritet Evropian do të ndaj me ju, që praktika të tilla do të thotë, në shtetet evropiane, që janë të rregulluara me këto çështje, janë Britania, Irlanda dhe Norvegjia si dhe tash së fundi është shteti i Kroacisë, i cili do të thotë, ka vendosur që të mos ekspozojë duhanin nëpër hapësirat e shitjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Për mua është krejt e kuptueshme pse kaq shpejt erdhi koha për ndryshimin e Ligjit për kontrollin e duhanit. Kjo ka ndodhur për shkak se kemi miratuar një ligj, i cili nuk ka qenë i mirë për të gjithë, përkatësisht në mënyrë të padrejtë dhe diskriminues, i cili ka goditur një pjesë të qytetarëve dhe të bizneseve.

Prandaj, ai edhe duhet të ndryshohet, së paku deri në masën sa propozohet sot me iniciativën e qytetarëve që janë mbi 10 mijë nënshkrime.

Këto ndryshime nuk besoj se do të pengojnë në arritjen e qëllimit kryesor që ky ligj, atij për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Po ashtu duhet të kemi parasysh edhe faktin se deri më tash se ky ligj nuk ka arritur efektet e dëshiruara. Nuk ka vend konsumi i duhanit dhe i cigareve, së paku nëse bazohemi në shifrat për sasinë e importuara të këtyre produkteve deri më sot. Nuk kemi asnjë analizë që do të na bindë se ka rënë konsumi i duhanit dhe i cigareve të gjeneratave të reja, përkatësisht të ato të moshës së adoleshencës.

Mirëpo, duken qartë efektet e dëmshme që ka pasur ai ligj, ndalimi i konsumit të cigareve në 100% të hapësirave publike ka imponuar që bizneset e vogla të hotelierisë, improvizojnë hapësira për duhanpirësit duke i detyruar ata të bëjnë shpenzime të tepërta, si dhe duke bërë ndërtime provizore, të cilat kanë shëmtuar pamjen e objekteve dhe të rrugëve të qyteteve.

Ligji për disa biznese ka pasur kosto të lartë, meqenëse ato përherë kanë qenë në shënjestër të inspektoratit, ose ka edhe të tilla që lejojnë pirjen e cigareve, duke pranuar rrezikun për gjobitje, për arsye të biznesit të tyre, që u ka rënë biznesi.

Ata kanë deklaruar se më mirë e kanë të paguajnë një gjobë, se sa të largojnë klientët dhe me këtë kam parë që edhe i kanë mbyllur bizneset e tyre.

Pra, duke miratuar këtë ligj ne kemi ndëshkuar bizneset apo kemi detyruar që ata të sillen në mënyrë të paligjshme. Së bashku me propozimet për ndryshimin e këtij ligji kemi edhe mendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, sipas të cilit vërehet se ajo është në qëndrimin se nuk duhet të ndryshojë asnjë fjalë e këtij ligji. Madje, për të na bindur ligji është i mirë, po përmenden edhe disa shtete të cilat kanë ligj të njëjtë sikur të ne. Mirëpo, nuk e thonë se i njëjti ligj nuk aplikohet në tërë zonën e Bashkimit Evropian, por nuk e përmend as faktin se Evropa është më liberale sa i përket kontrollit të duhanit.

Nuk mund të jenë model Islanda e Norvegjia, meqenëse pikërisht këto dy shtete kanë ndryshime esenciale në raport me Kosovën, si nga aspekti i zhvillimit ekonomik, standardet e jetesës, por edhe të mbrojtjes shëndetësore të popullatës, po nuk përmendet Austria dhe Gjermania, ku lejohet konsumi i duhanit në vende të veçanta, pastaj Bullgaria, ku duhani lejohet në hapësira që kanë ventilime adekuate, Greqia, ku mundësia për të krijuar vende për duhanpirës, rregullohet me leje të posaçme, Franca që lejon krijimin e mjediseve të veçanta, por jo më të mëdha se 20% e totalit ku ndalohet hyrja për persona nën 16 vjet, Rumania ku 50% e sipërfaqes nëpër lokale hoteliere mund të rregullohet për duhanpirës, por me kusht që t'i kenë ventilimet e veçanta dhe adekuate që i pranon timin e duhanit dhe e qet jashtë, apo Britania e Madhe e cila aplikon ndalimin e plotë të duhanit, lejon konsumin e tij nëpër hotele, por vetëm në dhomat e ndërtuara enkas për duhanpirësit dhe mysafirët e tyre.

Derisa të jetë jetëgjatë ligji janë anëtarët e Bashkimit Evropian, kjo tregon qartë se BE-ja nuk ka një standard unik rreth duhanit, përkatësisht u lejohet vendeve anëtare që të aplikojnë modalitete të ndryshme. Kjo qasje ka të bëjë edhe me trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve, meqenëse me ndalimin e duhanit përderisa favorizohet, një kategori e qytetarëve, një tjetër diskriminohet. Këtë element e bart edhe ky ligj që kemi ne.

I përmenda këto raste për të përfunduar se ndryshimet e propozuara janë minimumi i asaj që duhet ndërhyrë në këtë ligj, në fakt ligjit i duhen edhe ndryshime më të mëdha. Me miratimin e ndryshimit të propozuar ne duam të korrigjojmë një nen, që ka ndëshkuar mbi 4 mijë biznese të vogla rreth 12 mijë punëtorë.

Nuk mendoj se heqja e ndalesës së ekspozimit të cigareve do të nxisë duhanpirjen më të madhe në Kosovë. Ekspozimi, padyshim se duhet të përcillet edhe me masa të tjera, e posaçërisht me ndalesën që cigaret t'u shiten personave nën moshën 18-vjeçare.

Kjo ndalesë në mënyrë rigoroze duhet të respektohet nga të gjithë tregtarët. Ekspozimi i duhanit është në të gjitha vendet e rajonit edhe në Bashkimin Evropian.

Të nderuar deputetë, në Aeroportin e Prishtinës nuk ekspozohet duhani dhe nuk ka vend ku duhet të pihet duhani.

Të nderuar deputetë, në cilin aeroport të Evropës nuk ekspozohet duhani dhe nuk mund të pihet duhan. I kanë vendet e caktuara për pirjen e duhanit.

Po ashtu, inspektorati duhet të ndërmarrë diçka që edhe shitësit ambulantë të cigareve e të mos jenë persona të mitur, pa marrë parasysh se pjesa më e madhe e tyre këtë punë e bëjnë për ekzistencë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mendoj që krahasimi i biznesit të vogël në Kosovë dhe biznesit në Bashkimin Evropian është njëfarë demagogjie, është krejt e pandershme, sidomos kur kemi parasysh faktin se pikërisht bizneset e vogla ose ato dyqanet dhe çdonjëri nga ne e ka një mik, një anëtar të familjes, një të njohur, i cili mban një dyqan dhe sa herë që e vizitojmë e shohim që kriza ekonomike në këtë vend po thellohet dhe ajo shihet pikërisht në ato raftet me pluhur të dyqaneve të vogla, të cilëve u ka rënë shitja, sidomos viteve të fundit, për shkak të rritjes së konkurrencës dhe zhvillimit të qendrave të mëdha tregtare.

Prandaj, çka kemi mbërri ne me këtë ligj, kemi mbërri që njerëz të cilët punojnë me orare të stërzgjatura dhe mezi mbajnë familjet e tyre, t'i rëndojmë përmes një neni, i cili nuk e ka pakësuar pirjen ose konsumin e duhanit, por në fakt ka bërë që ai të ekspozohet në rrugë, të ekspozohet nga shitësit ilegalë, të cilët po ashtu janë problem i shoqërisë, sepse ata do të ndalen atëherë kur ne t'u gjejmë vende pune. Dhe, deri më tani s'e kanë bërë institucionet, prandaj ata janë në rrugë dhe shesin në mënyrë ilegale.

Po në anën tjetër, i kemi dëmtuar tepër rëndë ata që shesin në mënyrë legale dhe paguajnë taksa. Do të thotë, kemi arritur që të sjellim në këtë krizën e madhe ekonomike në Kosovë të shtojmë edhe një gur që kjo krizë të thellohet dhe t'i rëndojë ata më të dobëtit dhe ata më të vegjlit. Dhe, në këtë rast unë po dua të them që nuk bëhet fjalë për industrinë e duhanit në Kosovë, se i kam mbi njëzet letra, letra të shkruara nga komuna e Istogut dhe dëgjova që edhe deputetë tjerë kanë marrë letra nga biznese të vogla të

komunave të tyre, të cilët absolutisht nuk janë industri e duhanit, por janë dyqane të vogla nëpër fshatra, të cilët mbijetojnë përmes shitjes së pakove të cigareve dhe përmes shitjeve të tjera, të cilëve ne me këtë nen u kemi pamundësuar funksionimin e biznesit tepër të vogël, përmes të cilit ata mbijetojnë.

Dhe, ministër, mendoj që shëndeti publik është edhe mirëqenia e këtyre njerëzve, e këtyre bizneseve të vogla, fëmijëve të tyre, familjeve të tyre, dhe përderisa ne nuk kemi gjetur një zgjidhje tjetër dhe ata rrezikohen, konsideroj që ndryshimi i këtij neni në fakt nuk është ndryshim i cili do të përkrahë cilëndo industri të duhanit, sepse ne s'kemi industri të duhanit në Kosovë, u tha, por, do t'i përkrahë këto biznese të vogla të cilat duhet të përkrahen ose do të mbyllen dhe atëherë çështja e tyre, e familjeve të tyre, fëmijëve të tyre do të kalojë në një problem social dhe në një problem, të cilin ne si shtet nuk do të mund ta zgjidhim, sepse edhe kështu skemat sociale në Kosovë janë tepër të mëdha dhe po rriten përditë.

Prandaj, të mendojmë për të vegjlit, ata të cilët janë rrezikuar në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që kërkesa ka ardhur dhe është nënshkruar nga qytetarët e Republikës së Kosovës, po dihet nga kush është iniciuar dhe kë e përfaqësojnë këta aktorë nënshkrues të këtij peticioni, rrjedhimisht të këtij ligji të cilin e kanë prurë këtu.

Ju rikujtoj se në momentin kur është votuar ky ligj nga ne në Kuvendin e Kosovës, shumë nga mediet dolën dhe bënë anketa me qytetarë dhe biznese të ndryshme dhe të gjithë u përgëzuan dhe e mirëpritën këtë ligj, të cilin e miratoi Kuvendi i Kosovës, bile edhe vetë duhanpirësit thanë, se mirë na e keni bërë, sepse ndryshe nuk po e lëmë pirjen e duhanit dhe e dimë efektin e dëmshëm që e ka pirja e duhanit.

Qytetarët, është e vërtetë se paguajnë taksa, për ta ruajtur shëndetin e tyre dhe për ta rritur kualitetin e jetës dhe nuk paguajnë taksa për t'u dëmtuar ata në shëndetin e tyre.

U përmend këtu se janë shtuar shitësit nëpër rrugë që shesin duhan dhe unë kujtoj se shteti duhet të hapë vende pune e jo të lejojë shitjen e duhanit me kuti nëpër rrugë nga fëmijët skamnorë.

Është shumë e qartë se ligji nuk e ndalon shitjen e duhanit, por është duke lejuar ekspozimin e duhanit nëpër vende ku shitet për ta ruajtur shëndetin publik të qytetarëve. Fatkeqësisht, ne duhet të jemi shembull e jo shkelës të ligjeve, por që një ligj të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratuar, të gjithë e dimë se sa respektohet ky ligj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, apo edhe nga vetë administrata e Kuvendit.

Pyes veten dhe juve, sa deputetë kanë lajmëruar shkeljen e ligjit, respektivisht të këtij ligji, të dispozitave të këtij ligji. Pse ky ndryshim kaq i shpejt i joni, prej një vendimi të cilin e kemi marrë jo larg, pra nuk i ka as gjysmë viti.

Ligji është në faza të implementimit, bile kjo dispozitë është duke u zbatuar 100%. Pra duhet të mendojmë për shëndetin e qytetarëve e jo për përfitimet e bizneseve, të cilat shesin duhan apo të industrisë së duhanit.

Përfitimet janë më të mëdha duke e ruajtur shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani, a është këtu?

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe ne deputetëve na ka ardhur shkresa nga biznese të ndryshme të komunës së Prizrenit dhe kanë kërkuar që pikërisht për ta ndryshuar nenin 9 pikën 2, të shitjes për duhanin.

Mendoj që ekspozimi i duhanit nëpër gjithë Evropën bëhet nëpër vende të caktuara, nuk është vetëm në një vend, ose i mbyllur.

Secili kemi udhëtuar me aeroplan dhe nëpër frishopët e tyre i kemi vendet e caktuara ta shitjes të pambuluara, pa asgjë, prandaj, mbulimi edhe ekspozimi vetëm që e ka lejuar kontrabandën dhe këtë kanë kërkuar bizneset e ndryshme, që ta ndihmojmë ne me këtë.

Prandaj, ky ndryshim i këtij e lejon mundësinë e shitjes legale, në vende të caktuara dhe ikjes së kontrabandës së duhanit.

Ne kemi mjaft shkresa që kanë ardhur nga biznese të ndryshme, të cilët janë duke u përballur me gjitha këto vështirësi dhe ky ndryshim dhe ato që thanë edhe deputetët tjerë, besoj se është në të mirën e qytetarëve, të biznesit. Ndërsa, i mundësohet që fëmijët t'i ikin pjesës së tregut të duhanit, që janë duke e bërë. Prandaj, kërkoj që këto vërejtje që kanë ardhur edhe nga bizneset dhe që u thanë këtu, të realizohen, të amendamentohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Ajo që është evidente, është evidente që ka mungesë të vendeve të reja të punës. Është evidente që çdo vit shtohet numri i të papunëve dhe shtohet mungesa e mirëqenies për qytetarët e Kosovës. Dhe, ajo mungesë e mirëqenies nuk mund të kompensohet me shitjen e duhanit. Mendoj që mungesa e perspektivës dhe zhvillimit ekonomik qëndron krejt diku tjetër, qëndron në paaftësinë e kësaj qeverie, fatbardhësisht në ikje, që të krijojë vende të punës e të mos i lejojë, që të mos i vë në pozitë ata qytetarë që varen prej shitjes së një paqete të duhanit, apo të kenë rafte të pluhurosura, apo qysh u tha.

Raftet e pluhurosura nuk janë për shkak të mungesës së ekspozimit të duhanit, por janë për shkak të mungesës së mirëqenies edhe mungesës së zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të pandërprerë të vendeve të punës. Këtu është problemi, nuk është problemi të ekspozimi i disa kutive më tepër, apo më pak. Nuk do ta heqë pluhurin prej dyqaneve ekspozimi i kutive, do ta heqë pluhurin largimi i qeverisë dhe ardhja e qeverisë, e cila do të ketë zhvillim ekonomik, hapjen e fabrikave e të vendeve të reja të punës. Atëherë, njerëzit nuk do të kenë më mundësi që të varen prej një paqete duhani e tjera...

Kur ka ardhur ky ligj për kontrollin e duhanit kam qenë shumë e lumtur. Kam qenë e lumtur dhe kam pritur që ky të respektohet. Edhe kam pritur që komisioni para se të merret me ndryshim-plotësimin e ligjit, të merret me implementimin e këtij ligji, si po implementohet ky ligj. Në fakt, ne që nuk e pimë duhanin, mendoj që kam kujtuar që kemi ardhur deri në atë lirinë që të mos jemi në vendin ku jashtëqitjet tymore të duhanpirësve të jenë ata që dhunojnë lirinë time për të marrë frymë lirisht.

Prandaj, mendoj që ky ligj është dashur që të shikohet se si po implementohet. Në fakt, e dimë realitetin, që rrugët janë plotë me njerëz të cilët shesin duhan, ku ekspozohet e gjithë paleta e kutive të ndryshme të duhanit. E dimë që nëpër shitoret e vogla, përsëri vazhdon ekspozimi i plotë i këtyre.

Nëpër lokale, fatkeqësisht çdo ditë e më tepër po shtohet numri i lokaleve, ku nuk mund të hyhet, sepse vazhdon pirja e duhanit dhe dhunimi i të drejtës së joduhani-pirësve. Prandaj, para se të vinte ky ligj, i cili do të ndryshojë vetëm një pjesë të një neni, do të duhej që ky komision i cili është marrë më këtë, që të kërkonte se si po implementohet ky ligj dhe të na sillte raportin e implementimit të ligjit.

Unë para disa kohësh, isha në Amerikë dhe e fotografova një shenjë, ku thuhet që është e ndaluar pirja e duhanit në ndërtesë, bile edhe jashtë ndërtesave, 25 fita, ajo i bie diku 8 metra larg hyrjeve, larg garazheve, larg të gjitha hapësirave të hapura, të cilat shërbejnë për biznes të atyre kompanive, atyre shitoreve.

Prandaj, mendoj që ndoshta mund të themi, edhe pse nuk besoj që ekziston ndonjë analizë që ka ardhur deri te ulja, te rënia e shitjes në dyqane, por unë besoj që ka ardhur deri te rritja nëpër farmaci, të citostatikëve apo të barërave kundër sëmundjeve të mushkërive dhe rritje e biznesit të ordinancave që merren me këtë.

Prandaj, dëshiroj t'ju them edhe atyre që më kanë dërguar edhe mua sikur të gjithë tjerëve, letra me të cilat kërkojnë që të bëhet ekspozimi i këtyre. Dëshiroj t'ju tregoj se mungesa e vendeve tuaja të punës, që fëmijët e juaj nuk vuajnë për shkak të disa kutive të cilat ju do t'i qitni atje, por fëmijët dhe familja juaj dhe mirëqenia juaj nuk varet prej duhanit, por varet prej mungesës së zhvillimit ekonomik, mungesës së rritjes së mirëqenies suaj, mungesës së ideve se si të zhvillohet ky vend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Padyshim, që po kemi pasur rast të dëgjojmë edhe analiza goxha emocionuese në kohën kur para pak muajsh e kemi pasur të njëjtin projektligj. Është mirë të jemi në temë. Nuk besoj që Qeveria tash duhet adresuar edhe për çështje të tilla, siç është edhe mënyra e shitjes së duhanit edhe në këto dyqanet me pluhur e pa pluhur.

Unë më shumë se sa për kompetencën, po ndiej obligim moral, për t'u prononcuar, sepse kam qenë pjesë e debatit kur e kemi amendamentuar këtë ligj para pak muajsh.

Mendoj që një presion i tillë është legjitim i atyre që dëshirojnë ta ndryshojnë prapë ligjin, i atyre që merren me këtë biznes, por nuk mendoj që për kaq kohë të shkurtër institucionet përgjegjëse kanë arritur të sjellin informacione të duhura në këtë Kuvend për të argumentuar një proces të tillë.

Zoti Ministër, komplimente për angazhimin tuaj. Kam qenë dhe jam për këtë ligj, por është dashur mos me të lënë vetë sot këtu edhe ministri i Tregtisë e Industrisë, të sjellë disa të dhëna për tregun, për të argumentuar që nuk ka ndikuar keq, s'pati kur të ndikojë keq ky projektligj ose mënyra e shitjes së cigareve nëpër dyqane tona me pluhur edhe nëpër marketet e mëdha.

Një ministër tjetër të argumentojë pastaj anën e ekonomisë formale se sa ka ndikuar që të shtohet numri i atyre që shesin me këto paketa rrugës apo është zvogëluar, statistika të doganave. Pra edhe informacionet tjera nga Enti Statistikor e tjerë, për të ardhur në një përfundim të logjikshëm, një përfundim që nuk e dëmton askënd, as prodhuesit, as ata që tregtojnë, as ata qytetarë që konsumojnë, e tjerë, e tjerë...

Sot ne nuk i kemi këto informacione, jemi kthyer në një debat në pikën e atëhershme, në pikën zero dhe mendoj se po shtyhem, se kush te kush ka pasur ndikim, ata që e kanë nisur atë peticion, që i kanë marrë këto nënshkrime, pa e nënçmuar, duke respektuar të gjithë ata që kanë vënë një nënshkrim aty ku kanë shkuar të blejnë një pako cigare, ata që e pinë duhanin.

Po ju siguroj, zoti Ministër dhe kolegë deputetë, që një fuqi të tillë publike mund ta kenë po aq, ndoshta edhe më tepër, një numër i madh i organizatave të shoqërisë civile të përgjegjshme dhe me angazhime për ta mbrojtur shëndetin publik.

Mendoj se qysh nesër disa organizata mund të bëhen bashkë për të nisur të marrin disa mijëra nënshkrime, të nisin për ta ndryshuar prapë projektligjin që po supozoj, do të mund ta ndryshojmë ne sot.

Prandaj, kisha kërkuar nga ju, që këtë projektligj mos ta bëjmë amendamentimin tash, për ta pritur zbatimin e tij. Nuk duhet të jemi skeptik për zbatimin e ligjit. Edhe unë ju rikujtoj debatin që e kemi pasur atëherë. Qysh atëherë ka pasur skepticizëm se nuk mund të zbatohet ligji.

Vitin e kaluar dhe dy vjetët e fundit, ky Kuvend ka miratuar një varg ligjesh, të cilat kanë qenë të harmonizuara me politikat e BE-së dhe legjislacionin e BE-së për të siguruar një

treg të lirë, një treg më të mirë dhe me politika më të lehta për tregun në Kosovë. Aspak kjo mënyrë e shitjes së duhanit nuk e ka penguar tregun e lirë dhe nuk kemi të dhëna, nëse nga ana e konkurrencës është dëmtuar dhe se ndonjë ligj tjetër nuk është respektuar, e tjerë, e tjerë...

Pra, mendoj që është shumë herët dhe mendoj që kemi shumë punë për të bërë për të ardhur deri te të dhëna reale, se a duhet të ndërrohet ky projektligj apo jo. Ndërmjet asaj, se paskemi një dëmtim të bizneseve të vogla, po u diskutua këtu sikur duhani u ndalua për t'u shitur në Kosovë. Krejt ato dyqane me pluhur e pa pluhur shesin cigare.

Nuk duhet të krijohet një imazh që nuk është real, në fakt, në Kosovë. Ideja është për të krijuar ligje, të cilat kishin mundur të zvogëlojnë numrin e atyre që pinë duhan dhe për të krijuar një imazh më të mirë në shtëpitë tona, në dyqane, në rrugë, në institucione, e tjerë dhe mundësisht për të pasur më pak të sëmurë nga kanceri.

Zoti ministër, ju i dini më mirë, por shifrat na thonë që kemi rritje të numrit të atyre që janë të sëmurë nga kanceri. Edhe këto informacione do të duhej të na vinin këtu në Kuvend.

Pra, mendoj që është shumë herët dhe mendoj se ky projektligj aspak nuk është koha tash të trajtohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Që në fillim po ceku se duhani ka mbi 4 000 substanca helmuese, prej të cilave është vërtetuar shkencërisht që mbi 100 janë kancerogjene.

Qëllimi i këtij ligji, gjegjësisht i kësaj kërkesë për të ndërruar këtë ligj, unë mendoj se nuk është qëllimi vetëm te neni 9.2, sepse fundi i fundit nuk është ai që dëmton as kompaninë, as palën tjetër aq shumë, por qëllimi është te ndërrimi i ligjit në mënyrë që të zhvleftësohet ligji, sepse në momentin kur pas 2 muaj ditësh ne ndërrojmë ligjin, automatikisht te qytetarët dërgojmë një mesazh të keq, që ne kemi gabuar atë ditë: “ju lutemi të na falni që kemi gabuar dhe ju vazhdoni të pini duhan”.

Nuk është e vërtetë që i ka dëmtuar duhanpirësit ky ligj, sepse unë jam i sigurt, ka edhe këtu në këtë Kuvend plot duhanpirës dhe unë i kisha pyetur sinqerisht, a e ka ndërprerë dikush pirjen e duhanit prej këtyre duhanpirësve pse s’e ka ditur se ku duhet të shkojë e të gjejë duhanin, apo nuk ka mundur të furnizohet me duhan? Unë jam i sigurt që jo.

Dikush i përmendi edhe vendet e punës, që janë zvogëluar vendet e punës. Unë mendoj se, në qoftë se ne kemi të dhëna statistikore aq të sofistikuar, që për dy muaj na japin të dhënat e sakta, se sa është zvogëluar buxheti i kompanive që merren me shitjen e duhanit, atëherë ne mund të lavdërohem për statistikën shumë të saktë që i kemi. Por, unë besoj që nuk ka mundur të bëhet një diçka.

A janë dëmtuar kompanitë? Ne duhet të jemi shumë të qartë. Këtu janë dy palë, të cilat nuk mund të ruhen edhe njëra edhe tjetra. Ose duhet të dëmtohen pak kompanitë, ose duhet të dëmtohen qytetarët e posaçërisht moshat e reja. Tash mbetet në duart tona, si kuvendarë, si deputetë, a jemi për pak më shumë para për kompanitë dhe ndoshta edhe për Qeverinë, apo jemi për pak më shumë shëndet?

U përmendën ligjet e Evropës, u përmendën të gjitha andej e këndeje, ne i kemi specifikat tona. Ne e dini, deri tash kur janë ndarë 5 milionë euro, që janë folur të ndahen, njerëzit, është detyruar me qitë dorën në rrugë për të kërkuar para për mjekim. Ne nuk e kemi atë mundësi që t'i çojmë të gjithë ata që janë me sëmundje malinje, se padyshim i shkakton pirja e duhanit, jo i vetmi shkaktar, ka edhe plotë shkaktarë të tjerë, por kjo i ndihmon shumë.

Andaj, ne është mirë ta bëjmë atë që mund ta bëjmë. U përmend që ka rënë pirja e duhanit. Bëhuni të bindur, që ky nen nuk e ka dëmtuar shumë shitjen e duhanit, e ka dëmtuar propaganda që është bërë në medie. Ka pasur shumë takime, shumë ligjërata dhe qytetarët kanë filluar të vetëdijesohen dhe ky ligj nuk kishte mundur për t'u zbatuar ashtu qysh po zbatohet sot, hiqi disa mangësi të cilat nuk janë pengesë e këtij ligji, por janë edhe të dikastereve tjerë të Qeverisë, që ky ligj nuk po funksionalizohet aq sa duhet.

Prandaj, edhe njëherë po them, sot është në ndërgjegjen tonë, a jemi për pak më shumë para për kompanitë, apo jemi për pak më shumë shëndet për qytetarët, posaçërisht për fëmijët? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është më se evidente se edhe kur kemi trajtuar Ligjin për kontrollin e duhanit, ligji herën e kaluar ka pasur shumë debate rreth kësaj teme dhe në veçanti rreth nenit 9.2 dhe nenit përmes të cilit ndalohet konsumimi i duhanit në objekte të mbyllura, ashtu sikur ky ligj, ky nen tani ka ardhur përmes iniciativës qytetare, unë besoj që shumë shpejt edhe neni tjetër, i cili e sanksionon saktë që konsumimi i duhanit të ndalohet në ambiente të mbyllura.

Ka pasur shumë debate në atë periudhë kohore dhe atëherë kam deklaruar, që në njëfarë forme kjo çështja e duhanit tek shqiptarët ka qenë edhe si çështje nderi. Është bërë nder në mes dikujt, është qitur cigarja. Mirëpo, le që është ndaluar tani me këtë formë, me këtë ligjin e ministrit të Shëndetësisë edhe çështja e nderimit të dikujt, mirëpo edhe pse dihet qartë se duhani dëmton shëndetin, tani vërehet që është bërë edhe një dëmtim i bizneseve të vogla dhe ashtu si edhe kolegët tjerë deputetë edhe unë kam marrë në postën time në Kuvend një numër të madh të shkresave nga qytetarët, të cilët kërkojnë që ky nen të hiqet. Dhe, në bazë të informatave që kam dhe në bazë të asaj që është parë në medie,

shihet qartë se ka filluar një kontrabandim i duhanit bazuar në raportet policore dhe të doganave prej se ka filluar të zbatohet ky nen.

Unë kam marrë në postën time në Kuvend, disa prej tyre, një shkresë të pronarit të firmës “Kioska-Bina” të Hadije Veselit, të Hysni Behramit, domethënë të kompanisë NPT V&H Vushtrri, të Ismet Ademit të kompanisë 3-shi, të Behxhet Maliqit, të kompanisë “Binaku”, të Bahri Tahirit, të kompanisë Valoni, të Hajdin Abazit, të Kompanisë “Monte Karlo”, të Shaban Dërgutit, të kompanisë Leutrimi, Mbretëresha Teutë, të Ilir Azemit, Korabit... dhe këta deklarojnë kështu, po i përgjigjem ministrit, besoj ndoshta edhe ministri ka marrë këto shkresa, se janë pronarë të biznesit të vogël dhe punojnë me orar të zgjatur dhe për tu ofruar një jetë më të mirë për qytetarë, por besoni se ekonomia aktuale në Kosovë e bën shumë të vështirë këtë, prandaj vendosa t’ju shkruaj këtë letër dhe të kërkoj që neni 9.2 të ndryshohet. Gjithashtu, kemi marrë edhe një shkresë të Odës Ekonomike Amerikane, prandaj mendoj që ne këtu si deputetë jemi për të bërë ligje të përshtatshme dhe për të qenë në shërbim të qytetarëve dhe për të mos dëmtuar bizneset e tyre, mirëpo për të stimuluar bizneset e tyre.

Se si dikush, a do ta parapëlqejë të ndërpresë pirjen e duhanit apo nuk do ta parapëlqejë pirjen e duhanit, se a do të stimulohet kjo çështje me një reklamim të tij në dyqanin e tij apo jo, unë mendoj që është krejtësisht jo etike që cilido produkt qoftë ai, qoftë produkt i duhanit apo çfarëdo produkti tjetër, ai i cili shitet nën tezgë pa pasur mundësinë qytetari që ta shohë atë, është një stimulim i kontrabandimit dhe mundësisë për të manipuluar dhe për të krijuar një jo transparencë të theksuar në tregun e Kosovës.

Mendoj që duhet përkrahur kjo iniciativë e qytetarëve, për arsye se është në interesin e tyre dhe unë po besoj shumë, që edhe gjatë trajtimit të këtij ligji, duhet të kërkohej edhe nëse nuk do të ketë një dëgjim publik, do kërkohej nga aktorët e në veçanti nga dyqanet dhe restorantet, që edhe neni tjetër të plotësohet dhe të ndryshohet, për shkak se ne po shohim e mund t’ia bëj qejfin vetes ministri, se është duke u respektuar ligji për duhanin, mirëpo është më se evidente që kemi një respektim të pjesshëm në kryeqytet, mirëpo në viset rurale ligji është duke u shkelur me të madhe dhe ka një mosrespektim.

Ne duhet të bëjmë ligje të cilat janë të përshtatshme për qytetarët e Kosovës, të cilat janë të zbatueshme, jo ligje të cilat nuk mund të respektohen apo nuk mund të zbatohen në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po më çudit pse aq nguti për ndryshimin e një neni të një ligji, i cili ka disa muaj që ka filluar të implementohet.

Sa hulumtime janë bërë se çka janë mangësitë dhe çka janë ato anët pozitive që vijnë nga implementimi i këtij ligji, kush ka arritur t'i bëjë këto hulumtime dhe të dalë me një propozim?

Unë këtë nuk e marr si propozim të qytetarëve, si iniciativë të qytetarëve. Këtë ndryshim e marr si iniciativë të bizneseve që merren me shitjen e duhanit për arsye se i prek në disa gjëra të cilat për mua peshojnë shumë më shumë se sa një biznes i duhanit.

Ndryshimi i pikës 2 të nenit 9 do të ndikojë direkt në rritjen e numrit të përdoruesve të rinj, domethënë do të ndikojë direkt në përdorimin e duhanit nga ana e të rinjve dhe adoleshentëve. Të rinjtë dhe adoleshentët domethënë janë një moshë specifike ku kureshtja është ajo që ata i shtyn të provojnë shumë gjëra të cilat i shohin me sy. Kurrejshtja është ajo që do t'i shtynë ata që të fillojnë përdorimin e duhanit. Pse ta pengojë biznesin aq shumë mbulimi domethënë i ekspozimit të duhanit. Me këtë ligj nuk ndalohet shitja e duhanit, por vetëm ndalohet ekspozimi. Me një mbishkrim në ato vende ku shihet duhani se në këtë lokal shitet duhani ai që përdorë duhanin e din se në atë vend shitet duhani dhe do ta kërkojë nga shitësi që ta shohë se çfarë lloji të duhanit e kanë, e cila është e mbuluar për përdoruesit e rinj, për adoleshentët dhe të rinjtë, edhe në këtë mënyrë dot ë ndikojë, domethënë që të mos fillojë një përdorues i ri i duhanit.

Me këtë nuk do të parandalohet 100% që përdoruesit e rinj të fillojnë përdorimin e duhanit se janë edhe shumë faktorë tjerë që ndikojnë në këtë, mirëpo do të ndikojë direkt në uljen e numrit të përdoruesve të rinj.

Unë me profesion jam mjekë dhe asnjëherë nuk do të votoj diçka që e di se do ta dëmtojë shëndetin publik.

Unë nuk e di, kolegët e mi, se a e dinë se sa kushton mjekimi, trajtimi i një pacienti që ka kancer, që lidhet direkt me përdoruesin aktiv apo pasiv të duhanit.? Unë nuk e di se a e dinë kolegët e mi se sa kushton rehabilitimi i një pacientit nga trajtimi në qoftë se arrin të trajtohet nga kanceri.

Un nuk e di a e dinë kolegët e mi se sa i kushton një familje kur ka një pacient, një individ, një anëtar të familjes së sëmurë nga kanceri.

Është jo vetëm ana financiare, por është edhe ana sociale, ana psikike që ndikon, do të thotë në familje, që një familje të mos ketë mirëqenien e duhur në qoftë se e ka një anëtar të sëmurë nga kanceri.

Unë e pashë këtu, disa kolegë të mi veç nisën me iniciativa të reja, mbasi në qoftë se shpresoj se ky nen, ky ndryshim nuk do të kalojë, por edhe në qoftë se do të kalojë shumë shpejt do të na vjen iniciativë tjetër e bizneseve, mund të them se jo “iniciativë e qytetarëve” që të lejohen edhe hapësirat se ku do të përdoret duhani.

Kështu që unë e mbështes edhe një herë haptas do me thënë qëndrimin tim që e kam pasur në komision se jam kundër ndryshimit të këtij neni dhe i ftoj të gjithë deputetët kolegët e mi që ta votojnë kundër.

Më kishte ardhur çudi shumë në qoftë se kolegët e mi mjekë dhe punëtorët shëndetësorë do ta votojnë një ndryshim të tillë, sepse ata vetë e dinë se sa është i dëmshëm përdorimi i duhanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, ke të drejtë në replikë nëse ta ka përendur emrin a diçka, po s'po e di pse. Për duhan jemi, të gjithë e dimë çka është ajo punë, a po din, dhe kush dikë e kanë shtirë, pra ata që shesin duhan të votojnë për e dikë ashtu. Ne po diskutojmë. Duhani duhet të jetë monopol shteti dhe duhet të jetë i kontrolluar më së pari nga shteti e jo nga tregtarët. Për duhanin duhet ta dimë origjinën ku prodhohet dhe përmes kujt po blihet dhe ku po blihet, e pastaj këto tjerat të dyqaneve se kushdo që pi cigaren dhe s'e di origjinën ai dihet çka bën. Kështu që unë mendoj se nuk jemi as kujdestarë të tregtarëve e as të atyre, ata që i kanë dyqanet me pluhur duhet që t'ua mbyll inspeksioni se nuk guxojnë të kenë pluhur në dyqane, se aty përveç duhanit shitet edhe ushqim. Pra, të gjitha këto mund t'i trajtojmë ne gradualisht, por organet ekzekutive duhet ta kryejnë punën e vet, të mos lejojnë të vijnë cigare fals as nga Bullgaria, as nga Kina, as nga Rusia, as nga Ukraina, se asnjë cigare që e ka, që është e prodhuar aty ku duhet e ku prodhohen cigaret evropiane, nuk hyn në Kosovë.

Bekim Haxhiu e ka një replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Është e vërtetë që nuk ma ka përmendur emrin, mirëpo i është referuar kolegja e nderuar fjalimit tim dhe gjithsesi, mendoj që aspak nuk ka të bëjë ekspozimi i duhanit me mbrojtjen e shëndetit. Bile, bile kjo formë e shitjes së tanishme e duhanit e stimulon dëmtimin e shëndetit. Në formën si është duke u mbajtur tani duhani nën tezga, nën myk vetëm sa e dëmton shëndetin e atyre që e konsumojnë. Dhe, nuk ka aspak lidhje ekspozimi me shëndetin. Kjo s'ka të bëjë fare me atë dhe nuk mundemi për ta lidhur në këtë formë ekspozimi. Kjo vetëm që e stimulon kontrabandimin e duhanit dhe për të futur duhan edhe jo më kualitativ në Kosovë në raport me këtë, me atë që e thatë edhe ju i nderuar kryesues. Pra, kjo vetëm sa e stimulon kontrabandën, duhanin ilegal dhe në këtë formë edhe do të dëmtohet edhe më tepër shëndeti dhe aspak nuk ka të bëjë ekspozimi dhe shtija me atë të dëmit të cilat i shkakton duhani.

Ato dëme duhani do t'i shkaktojë si u ekspozua në tezga, si s'u ekspozua, për ata që e konsumojnë dhe kjo s'ka të bëjë fare dhe nuk mund të lidhen këto në mes veti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash zonja Breca ka kundër-replikë.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

Kolegë, të them, ju jeni ftiziatër. Unë kam pritur që keni shumë lëndë, domethënë, të lidhura me mjekësinë e përgjithshme, me ne mjekët.

(Ndërhyrje)

Fiziatër apo fiziterapeut? Ishte dashur ta dini që kjo ndikon direkt në shëndetin. Ajo është logjika e juaj që e thoni që nuk ndikon. Nuk e di a keni lexuar ndonjë hulumtim për të parë se sa ndikon ekspozimi i duhanit në fillimin e duhan-pirjes? Lexoni, keni shumë hulumtime që janë bërë në shtetet e perëndimit dhe në shumë shtete ku tregojnë qartë se sa ndikon ekspozimi i duhanit në fillimin e përdorimit nga ana e adoleshentëve. Një.

E dyta, se mbeta borxh më herët ku u tha se është e pamundur nga ana e inspektorëve që të bëhet kontrolli dhe dënimi i atyre që i pinë nëpër lokale, ka shumë lokale të natës e të ditës ku përdoret duhani. Kjo është një soj sikur të aludosh , domethënë tash të thuash se është e pamundur...

(Ndërrprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Zonja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolege dhe ju kolegë deputetë,

Jemi të vetëdijshëm që as ata që janë pro ndryshimit të këtij amendamenti, as ata që janë kundër ndryshimit të këtij amendamenti, nuk janë kundër shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës e me theks të veçantë nuk janë kundër shëndetit të të rinjve të Kosovës.

Mirëpo, theksi bie diku tjetër, se sa është zbatuar ky ligj dhe sa ka pasur kontroll të zbatimit ky ligj.

Më vjen shumë keq zoti ministër kur thoni që ky ligj është zbatuar në masë të madhe, sepse kjo nuk është e vërtetë. Ne jemi gjithkund dëshmitarë në Prishtinë, sidomos, meqë ju thatë që pikërisht në Prishtinë po zbatohet ky ligj, e unë kisha dashur t'ju pyes a është bërë ky ligj veç për Prishtinën apo është bërë ky ligj për krejt Kosovën, sepse nëse është bërë për krejt Kosovën duhet të gjejë zbatueshmërinë në gjithë Kosovën, jo vetëm në Prishtinë, që edhe në Prishtinë nuk po zbatohet, si nga ekspozimi i duhanit ashtu edhe nga duhan-pirja nëpër lokale. Sepse, nëse e marrim te duhanpirja unë mund të them zoti Ministër se krejt çka ka ndodhur me këtë ligj taketuket janë shndërruar në tablla të kafes, nëpër tavolinat e kafiterive dhe restoranteve në Prishtinë, sepse duhani pihet çdo kund, jo vetëm në klubet e natës, por pihet në çdo kafiteri të qytetit, pothuajse. Mos t'i përfshijë të gjitha, sepse ka disa pronarë të kaftierive të cilat e respektojnë, mirëpo në masë të madhe ky ligj nuk respektohet absolutisht.

Dhe më vjen keq që sot, dy muaj pas hyrjes në fuqi dhe fillimit të zbatimit të këtij ligji na vjen ky ligj për plotësim-ndryshimin e këtij ligji ose këtij amendamenti.

Unë mendoj se duhet sot të kishim pasur disa statistika nga ju si ministër që sa duhanshitës janë dënuar ose thjeshtë kanë marrë masa inspektorët e juaj që të dënohen ata shitës të cilët u shesin cigare fëmijëve në moshë prej 7 vjeç, ndoshta edhe më të vegjël e

deri në 18 vjeç. Unë nuk kam dëgjuar asnjë rast që është sanksionuar duhanshitësi që mos t'i shesë fëmijës duhan.

Ne e dimë shumë mirë, këtu zakonisht është bërë kur nuk dimë çka të themi i përmendim standardet evropiane, po unë e di që nëse flasim për Evropën, në Evropë nuk guxon t'i shitet duhani një fëmije nën moshën 18 vjeç dhe të them të drejtën këtu po flitet për adoleshentët që do stimulohen të pinë duhan, ndërsa unë mendoj që shitësit nuk duhet t'u shesin fare adoleshentëve duhan.

Dhe tjetra çka dua të them, në vendet e Evropës edhe aparatet, ose ata automatët ku blihen cigaret nuk e kanë të mundshëm, domethënë fëmijët nën moshën 18 vjeç pa e dhënë letërnjoftimin ose ID kartën, nuk mund të blejnë duhan as edhe në aparate e lëre më në daqane ku shitësit e shesin duhanin.

Unë qëndroj prapa fjalës time që e kam pasur kur ka ardhur ky ligj për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pikërisht jam shumë pro mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe mbi të gjitha vlerësoj shumë lart ato biznese të cilat e kanë respektuar jo duhanpirësin dhe e kanë respektuar edhe Ligjin e Kosovës të cilin vërtet e kemi miratuar jo shumë larg nga kjo seancë që po flasim sot.

Edhe një herë kisha dashur të di se sa masa janë marrë ose sa gjopa janë shqiptuar për ata shitës që kanë shitur duhan ose cigare fëmijëve nën moshën 18 vjeç, nëse e keni ndonjë statistikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka fjalën për replikë, më duket.

ARDIAN GJINI: Vetëm për disa sqarime. Nuk e kam në plan të shkoj më tutje. Fillimisht disa herë u përmend që ligji ka hyrë në fuqi tani e 2 muaj, ligji ka hyrë në fuqi më 23 maj të vitit të kaluar. Nuk janë 2 muaj. Qysh janë 2 muaj prej 23 majit të vitit të kaluar e deri më 5 maj të këtij viti, të nderuar deputetë. Është një vit dhe kemi pasur kohë të shohim çka po ndodh.

E dyta, unë nuk e di çka kemi nevojë t'i tregojmë njëri-tjetrit sa i dëmshëm është duhani. Po e dimë. Është absolutisht e vërtetë, siç tha kolegja deputete dhe doktoreshë paraprakisht që ekspozimi ndaj duhanit e rrit gjasën që dikush ta fillojë duhanpirjen. Por, ne nuk po flasim për këtë punë, se ata njerëz janë të ekspozuar krejt kohën. Unë ju thashë çka po bëjmë ne, çka po mbërrimë kur në gjithë Kosovën shitet duhani nëpër kafene me kartonë, ku nuk ka njeri në Kosovë që nuk është i ekspozuar ndaj duhanit.

Nëse i ndalim krejt, unë jam i pajtimit me ju, por efekti i këtij ligji është për t'i dënua ata që paguajnë tatim e për t'i favorizuar ata që nuk paguajnë tatim. Efekt tjetër nuk po shoh unë.

Në të vërtetë, kjo po ndodh në Kosovë. Nëse ju për një vit nuk keni arritur ta shihni që ky është efekti i këtij provizionit, atëherë unë nuk e di çka të them më tepër. Pse s'po i hiqni fëmijët që shesin duhan në rrugë? Silluni rreth e rreth Kuvendit, e shihni.

Domethënë, mos e tëholloni dhe ta shtrembëroni këtë që po e themi ne. Nuk po themi që është mirë të ekspozohet duhani, por po themi që është e pamundshme të ekspozohet duhani dhe mos harroni që është e vërtetë që 80% e inspektorëve pinë duhan vetë, edhe kur është ftohtë shkojnë në mëngjes ta pinë një kafe me një cigare diku dhe e harrojnë atë punë.

Ne jemi duke jetuar në Kosovë. Kosova nuk ka vend fiktiv, është real. Ky është vendi ynë. Ne duhet të synojmë që të ndalet duhani, por nuk mund të bëjmë këso salto-mortale, të bëjmë këso ligje të cilat janë jo ligje, ‘non-wo’ i thonë anglisht. Nuk funksionon.

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, ngadalë se edhe ty të vjen rendi, por ai ka bërë replikë me zonjën Breca dhe unë po dua me ia dhënë fjalën zonjës Breca me bë kundër-replikë. Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari koleg, unë nuk e di prapë në çka po bazoheni me thënë se ekspozimi i duhanit po e dëmtonte biznesin dhe nuk po e dëmtonte, nuk po shkaktonte duhanpirje. Në çka po bazoheni, në çfarë hulumtimi po bazoheni, në cilat të dhëna po bazoheni, ku i morët ato të dhëna? A aq mirë në shtetin tonë po punojnë të dhënat statistikore që as shpejt mbërritët t’i mblidhni këto të dhëna?

Shumë keq nga ana e juaj që thatë se në hapësira është e pamundur kontrollimi nga ana e inspektorëve dhe atyre që e përdorin duhanin. Kjo njësoj i bien se një njeri, një individ, një person në qoftë se e mbyt dikë është e pamundur kapja dhe dënimi i tij, domethënë në burg nga ana e policisë apo e gjyqësisë. Që kjo është njësoj. Domethënë që ligjet duhet të funksionojnë zotëri e jo të tregoni kurrfarë të dhëna, kurrfarë baze nuk keni të tregoni se kjo nuk ndikon në duhan- pirje, në rritjen e duhan- pirjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër Agani e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Të nderuar deputetë,

Mendoj se edhe ky debat shumë qartë e qartëson një fakt të thjeshtë se sa është niveli i përgjegjësisë së deputetëve të Kuvendit të Kosovës ndaj qytetarëve të këtij vendi.

Po flasim për 2 muaj, ishte shumë e qartë, thënia e zotëriut Gjini se bëhet fjalë për vetëm 2 muaj, pas fillimit të zbatimit të këtij ligji kur është nisur, kur është bërë kjo nismë qytetare. Pa bërë asnjë analizë, pa bërë asnjë fakt. Do të thotë, është thjeshtë paragjykim, interes i pastër ekonomik. Lobim për interesa materiale, financiare dhe kësaj s’mund t’i ikni , absolut.

Të ishte bërë analiza pas 10 muajve të zbatimit dhe të dalim me fakte konkrete, krejt në rregull. Asnjë numër, asnjë fakt, 2 muaj pasi ka filluar zbatimi i ligjit, ju lutem.

Stërshitësit. Argumenti për ndalimin e ekspozimit të duhanit qenkan stërshitëset e duhanit, pakot me duhan. E çka me çamkëza? A e kemi ndaluar ne ekspozimin e çamçakëzëve nëpër vende të shitjes? Ai u ndalua? E pse po shitën çamçakëzët?

Argumentimi i stërshitjes është ajo që thamë, faktorët socialë ekonomikë, nuk zgjidhet problemi i stërshitjes duke i punësuar fëmijët se është e ndaluar me ligj për t'i punësuar fëmijët. Zotëri Gjini, është e ndaluar me ligj për t' i punësuar fëmijët.

Prandaj, ajo që dua të them është që ekspozimi i duhanit, të nderuar deputetë, ekspozimi i duhanit ka qenë një fitore e madhe e kulturës qytetare mbi provincializmin primitiv, mbi shprehitë e kohës së shkuar, një hap i qartë i qytetarëve të vendit kah Evropa, një shprehje e nderimit ndaj qytetarëve me metoda tjera ma bashkëkohore se me cigare.

Zonja Ganimete, në një emision, në televizion e kam parë një përfaqësues nga komuna e Deçanit, thotë a del ministri ndonjëherë kah Deçani të shohë se sa zbatohet ligji? Kam qenë me një dasmë në komunën e Deçanit, me 500 pjesëmarrës, ku kam qenë 5 orë dhe dasmë e dyfishtë, me miqtë nga dy anët. Asnjë cigare. 5 orë. Ju lutem.

Prandaj, atë fitore që e kanë realizuar qytetarët e Kosovës, unë ju uroj që edhe ju ta realizoni si deputetë. Unë uroj që ju të vini në nivelin e qytetarëve të këtij vendi, që e kanë ngritur vetëdijen e tyre në atë nivel që qartë i kanë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ke hapur front për replika me 3-4 veta për njëherë. Zoti Gjini e ka fjalën për replikë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht, ministër nuk ke të drejtë të na tregosh nivelin neve si deputetë në çfarë niveli domi të shkojmë dhe nuk është ky nivel i një ministri, nëse do me ta kthyer me të njëjtën gjuhë. Niveli yt po tregon se je ardhur këtu t'u tregosh nivelin deputetëve, na e kemi njëfarë niveli, mos harro.

Dhe krejt çka po dua me thënë është që seriozisht jam krejt i befasuar. Ta dëgjoj dikë duke i referuar fjalës sime dhe duke folur krejt diçka tjetër prej asaj që kam folur unë në të vërtetë mu rrëxu. Dhe, nuk e di a ka logjikë për të diskutuar.

Thotë dikush, tha zoti Gjini krejt çka s'kam thënë unë, krejt të kundërtën. Sinqerisht, domethënë, ndotjani bre veshin çka po thotë dikush e mbasandaj thoni se krejt çka u përmend unë nuk e thashë. Krejt kontra thashë, në fakt.

Unë thashë që ekspozimi ndaj duhanit e rrit mundësinë për ta nisur duhanin, është e vërtetë, por unë po ju pyes juve a e keni ndalë ekspozimin e njerëzve ndaj duhanit? Dhe ju më kallëzoni ju a e keni ndaluar a jo?

Edhe ky thotë po çka t' u bëjmë stërshitësve që kemi raste sociale. Po nuk jemi duke folur ne për atë punë, ne jemi duke folur për një temë që është tepër konkrete dhe e cila e ka kuptimin se a e ke ndaluar ekspozimin a jo, apo veç i ke bërë dëm dikujt. Veç për këtë fol.

Fundi i fundit, secili deputet voton vetë , po mos i përziëni sendet. Për të dashur t'ia mbushni mendjen dikujt të votojë qysh do të votojë, po përdorni argumente herë majtas herë djathtas që s'kanë të bëjnë me thelbin e temës për çka jemi duke folur, jo për esencën.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu, replikë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues.

KRYESUESI: Kundër-replikë, në fakt.

GANIMETE MUSLIU: Ministër, atyre dasmaxhinjve atje, ose atij dhëndrit me nusen që janë martuar në Deçan, u uroj trashëgohen dhe më vjen mirë që paskeni marrë pjesë në dasmë, ndërsa unë kisha pyetje konkrete për juve. Tha, nuk thashë që 100% nuk zbatohet. I përshëndes dhe respekt të veçantë për të gjithë ata pronarët e lokaleve dhe të restoranteve të cilët e respektojnë ligjin.

Pyetja ime konkrete ishte, cilat janë statistikat, sa shitës të duhanit janë dënuar ose thjeshtë u është shqiptuar një ankesë ose një vërejtje që i kanë shitur duhan një fëmije nën moshën 18 vjet? Kjo ishte pyetja konkrete, nëse keni mundësi që të më përgjigjeni, nëse keni ndonjë statistikë të saktë. Pyetje konkrete është dhe kisha dashur përgjigje prej ministrit direkt tani.

KRYESUESI: Ju lutem, vetëm kundër-replikë ke, s'ka pyetje tash, se ka kaluar koha e pyetjeve. Në fund ministri ka të drejtë që ta thotë fjalën për pyetjet që ia bëni ju. Dhe, unë besoj që janë konsumuar replikat, jeni paraqitur edhe 4 veta për replika këtu, s'po di pse? Bekim, unë po besoj që të njëjtat gjëra janë. Zoti Kelmendi, edhe ti, replikë ke a? Hajde...

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha të ndërlihem pikërisht në atë fjalimin tim që u përmend për 2 muaj. Është e vërtetë që e përmenda në fillim i pari se ende pa kaluar 2 muaj zbatimi i këtij projektligji ka filluar nisma.

Dhe ajo çka desha tjetër ta ndërlihdh, do të thotë ka filluar nisma për një amendamentin të këtij ligji. E ajo çka përmenda, çështja e dytë në fillim të këtij fjalimi tim e thashë se fatkeqësisht Kuvendi ka ra në lajthitje të kësaj iniciative nga industria e duhanit. Pse po e them? Shumica e deputetëve që ishin pro këtij ndryshimi të projektligji thanë që qëllimi, konkretisht ligji që është deri tash aktual nuk është i mirë se s'po zbatohet. E unë e desha një sqarim shumë të thjeshtë se shumica, pjesa dërmuese e këtyre vozitësve të veturave. Ne e dimë që në komunikacion pjesë dërmuese të rasteve nuk zbatohen rregullat e komunikacionit, kufizimet 50 – 60 në orë. A do të thotë kjo tash që do të hiqen të gjitha rregullat e komunikacionit dhe do të vozitet pa kufi? A do të thotë kjo që të hiqen krejt rregullat e komunikacionit? Do të thotë kjo i bie njëjtë si ta heqim këtë ligj se nuk është i mirë. Ligjin e kemi të mirë. E ajo çka duhet në fazat e ardhshme për ta fuqizuar zbatimin e këtij...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bekim Haxhiu. Një minutë e ke.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Vërtet se është një ligj i cili po zgjon debat, mirëpo aspak domethënë nuk i vjen në etikë ministrit që të vlerësojë punën e deputetëve. Ne jemi këtu për ta vlerësuar punën e tij, jo ai tonën, domethënë, kjo është çështja e parë.

Çështja tjetër, do të thotë nëse hiqet ky neni 9.2, nuk do të thotë se nuk do të rregullohej kjo çështje. Unë dua ministrit t'ia kujtoj këtu. Sa është malli i kontrabanduar brenda kësaj periudhe kohore? Po flasim vetëm pas Vitit të Ri e këndeje, janë me dhjetëra dhe me qindra kilogramë duhan të kontrabanduar që ky nen 9.2 e ka stimuluar kontrabandimin e duhanit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën! Mos përmend emra, Alma.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Jo unë s'po përmendi emra, por kur të ma japësh fjalën, mos ma merr më fjalën! Plus, zoti Haxhiu e përsëriti vetveten tani. Për sa i përket Ligjit për kontrollin e duhanit, nëse ky ligj ia ka dalë sadopak që, duke e ndaluar reklamimin të ulë pirjen e duhanit, unë mendoj që ky është një sukses. Nuk kemi të dhëna, por është lajm i mirë në qoftë se e ka prodhuar këtë efekt, pra më pak pirje duhani dhe, në fakt, në vendet ku është ndaluar duhani, ku ka pasur restriksione, qoftë për reklamimin, qoftë për vendpirjen, zakonisht e ka prodhuar këtë efekt.

Unë kurrësi nuk pajtohem se mungesa e reklamës është pengesë për shitjen. Absolutisht jo! Sepse për ditë ne po shohim se duhani po shitet.

E vërteta është që njerëzit po arrijnë t'i gjejnë edhe substancat narkotike, posedimi i të cilave është vepër penale. Pra, i gjejnë rrugët për t'i blerë. Ndërkohë që duhani nuk është i ndaluar për t'u shitur, ai shitet, por ndalohet reklamimi.

Nuk mund të pajtohem me argumentet që dolën këtu se po zhvillohet kontrabanda. Jo! Kontrabanda zhvillohet atëherë kur diçka ndalohet. Edhe një herë - shitja nuk është e ndaluar. Ajo çfarë ndalohet është reklama. Reklama, siç e dimë të gjithë, është promovim. Është joshje, është nxitje, në këtë rast për konsumatorët.

Dhe, duhani pranohet që është helm. Helm për trupin e njeriut. Ne kurrësi nuk duhet ta miratojmë një ligj, i cili do të ndihmonte në promovimin e helmit. Kjo është çështja. Çështja është shumë e thjeshtë.

Në lidhje me argumentet se duhani po shitet nga fëmijët, e vërtetë është që fëmijët po punojnë, fëmijët janë në rrugë, ka plot të tillë. Mirëpo, shfrytëzimi i fëmijëve në punë është gjithashtu i paligjshëm, është vepër penale. Institucionet duhet të merren me këtë. Shfrytëzimi i fëmijëve në punë është vepër penale, të nderuar kolegë, dhe shteti ka dështuar në fakt që t'i marrë fëmijët nga rruga, pavarësisht çfarë ata shesin, duhan apo

çfarëdolloj gjëje tjetër. Në fakt, fëmijët duhen të jenë në shkolla, e jo duke u marrë me shitblerje.

Përfundimisht, unë dua të them këtë që ne si deputetë nuk duhet të biem pre e presionit as të shitësve, as të industrisë. Imagjinojeni sikur ne të kishim industri të zhvilluar armatimi, çfarë do të thotë kjo, si do të kishim reaguar ne. Do t'i lejomi armët nëpër rrugë?

Unë mendoj që sot është koha që ne deputetët e Kuvendit të Kosovës t'u besojmë kolegëve tanë deputetë, shumicës së tyre, të cilët janë me profesion mjekë dhe e kanë brengë më shumë se sa të tjerët shëndetin e njerëzve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Kur filloi debati për Ligjin e duhanit, fillimisht këtu u deklaruan shfatet e grupeve parlamentare dhe të gjithë e patën një qëndrim, dikush pro dhe dikush kundër këtij projektligji, ose këtij ndryshimi të këtij neni.

Mua po më vjen çudi sesi deputetët e një grupi parlamentar, megjithëse deputetët kanë të drejtë ta ngrehin një shqetësim dhe ta kenë mendimin e vet personal, i referohen fjalës ose qëndrimeve të grupeve të tjera parlamentare, kur grupi i vet parlamentar e ka një qëndrim të kundërt me deklarin e deputetëve.

Të gjithë qytetarët e kanë pritur miratimin e këtij projektligji, duke menduar se ky ligj do të implementohet, mirëpo të gjithë jemi dëshmitarë se sa po implementohet ky ligj, mendoj në kontestin negativ.

Ne si deputetë gjatë amendamentimit jemi munduar të bëjmë ligj, i cili do të implementohet, e jo ta bëjmë një ligj ekstrem. Ligj të formës së tillë nuk kemi as në rajon, e as më gjerë.

Ne patëm propozuar që në lokale të ketë ndarje fizike ku pihet duhani, e jo të ndalet ndoshta 100%, dhe qëllimi ka qenë që ky ligj në këtë rast të gjejë implementim. Ndërsa sot nuk ka as ndarje fizike, e në 80% të rasteve pihet duhani.

Një deputet tha se Komisioni Parlamentar është dashur ta mbikëqyrë implementimin e këtij ligji, mirëpo janë disa rregullore dhe është një afat kohor, me të cilin Komisionit Parlamentar i lejohet mbikëqyrja e një ligji dhe ky ligj ende nuk e ka arritur afatin kohor për mbikëqyrjen e implementimit të tij, në mënyrë që ne si komision ta sjellim në Parlament një raport, qoftë edhe me rekomandime se sa po implementohet ky ligj.

Është mirë që në të ardhmen ne si deputetë të sjellim ligje, të cilat në pako të gjejnë implementim në praktikë, e jo ligje sa për të thënë.

Pra, në vend që të kujdesemi nëse po ekspozohet apo jo, ne duhet të kujdesemi se sa po respektohet Ligji i duhanit dhe sa është ndaluar në lokale pirja e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit është zonja Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, nënkryetar!

Thënë të drejtën, nuk e pata ndërmend të diskutoj, mirëpo më nxitën disa fjalë të deputetëve. Nuk e kam ndërmend t'i falënderoj restorantet, të cilat e zbatojnë ligjin. Ligji i cili është në fuqi duhet të zbatohet. Është obligim i lokaleve që ta zbatojnë, përkundrazi duhet të pasojnë sanksionet dhe atë mjaft të larta, siç janë paraparë edhe në ligj.

Është e vërtetë se në fillim të hyrjes në fuqi të këtij ligji, i njëjti është zbatuar nga restorantet dhe lokalet, mirëpo pas një kohe shumë të shkurtër i njëjti nuk po gjen zbatim dhe shumë lokale nuk e respektojnë.

Prandaj, inspektoratet duhet ta kryejnë punën e vet me përgjegjësi dhe t'i sanksionojnë lokalet, të cilat nuk e zbatojnë këtë ligj.

I kemi 13 mijë nënshkrime, të cilët propozojnë ndryshimin e këtij ligji, do të thotë ndryshimin e nenit 9.2. Jam kundër këtij ndryshimi. 13 mijë nënshkrime logjikisht nëse e marrim nuk duhet ta ndryshojnë jetën e afro 1 milion e 800 mijë qytetarëve. Ne jemi këtu të vendosim nëse do ta ndryshojnë apo jo për të keq jetën e qytetarëve të Kosovës.

Personalisht jam kundër ndryshimit të këtij neni dhe pikërisht për arsye të cilat i përmendi zonja deputete Nazane Breca, dhe e përgëzoj për qëndrimin kundër të grupit parlamentar, sepse grupi i saj doli me qëndrim që është për ndryshim, dhe shpresoj se fjalët e saj do të ndikojnë që ta bindë grupin që ta votojë kundër këtij ndryshimi.

Pra, u përmend edhe kontrabanda si një arsyetim, i cili nuk qëndron, sepse ne pikërisht i kemi organet të cilat duhet ta luftojnë këtë kontrabandë dhe nuk duhet të jetë arsyetim që të ekspozohen prodhimet e duhanit. Kjo ishte atë çfarë pata unë ta them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, me dasma nuk vlerësohet implementimi i ligjit, edhe pse të përgëzoj për vlerësimin e veçantë. Edhe sa në dasma ke për të shkuar për ta konstatuar se sa implementohet ligji?

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj për këtë debat, i cili ishte përfundimisht i singërtë nga secili prej jush. Kjo është me rëndësi shumë të madhe, edhe për qytetarët, edhe për mua si ministër. Do të thotë, kam dëshirë që në këtë mënyrë t'i kuptoni edhe fjalët e mia dhe ta eliminoni çfarëdo konteksti pezhorativ në qoftë se keni lexuar diçka ndërmjet rreshtave, se nuk ka qenë qëllimi aty.

Si përgjigje vetëm ta japë, se deputetja Musliu disa herë u drejtua, kërkoi përgjigje drejtpërdrejt. Unë jam kryetar i Këshillit Ndërmnisror, i cili e mbikëqyr zbatimin e këtij ligji.

Ky këshill i ka mbajtur deri më tash gjashtë takime. Në këshill janë pjesëmarrës të gjitha inspektoratet relevante që e mbikëqyrin zbatimin e ligjit. Në këtë moment, meqenëse nuk ka qenë temë e debatit dhe e diskutimit mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit, unë nuk i kam të gjitha shënimet detaje, por po ju them se vetëm Inspektorati Sanitar në këta 10 muaj ka kryer 3 500 inspektime dhe i ka 85 lëndë në gjykatë për shkelje të ndryshme të zbatimit të këtij ligji.

Inspektorati Shëndetësor 500 inspektime, prej tyre rreth 200 specifike në bazë të paraqitjeve të qytetarëve dhe 3 lëndë janë në gjykatë nga ky inspektorat dhe të gjitha inspektoratet e tjera.

Kjo që pyetët për fëmijë dhe dënimet konkrete mund t'i merrni nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që i ka nën kompetencë me inspektoratet e saj këtë domen.

Një gjë është e qartë - shteti nuk ka pasur dëme ekonomike nga zbatimi i këtij ligji. Këtë e ka vërtetuar edhe Oda Ekonomike e Kosovës, e cila ka thënë dhe e tha edhe zoti Deshishku sot në fjalën e tij se nuk ka pasur rënie të importit të duhanit, që është një indikator indirekt i kësaj që po flasim, dhe që ky ligj nuk e ka pasur për qëllim dëmin ekonomik të shtetit, ose zvogëlimin e tregtisë me duhan, por ka pasur për qëllim pengimin e eksponimit të tymit të duhanit ndaj qytetarëve që nuk e konsumojnë duhanin dhe pengimin e joshjes së fëmijëve dhe të rinjve me duhan, duke marrë parasysh moshën e tyre dhe faktin se shumë studime deri më tani kanë dokumentuar se ekspozimi i duhanit e stimulon blerjen impulsive të ashtuquajtur të pamenduar të duhanit nga të rinjtë dhe nga fëmijët.

Mendoj se ky projektligj duhet të refuzohet. Është herët, e tha edhe zonja deputete se ende as Komisioni Parlamentar nuk ka arritur as ta analizojë bile zbatimin e tij që të përgatisë një raport zyrtar. Ky projektligj duhet të refuzohet në këtë fazë dhe t'u nënshtrohet procedurave tjera parlamentare.

Janë dy interesa të mëdha për ta refuzuar këtë projektligj, një shëndetësor dhe dy - interesi shtetëror. Shëndetësor, sepse është e qartë, sepse në qoftë se i ndryshojmë dispozitat e paragrafit 9.2 dhe 9.3, ne po e vëmë rininë tonë në rrezik të joshjes nga konsumimi i duhanit.

Është një dispozitë e ligjit që zbatohet 100%. Po duam ta ndryshojmë një dispozitë të ligjit që po zbatohet 100%. Do të kishte logjik të themi ta ndryshojmë atë dispozitë të ligjit që nuk po zbatohet 100%, e ta përmirësojmë, ose të bëjmë diçka, e jo ta prishim atë që është duke funksionuar. Kjo është nën një.

Interesi shtetëror, përfundimisht ju e dini Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, e ka vlerësuar si arritje të madhe mbrojtjen e shëndetit publik për Kosovën. Mund ta

paramendoni raportin e këtij viti, në qoftë se tash Kuvendi e merr një vendim të kundërt. Unë jam i bindur se nuk do ta bëni këtë gabim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koha është për të votuar. Në sallë janë 67 deputetë. Ju lus që të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Nuk miratohet. 27 vota kundër. A nuk kanë votuar 61 deputetë? Ok, në rregull.

E përsëritim votimin. Ju lus të votoni! Në qoftë se është dikush pa kartelë, le të lajmërohet. Përsëritje, ose e lëmë krejt, e shtyjmë. Në sallë janë 67 deputetë, duhet të votojnë 61 së paku që të konstatohet nëse ligji është refuzuar, është miratuar apo nuk është miratuar. Kjo është ajo që ne duhet ta zbatojmë.

Tani unë po e zbatoj atë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Çdonjëri nga ne mund të themi nga diçka, edhe qëllon gjithqysh.

67 deputetë janë të pranishëm. Ju lus të votoni për ose kundër. Votojmë tash!

Tani unë nuk kam koment, prapë nuk po votoni. Unë s'kam çfarë të bëj, me dhunë nuk mund të ju detyroj të votoni.

A votojmë edhe një herë? Atëherë refuzohet, ligji nuk miratohet.

(Reagime në sallë.)

Po pse? Ne kemi kuorum në sallë dhe duhet të votojmë. Çfarë Sabri, se nuk po të kuptoj? Në 15:00, kur të vijmë të votojmë? Jo, unë dua ta mbyll për të shkuar në pushim të drekës. Nuk kalon pra, le ta sjellin ligjin për së dyti.

Atëherë pushim deri në orën 15:15.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Meqenëse ende nuk ka numër të duhur të deputetëve për t'i miratuar amendamentet, po fillojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillimin Ekonomik dhe Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Aviacionit Civil.

Komisionit për Zhvillimin Ekonomik dhe Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Aviacionit Civil të Kuvendit dhe ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti, a është këtu? Nuk është.

Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kush është i përgatitur për të diskutuar lidhur me raportin? Zonja Selmani, si kryetare e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANAI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Në vend se sot të ishte me ne edhe ministri i Infrastrukturës, është dashur të jetë edhe ministri për Tregti, për arsye se Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri ka bërë monitorimin e Ligjit për Aviacionin Civil dhe çështjen e zbatueshmërisë së tij. Në rast se nisemi nga fillimi i miratimi të Ligjit për Aviacionin Civil në Republikën e Kosovës, mund të themi se ky ligj ka ardhur në kohën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, apo më mirë të themi me pakon e ligjeve të presidentit Ahtisari, dhe fatbardhësisht Komisioni Parlamentar e ka marrë në monitorim çështjen e zbatueshmërisë së tij është kërkuar mjaft mirë nga Qeveria që në... Ju kisha lutur të mbani pak qetësi, ose po e ...dhe Komisioni Parlamentar thotë shumë qartë që Qeveria ta përfshijë në planin legjislativ të saj plotësim-ndryshimin e ligjit për arsye se ky ligj në krahasim me rrethanat në të cilat ndodhet tash Kosova, duhet të ketë plotësim-ndryshime.

Koalicioni për Kosovë të Re u jep përkrahje rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe beson e shpreson që ministri shumë shpejt do të na sjellë ligjin në plotësim-ndryshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën si kryetar i komisionit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në vazhdimësi ka pasur, përveç aktiviteteve permanente, edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Me të drejtë e ka veçuar kësaj here mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil. Më lejoni që fillimisht t'ju a lexoj rekomandimet, të cilave mendoj që Kuvendi i Kosovë duhet t'u përmbahet, në mënyrë që të ketë zhvillime pozitive në këtë fushë.

Dëshiroj t'ju them po ashtu se ky institucion, ose kjo sferë ka qenë dhe mbetet e mbuluar mirë, jo vetëm me legjislacion, por edhe sa i përket funksionimit normal dhe efikas të institucionit. E kemi një kuadër të kualifikuar, të përgjegjshëm, një institucion i cili mund të radhitet ndër institucionet e suksesshme në Kosovë. Megjithatë, komisioni i ka identifikuar disa çështje të cilat duhet të trajtohen me prioritet.

Nën një, në rekomandimet të cilat ne i kemi radhitur, Qeveria ta përfshijë në planin legjislativ të vitit 2014 plotësim-ndryshimin e Ligjit të Aviacionit Civil të Republikës të Kosovës. Pra, konsiderojmë që ligji duhet të trajtohet, meqenëse në ndërkohë ka pasur disa zhvillime, të cilave ne duhet t'u përgjigjemi me plotësim-ndryshim të ligjit. Në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Aviacionin Civil të Republikës së Kosovës, përveç tjerash, duhet të qartësohen kompetencat sa i përket sigurisë dhe sigurimit të aeroporteve në ligj. Pra, siguria dhe sigurimi janë edhe disa si terma, janë çështje të cilat duhet të qartësohen më tej në ligj. Këto i kemi identifikuar gjatë procesit të monitorimit.

Ministria e Infrastrukturës ta harmonizojë legjislacionin në atë mënyrë që të krijojë një komision për hetimin e aksidenteve, si në fushën e aeronautikës, po ashtu edhe të aksidenteve hekurudhore. Ne me legjislacionin tonë nuk i kemi pasur të qartësuar mirë. Kemi vërejtur po ashtu edhe në autoritetin e hekurudhave që janë disa çështje të cilat do të mund të harmonizoheshin me një ligj dhe mbikëqyrje të institucionit të vetëm. AAC, në bashkëpunim me institucionet tjera, të vazhdojë përpjekjet për anëtarësimin e Kosovës në IKAO dhe për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me EASA. Pra, pavarësisht që po bëhen përpjekje të institucionit, ne sugjerojmë që të përshpejtohen dhe të intensifikohen aktivitetet.

Ministria e Infrastrukturës, bashkë me institucionet tjera relevante, të angazhohet për shpalljen e Kosovës zonë e lirë ajrore dhe ta mbështesë këtë proces. Operatori i shërbimeve të navigacionit ajror dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, në bashkëpunim me AAC-në, të vijoje procesin e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe të rritjes të profesionalizmit në kryerjen e shërbimeve dhe rekomandimi i fundit - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Infrastrukturës duhet të qartësojnë dhe të parashohin çështjen e regjistrimit, licencimit dhe operimit të kompanive të huaja ajrore në Kosovë.

Këto janë rekomandimet që i ka nxjerrë komisioni. I falënderoj të gjithë ata që janë kyçur, përveç deputetëve, edhe institucionet e Qeverisë dhe të Autoritetit të Aviacionit, që kanë marrë pjesë në mënyrë permanente gjatë kohës sa i kemi monitoruar dhe i kemi nxjerrë këto rekomandime dhe shpresoj që institucionet e Kosovës prej Kuvendit dhe të tjerat të jenë në funksion të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Deshishku është paraqitur.

Lus gazetarët të mos i përdorin telefonat brenda! Nuk kanë të drejtë të flasin në telefon nga vendi ku janë caktuar, si dhe nuk kanë të drejtë ta dezinformojnë opinionin për deklaratat tona. E njëjta gjë sot. Është fyese për Parlamentin në qoftë se unë do të përdorja fjalë të tilla fyese edhe për kolegët, edhe për vete, siç e kanë botuar ‘Express’ dhe ‘Bota Sot’. Nuk është në rregull dhe nuk keni të drejtë të flisni në telefon.

Zoti Deshishku, e keni fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues i Kuvendit!

Edhe pse ministrin nuk e kemi këtu,

Të nderuar deputetë,

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, me gjithë shumë vështirësi që ka, është duke u kompletuar dhe duke u aftësuar që me sukses t’i përmbushë detyrimet mjaft specifike që ka.

Sipas raportit të Grupit punues të Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, i ka kompletuar edhe dokumentet, aktet nënligjore, të cilat i duhen për kryerjen e punës së vet. Njëkohësisht e ka shtuar aktivitetin për themelimin bashkëpunimit me agjencitë simotra

të vendeve të ndryshme të botës, si dhe me asociacionet ndërkombëtare, sado që këtu ende ka probleme pikërisht për shkak të statusit ndërkombëtar të vendit tonë.

Që në fillim dua të them se LDK-ja e përkrah këtë raport, së bashku me të gjitha propozimet që dalin prej tij. Mendoj se propozimet e dhëna vetëm sa e forcojnë këtë autoritet dhe e krijojnë një ambient më të përshtatshëm për përmbushjen e përgjegjësiave që ka Autoriteti i Aviacionit Civil. Më lejoni që t'i përmend edhe disa nga problemet e pranishme për zgjedhjen e të cilave duhet t'i ndihmojmë edhe ne, qoftë nëpërmjet ndryshimeve të ligjeve, apo duke propozuar masa tjera adekuate.

Në punën e këtij autoriteti mjaft shumë të reflektuar, fakti se vendi ynë nuk është anëtar i OKB-së, e ka shkaktuar ngadalësimin e integritit në hapësirën e përbashkët ajrore, si dhe në pamundësinë e krijimit të marrëdhënieve të barabarta me anëtarët e tjerë të BE-së. Sado që kjo çështje nuk lidhet shumë me mundësitë që ka ky Kuvend, apo në vullnetin e deputetëve, megjithatë mendoj se ky autoritet duhet ta bëjë gati tërë dokumentacionin dhe të jetë i gatshëm për krijimin e rrethanave, menjëherë të kyçet në procese integruese. Mirëpo, për shkak të neglizhencës të Qeverisë së Kosovës, ky autoritet që nga korriku i vitit 2013 nuk ka bord mbikëqyrës, meqenëse katër nga pesë anëtarët, sa i ka ai, u ka skaduar mandati. Madje unë nuk kam ndonjë informatë se deri ku ka arritur procedura për tejkalimin e këtij problemi, por frikësohem se pa këtë bord do të vazhdojmë edhe për më shumë muaj.

Njëkohësisht është e pakuptimshme që ministria përkatëse, përkatësisht ajo e Infrastrukturës, të mos ketë staf të mjaftueshëm për këtë sektor. Besoj se nuk duhet të ketë kufizime buxhetore që të bëjë numër të mjaftueshëm të punëtorëve, pra edhe t'i aftësojë që ata t'i kryejnë punët në ndërlidhje me Aviacionin Civil. Pastaj duhet të mundësojë harmonizimin e legjislacionit në fushën e inspektimit të aksidenteve në qarkullim ajror dhe hekurudhor.

Në fakt, komisioni përgjegjës të ketë kompetenca më të gjëra, apo edhe ato për hetimin aksidenteve ajrore. Njëkohësisht, nëpërmjet ligjeve apo akteve nënligjore të bëjë qartësimin e kompetencave sa i përket sigurisë dhe sigurimit të aeroporteve. Të gjitha këto vërejtje që i përmenda, të cilat janë edhe të Grupit punues, imponojnë nevojën që sivjet të bëhet vlerësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Aviacionin Civil. Me këtë, pa dyshim se do të krijonim kushte për punë me efikasë të këtij autoriteti, por njëkohësisht edhe për zgjedhjen e situatave kontestuese rreth kompetencave dhe përgjegjësiave të tij.

Grupi ynë Parlamentar e përkrah raportin e Aviacionit Civil. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Sa deputetë janë në sallë? Në rregull.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2013 i Agjencisë për Menaxhimin Komplekseve Memorialë të Kosovës

Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për mosmiratim.

Radha e diskutuesve, kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Nait Hasani, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk kemi kuorum, zoti Sabri. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët,

Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Menaxhimin Komplekseve Memorialë më 1,8 dhe 15 prill dhe në raport ka gjetur të dhëna të mangëta, të cilat i ka sjellë shefi i agjencisë, kështu që komisioni e ka parë të arsyeshme që dhe ka kërkuar nga drejtori apo shefi i agjencisë që ta plotësojë dhe ta rregullojë raportin për të cilin ai nuk ka sjellë të dhëna ose fakte të mjaftueshme për të cilat është përgjigjur.

Në pyetjet e kolegëve deputetë, ai ka thënë që në raport ka të bëjë me çështjet e ofertave të ndryshme, dyshimet dhe për çështje korruptive, kështu që ne kemi kërkuar që të na sjellë të dhëna për këtë çështje, por ai nuk ka qenë në gjendje që t'i sjellë, por në të njëjtën ditë kemi kërkuar nga ministria po ashtu që është akuzuar nga drejtori dhe ata i kanë të dhënat që e dëshmojnë të kundërtën e raportit. Prandaj, komisioni, duke pasur këtë parasysh, ka kërkuar që të mos miratohet ky raport për arsye se nuk i plotëson kushtet dhe nuk merret me thashetheme për çështjet të cilat mund të jenë pjesë e organeve të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport, edhe komisioni e ka shqyrtuar, siç e theksoi edhe kryetari i tij. Ne i kemi dhënë dy herë mundësi që ai të na sjellë fakte lidhur me konstatimet që i ka bërë në raportin e vet. Në raport ka konstatuar se për Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë shkelje të caktuara të ligjit, që janë probleme që duhet t'i shqyrtojë prokurori.

Ne i kemi kërkuar të na sjellë fakte e argumente, por ai nuk ka mundur ta bëjë këtë. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ka sjellë fakte që e kundërshtojnë raportin e tij dhe ne, edhe si komision, por edhe si grup parlamentar, kemi marrë qëndrim që të jemi kundër miratimit të këtij raporti dhe i ftojmë të gjithë deputetët të votojnë kundër miratimit të raportit të agjencisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësues i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të kishte qenë mirë të ishte edhe ministri, sepse është e vërtetë, siç e thanë edhe kryetari i komisionit dhe kolegët e tjerë të këtij komisioni që është një raport, i cili është sjellë nga drejtori i kësaj agjencie, dhe po ashtu ne e kemi ftuar në Komisionin Parlamentar edhe ministrin për të sqaruar. Është një raport në të cilin vërtet shkruan për dyshime për tenderë dhe duke mos e respektuar edhe Ligjin e prokurimit, mosbartja e projekteve të agjencia dhe shpallja e tenderit nga ministria.

Përveç që janë në kundërshtim me ligjin e lartcekur, ngjallin edhe dyshime për qëllime korruptive. Kështu thuhet në raportin, të cilin e ka sjellë drejtori i kësaj agjencie, prandaj ne e kemi parë të udhës që të jetë edhe ministri në njëfarë forme në komision për të raportuar dhe njëkohësisht për të argumentuar nëse ky raport të cilin e ka sjellë drejtori i agjencisë është i drejtë, apo jo i drejtë.

Megjithëse, ne si deputetë të Parlamentit në këtë seancë e kemi raportin përpara, ky raport nuk ka ndryshuar nga drejtori i kësaj agjencie dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, njëkohësisht edhe anëtarët në kuadër të këtij komisioni kanë abstenuar në këtë raport, sepse nuk jemi ne ata të cilët e diktojmë drejtorin e kësaj agjencie, apo ndonjë drejtor tjetër të çfarëdo agjencie tjetër nëse duhet ndryshuar apo nuk duhet ndryshuar raportin. Pra, nuk jemi ne ata prokurorë apo gjyqësorë të cilët përzihemi në një raport, të cilin e ka përgatitur drejtori i kësaj agjencie.

Prandaj, dilemat ajanë shumë të mëdha dhe njëkohësisht konsideroj që kjo është një çështje ndërmjet drejtorit të agjencisë në këtë rast dhe është një çështje ndërmjet ministrisë përkatëse, për të cilën janë dhënë shumë vërejtje. Të dyja palët kanë dhënë vërejtje për njëra-tjetrën dhe ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës, njëkohësisht edhe si anëtarë të komisionit, nuk përzihemi, sepse nuk jemi në rolin e gjyqësisë në këtë rast, por konsideroj se një raport i tillë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, ne ashtu siç është do ta miratojmë në parim dhe do të shohim më tutje se si do të veprohet mes drejtorit të Agjencisë dhe njëkohësisht mes Ministrisë përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Komplekset memoriale janë simbole përmes së cilave ne si shoqëri i vlerësojmë të gjithë ata që me pushkë në dorë kontribuan për lirinë e vendit, ato paraqesin vlerat tona për luftën dhe luftëtarët e lirisë.

Një popull që vlerëson pionierët e lirisë, din ta vlerësojë dhe ta ndërtojë lirinë.

Agjencia ka pasur për detyrë komplekset memorialë të shpallur me vendim të Kuvendit si zona me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik, t’i menaxhojë në funksion

të rolit që kanë ato. Raporti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë tregon që këto vlera të njohura nga shoqëria janë zbehur dhe nuk janë mbështetur nga Qeveria.

Në vend të një bashkëpunimi të ngushtë mes Qeverisë dhe Agjencisë ndodhi e kundërta që për pasojë ka mirëmbajtjen e paorganizuar të komplekseve memorialë e deri tek mbyllja e tyre nga donatorët.

Nga raporti del që drejtori i vetmi i punësuar, por edhe i autorizuar që ta ndërtojë agjencinë dhe ta funksionalizojë atë nuk arriti t'i përmbushë detyrat me të cilat e ka ngarkuar Kuvendi. Në arsyetimin e tij ai raporton për mungesë të hapësirave për punë, mungesë të stafit, mungesë të vullnetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mungesë të automjeteve dhe mungesë të buxhetit.

Për të gjitha këto ai fajëson Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Raporti sjell një varg faktesh që dëshmojnë mungesën e vullnetit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për ta bërë të mundshëm punën e agjencisë dhe për t'i përmbushur dhe për të mbështetur ndërtimin e tij në bazë të detyrave që u takojnë me ligj duke filluar nga ndarja e buxhetit, herë 3 milionë, herë 1 milionë e deri tek pengesat, respektivisht refuzimi për bartjen e projekteve.

Drejtori i agjencisë mos bartjen e projekteve nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor tek agjencia e lidh me dyshimet e korrupsionit tek ministria përkatëse. Ministria pohon të kundërtën, duke pasur parasysh situatën e shpjeguar del që lufta mes drejtorit të agjencisë dhe ministrisë përkatëse lidhet më shumë me faktin se kush do t'i shpallë dhe menaxhojë tenderët.

Dyshimet për korrupsion duhet të hetohen nga prokuroria përkatëse. Përfitimi edhe nga tenderët për komplekset memorialë flet për një degradim të skajshëm të institucioneve tona. Mendoj që drejtori i agjencisë përgjegjës për ndërtimin dhe organizimin e tij kishte një afat të shkurtër kohor për realizimin e detyrave që i takojnë.

Kjo detyrë bëhet akoma më e rëndë kur merret parasysh se dy ministrinë përgjegjëse, në vend se të lehtësonin punën rreth ndërtimit dhe funksionalizimit të agjencisë, bënë të kundërtën. Dëgjimi publik i drejtorit dhe ministrit Dardan Gashi nuk solli fakte të reja për sqarimin e situatës. Ministri Gashi vuri në dukje, mes të tjerash se projektet nuk u dorëzuan për shkak që agjencia nuk kishte staf dhe kushte për t'i marrë përsipër ato.

Ky mund të jetë një shpjegim i besueshëm nëse këtij shpjegimi nuk i qesim përbri pengesat që iu bënë drejtorit për ta ndërtuar agjencinë.

Të gjitha këto sjellje të institucioneve të Kosovës në lidhje me agjencinë sjellin shumë dyshime për përgjegjësitë institucionale, luftës së brendshme mes institucioneve dhe dyshime të bazuara për korrupsion.

Duke pasur parasysh situatën, propozoj të themelohet një komision i Kuvendit, i cili do ta hetojë situatën dhe do t'i sqarojë Kuvendit cila është e vërteta rreth situatës së krijuar, të sqarojë dhe konkretizojë se cilat janë përgjegjësitë e Ministrisë së Financave, Ministrisë për Planifikim Hapësinor dhe drejtorit të agjencisë për dështimet në themelimin dhe funksionalizimin e agjencisë. Po ashtu t'i sqarojë çështjet e akuzave të ndërsjella për korrupsion, komisioni t'i raportojë Kuvendit dhe të kërkojë përgjegjësi nga institucioni relevant, varësisht nga përgjegjësit që janë, Kuvendi të reagojë varësisht nga të gjeturat e komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky është një raport i sinqertë i cili prezanton punën e bërë në një kohë të shkurtër, për shkak të moshës së vet të re vetëm disa muajsh që e ka pasur kjo agjenci.

Themelimi ligjor i Agjencisë për Komplekset Memorialë të Kosovës u bë në maj të vitit 2013, ndërsa emërimi i drejtorit të saj u bë më 12 korrik 2013. Me një marrëveshje që ka pasur Ministria e Mjedisit me komisionin është dashur që t'i barten tre njerëz nga ministria e cila punë është bërë shumë vonë, domethënë është bërë pas skadimit të afatit për rishqyrtim të këtij raporti, pra më 12 janar 2014 është bërë ky transfer.

Nga 9 pozita të zyrtarëve janë miratuar vetëm 5 edhe mund të them që kjo agjenci vërtet ka pasur pengesa, për shkak se nuk ka pasur as ambiente pune që u thanë këtu, por nuk ka pasur as infrastrukturë, makina etj.

Raporti thekson se Ministria e Mjedisit nuk ia ka bartur përgjegjësitë pas themelimit të agjencisë në rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2013, madje me ngutje i ka shpallur tenderët dhe ka nënshkruar kontrata për punë për dy projekte të mëdha të cilat janë miratuar në dhjetor të vitit 2013, në vlerë prej rreth 1 milion e 470 mijë euro.

Mos bartjen e projekteve nga agjencia që i ka shpallur tender ministria vetë, kjo agjenci në njëfarë mënyre vetë u theksua këtu e ka akuzuar ministrinë që dyshon që ka të bëjë me afëra korruptive.

Ne nuk jemi ata që mund ta vlerësojmë se a është kështu apo nuk është, por megjithatë mendoj që ky është raport i vetëm në Kosovë që dikush ka guxim që të bëjë me gisht për korrupsion në institucionet tona. Prokuroria duhet t'i verifikojë këto dyshime, sepse kjo është punë e saj. Ne duhet të mësohemi me këto lloj raportesh dhe duhet të pranojmë si vlerat e institucioneve tona të cilat janë të interesuara që ta luftojnë korrupsionin, ndërsa faktet dhe drejtësinë dihet e ndan gjykata.

Ne duhet ta miratojmë këtë raport, i cili i përshkruan aktivitetet ashtu siç janë, ndërsa punët tjera është mirë që nga këtu të apelohej, domethënë, t'i marrë rekomandimet vetë prokuroria që t'i marrë veprimet e nevojshme të veta.

Pra, mendoj që duhet ta miratojmë këtë raport me kënaqësi dhe madje duke e lavdëruar punën që e ka bërë vetë drejtori dhe vetë kjo agjenci deri tash edhe me këtë rast duhet ta mirëpresim edhe këtë lloj akuze e cila duhet të adresohet atje ku duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka zonja Lama.

SEVDIE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Për arsye të cilat i ceku kryetari i komisionit, grupi jonë parlamentar nuk do ta përkrahë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege edhe kolegë deputetë,

Në kohën kur po diskutojmë raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, do të them që Ligji për memorialët është votuar në mars të vitit 2013 dhe ne si Kuvend e kemi votuar të njëjtin ligj, me ç’ rast është themeluar edhe Agjencia për Mbrojtjen e Monumenteve, që është parë si shpresë për trajtimin kryesisht të komplekseve memorialë që janë ndërtuar pas luftës dhe për mision ka pasur edhe ruajtjen e vlerave të periudhës së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç është edhe mirëmbajtja e komplekseve memorialë. Po ndalem këtu, sepse disa herë gjatë këtyre seancave të fundit është përmendur mbyllja e memorialit në Marinë dhe meqë jemi tek raporti për agjencinë në fjalë unë do të them se mbyllja e këtij memoriali të UÇK-së do të thotë në Marinë, që ka qenë edhe një investim i investitorëve amerikanë e në të cilin janë skalitur emrat e mbi 2 mijë dëshmorëve të luftës nga gjithë Kosova, në radhë të parë është fyerje për të gjithë familjarët dhe në përgjithësi për gjithë shtetin e Kosovës.

Unë e kuptoj që drejtori i kësaj agjencie është përpjekur që do të thotë t’ia hedhë kompetencat, ose t’ia hedhë fajin Ministrisë së Planifikimit Hapësinor për mungesë të buxhetit, mirëpo unë mendoj gjithsesi që një memorial i tillë nuk meriton që të mbyllet, sepse dyert e memorialit janë mbyllur më 7 prill nga donatori në shenjë proteste për faktin se kjo vepër nuk është mirëmbajtur.

Në nëntor të vitit të kaluar, po e përmend këtë për të përkujtuar se ka pasur vjedhje të disa rrethojave të kompleksit, pastaj vazhdimisht ka pasur edhe dëmtim të emrave të skalitur në këtë memorial. Pra, vlen të theksohet këtu se deri në momentin e themelimit të kësaj agjencie për këtë monument është përkujdesur një roje, Ruzhdi Geci, nga fshati Llaushë, i cili për 8 vjet është përkujdesur që ky memorial të ketë një status të mirëfilltë dhe në momentin kur ne e kemi themeluar një agjenci dhe kemi pritur që këta memorialë të gëzojnë një trajtim të duhur, ka ndodhur dhe mbyllja e memorialëve, pikërisht për faktin se këta memorialë nuk kanë gëzuar përkrahjen nga agjencia që është e thirrur për këtë.

Dhe kur jemi tek raporti, unë nuk do ta votoj raportin e Agjencisë për Mbrojtjen e Monumenteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Kjo është ndoshta ajo problematika që jo rrallëherë jo vetëm deputetët opozitarë, por ndoshta edhe deputetët kështu që kanë pasur një logjikë se si funksionojnë institucionet e Republikës së Kosovës kur e keni trajtuar themelimin e agjencive apo të them teprimin e themelimit të agjencive të pavarura për dikasteret e ndryshme dhe dublifikimin e pozitave institucionale që sot janë në Republikën e Kosovës.

Dhe, me këtë logjikë vjen edhe deri tek kjo problematikë dhe Kuvendi mendoj që nuk është ta quaj në atë që është para një akti të kryer, por është para një akti të asaj logjike institucionale që mund të ketë edhe afëra korruptive.

Tash po mundohem vetëm ta theksoj, sepse kemi të bëjmë me një agjenci që është dashur ta ketë logjikën e përkujdesjes për komplekset memorialë, ku shumica e tyre në Kosovë janë në gjendje jo të mirë, bile- bile janë në fokus të pushtetit vetëm gjatë fushatave elektorale dhe tash edhe jemi mësuar me këtë logjikë e shumë njerëzve se gjaku i dëshmorëve edhe i heronjve duhet të përdoret vetëm para zgjedhjeve dhe asnjëherë apo kurdo qoftë për temat që ia vlen apo më mirë të them për atë çka e meritojmë.

Sa i përket këtij raporti, unë mendoj që edhe komisioni funksional, kolegët e mi deputetë këtu që janë, absolutisht nuk kanë qenë në nivel të kryerjes të detyrës së deputetit, sepse me një rekomandim të vetëm nuk përfundon puna e një raporti të një agjencie. Domethënë, me një rekomandim që të mos miratohet, ndërsa arsyet dhe problematika pse janë këtu brenda nuk e tregojnë të vërtetën.

Dhe, tash ata që e kanë lexuar me kujdes këtu më shumë është lufta se sa kush t'i menaxhojë tenderët, që domethënë më shumë është lufta te paraja publike, te investimet publike se sa te mirëmbajtja apo te avancimi i komplekseve memoriale në Kosovë. Dhe, tash kur po i shohim ne tash për shembull komplekset si në Mejë, apo në Koshare, apo në Marinë që e përmendi kolegja deputete, kjo është për të ardhur keq, jo që është për të ardhur keq, po kjo do një shqyrtim të atyre rekomandimeve që i tha zotëria nga "Vetëvendosja" që duhet të jenë në funksion tash të këtij debati, sepse ndoshta për ne, për deputetët edhe për komisionin në fjalë është dukur diçka e vogël, por kjo është shumë shqetësuese.

Paramendoni një drejtor i një agjencie i cili në raportin e vet e jep në mënyrë kronologjike, në mënyrë informative, gjendjen, luftën se kush duhet për t'i menaxhuar tenderët.

Dhe, kjo me të vërtetë nuk ka koment tjetër se çka është duke u bërë në këtë vend dhe si është duke funksionuar ky shtet. Po ku është logjika edhe 18 apo 30 agjencive tjera që janë në Republikën e Kosovës, apo edhe 8 zyrave që funksionojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të këtij vendi. Dhe, mendoj që unë nuk e di se si Kuvendi mund t' i mbyll

sytë, komisioni funksional t'i shohë me sy aferat korruptive, deklarative, publike edhe thuhet duhet të mos miratohet ky raport.

Andaj, unë mendoj që Kuvendi duhet të jetë shumë serioz, deputetët shumë serioz, të nxjerrin rekomandime shumë serioze dhe shikoni ku është përgjegjësia e ministrit në fjalë ose e Qeverisë komplet, se nuk është ministri bajraktar në veti këtu, ose drejtori i agjencisë. Dhe, me një çështje paramendo kur të vjen puna për t'u korruptuar memorialët e dëshmorëve.

Unë nuk e di, nuk e di deri kur ose si do të funksionojë ky shtet. Me të vërtetë është turp, turp i madh çka është duke ndodhur me paranë publike edhe me këto institucione.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ndoshta duke ju mbetur borxh nuk do të ndalem aq shumë të analiza e raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Memorialëve edhe për faktin se u thanë këtu edhe kolegët e mi nga grupi im parlamentar, kolegu im e tha edhe të tjerët e thanë që ka çka të thuhet edhe të diskutohet edhe për raportin.

Por, unë do të mundohem që për hir të asaj që të jemi sa më të familjarizuar me këtë problematikë, unë do të marr vetëm shembullin ku edhe nga një kolege u përmend si rast, me të cilin pajtohem që vërtet është shumë fyese për familjarët e dëshmorëve, për vlerat e UÇK-së që një memorial pas 15 vjetësh të përfundimit të luftës të mbyllet në shenjë proteste.

Dhe, kjo ka ndodhur në një memorial ku pikërisht Qeveria nuk ka dhënë për të, por kanë dhënë donatorët e ata donatorë nuk kanë qenë donatorë protagonistë të kësaj lufte, kanë qenë donatorë amerikanë, të cilët e kanë sponsorizuar me iniciativat dhe me shenjë përkrahje për luftën e UÇK-së dhe në derë të kësaj ose në drynin e portës, në drynin e mbyllur të portës së këtij memoriali shkruhet kështu: “të dashur vizitorë patriotë” pra, e ka fjalën për vizitorët patriotë: “njoftim për mbyllje të përkohshme”.

Donatorët amerikanë që e ndërtuan fazën e parë të memorialit kombëtar të UÇK-së janë të brengosur nga Qeveria e Kosovës që nuk ka ofruar ndonjë shenjë të qëndrueshme që përfundimisht të marrë përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe ruajtjen në këtë vend të nderit të gjithë burrave dhe grave të UÇK-së që janë vrarë në luftë.

Që kur memoriali ishte i hapur në vitin 2005, të gjitha shpenzimet janë paguar nga donatorët amerikanë duke pritur që Qeveria ta bëjë punën e saj. Pasi që tani ka ndodhur shumë vandalizëm, të cilën do të mundohem edhe vizuelisht me anë të fotografive t'ua tregoj dhe shkatërrim dhe Qeveria nuk po ndërmerr asnjë hap për arsye të sigurisë, donatorët amerikanë vendosën që ta mbyllin memorialin deri në njoftim tjetër. Dhe ju thotë qytetarëve: “ju lutem, kontaktoni politikanët tuaj të nivelit lokal dhe atij qendror për të përmirësuar sa më shpejt që është e mundur këtë mospërfillje të turpshme”.

Pra, zonja dhe zotërinj deputetë, ky memorial sot është në këtë gjendje. Porta ku ka ruajtur rojtari është e djegur, arsyen për ta djegur këtë portë unë nuk e kam ditur. Kur do të duhej të ishin emrat e dëshmorëve të shkruar, gjendja është kështu. Këto varreza janë pa emra dhe pa trupa të dëshmorëve, këtu janë nën këto llamarina janë të shkruar të gjithë emrat e dëshmorëve të UÇK-së dhe duket se donatori i ka respektuar më shumë se sa ne duke i mbyllur emrat për shkak se nuk ka dashur të shohë një gjendje afër emrave të dëshmorëve të UÇK-së.

Sikur këto shtylla këtu, shtyllat e ndriçimit janë të rrënuara të gjitha shtyllat që e rrethojnë kompleksin dhe vërtet është e turpshme për çka janë të rrënuara këto shtylla, për t'ua marrë telin dhe bakrin e tyre për ta shitur njerëzit, të cilët edhe ndoshta kanë mbijetuar me shitjen e këtij bakri. Dhe, përveç kaq janë thyer edhe xhamat e objekteve përcjellëse, pra çka ka kërkuar donatori? Ka kërkuar thjesht mirëmbajtje të investimeve të tij.

Ku nuk ka mirëmbajtje si ne mund të presim më shumë që Qeveria t'i trajtojë këta memorialë. Pse i nxora tash këto fotografi? I nxora këto fotografi për të thënë se pavarësisht që Agjencia për Menaxhimin e Memorialëve mund të ketë probleme, këto probleme nuk do të duhej t'i kishte Qeveria.

Pavarësisht që mund të ketë edhe probleme thjesht procedurale, këto probleme nuk do të duhej që së paku familjet e dëshmorëve t'ua linte Qeveria. Tek e fundit, familjarët e dëshmorëve edhe nuk e dinë ose mund të mos e dinë se kush e ka kompetencën për mirëmbajtje. Familjarët e dëshmorëve ndoshta edhe e dinë ose mund të mos ta dinë se sa buxhet ka ndarë Parlamenti i Republikës së Kosovës për këtë agjenci, por ata e dinë që ka një qeveri lokale dhe një qeveri qendrore që së paku në kohë fushatash dhe së paku për televizor shkojnë dhe hedhin lule te varrezat e dëshmorëve në vlerat e të cilëve ata thirren sa herë e kërkojnë votën.

Dje, në fushatën e kryeministrit në Has, diku, i shoqëruar edhe nga ministri ri FSK-së, dëgjova që duke thënë si zakonisht se Partia Demokratike e Kosovës është trashëguesja e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vërtet është tepruar, vërtet është bërë shumë që kjo parti të vazhdojë, të marrë nga vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të mos i japë kurrë pikërisht kësaj vlere, siç është Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Nëse jo agjencia, atëherë mendoj që Qeveria do të duhej të përkujdeset për memorialët. Në rastin konkret, nëse jo Qeveria, atëherë pikërisht komuna e Skenderajt do të duhej të përkujdesej qoftë me një roje për këtë memorial. Jam shumë i bindur që një rojë për këtë memorial do të kushtonte shumë më lirë se sa ditëlindja e kryeministrit në Skenderaj, andaj nuk do të duhej të ishte e papërbalueshme financiarisht përkujdesja për këtë memorial dhe për memorialët tjera.

E mora thjesht një memorial për të thënë që në këtë gjendje janë edhe shumë memoriale tjera, duke e ditur që janë shumë memorialë tjera në këtë gjendje, atëherë më lejoni t'ju kujtoj vetëm gjendjen e varrezave të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Polac. Janë edhe më keq se kaq.

Dhe gjithë ato varreza është dashur që pikërisht me fondet e ndara për përkujdesje të zhvarroseshin dhe të vinin aty ku e kanë vendin ose ku është përcaktuar, po në këtë gjendje janë sot edhe varrezat e tjera dhe të mos harrojmë ne sapo kemi kaluar edhe përvjetorin e Betejës së Koshares dhe dëshmorët kanë shkuar atje ku nuk i kanë trupat e më të dashurve të tyre.

Pra, trupat nuk janë në varreza, trupat janë në morg dhe ne ua kujtojmë dhe thirrëmi në vlerat, të cilat vërtet nuk po i respektojmë në nivel qeverie. Prandaj, do të duhej që kjo analizë e këtij raporti së paku të na vetëdijesonte, së paku ky raport i cili është me shkas të na vetëdijesonte që ne këto vlera t'i trajtojmë në mënyrën më të duhur, t'i respektojmë në mënyrën më të duhur dhe në vend që ne ato t'i shfrytëzojmë, do të duhej që ne të përkuleshim para tyre dhe t'i trajtonim më dinjitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dashur t'i përsëris fjalët e kolegut, Rexhep Selimi, e dimë shumë mirë që kur është nisur ideja për themelimin e agjencisë pikërisht ka buruar që t'i hiqet kjo kompetencë ekzekutivit për shkak të dyshimeve të bazuara se edhe po mund ndodh të ketë keqpërdorime.

Dhe, është shumë e vërtetë që në pajtim të gjitha grupeve parlamentare është hartuar një listë e të gjitha memorialëve në nivel nacional, e të gjitha periudhave historike të cilat do t'i kalojnë kësaj agjencie për mbikëqyrje. Natyrisht, se ndarja e buxhetit në Ministrinë për Planifikim Hapësinor, nuk është bartur tek agjencia dhe kjo po shihet edhe brenda raportit.

Ajo që ky raport është shqetësim për mu edhe mendoj edhe për kolegët tjerë është që ky raport asnjë shpjegim nuk e jep në çfarë gjendje i kemi ne memorialët. Ky raport më shumë flet për dallimet mes agjencisë dhe ekzekutivit, ky raport flet më shumë për krizën financiare, gjendjen financiare, më shumë flet për mungesën e buxhetit, mungesën e logjistikës. Asnjë shpjegim nuk e jep se në çfarë gjendje janë këta memorialë. Foli shumë mirë zoti Rexhep Selimi, unë kam qenë edhe fizikisht në Polac ku e ka Rexha një shok të mirë, Mujë Krasniqin, aty.

Është fare turp për neve që akoma lopët kullosin mbi varrezat e dëshmorëve dhe kjo nuk është justifikim as për Rexhën as për mua, nuk duhet të manipulojnë tash me këtë gjendje, sepse fajtorë është edhe Rexha edhe Dauti edhe të gjithë ne në Kosovë pse e kemi atë gjendje. Ajo që është shqetësuese është raporti shpjegon takime në Ministri të Financave, takime në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, takime në drejtorinë e ekzekutivit, na kanë premtuar kaq, na kanë premtuar aq, kur kam shkuar me këtë datë na i kanë ndalur kaq shumë, na kanë thënë i ke 11, jo herën e dytë i ke 7, tash i ke 3.

E akuzon Qeverinë që ka dilema për korrupsion, nuk flet për gjendjen reale të memorialëve e është shumë e vërtetë që në seancën e parë si fjalë të rastit që e ka mbajtur në këtë Kuvend, kemi kërkuar investime në Koshare.

Sot katër vjet përafërsisht, domethënë, jemi në vitin 2014, është e vërtetë që trupat e Koshares janë në morgun e Rahovecit. Është shumë e vërtetë që në Polac varrezat e Bedri Shalës, Ilaz Kodrës, Mujë Krasniqit, Rasim Kiçinës janë në gjendje të mjerueshme, as emrin nuk e di në tabelën e tyre, se cili varr i cilit dëshmor është dhe, aty janë mbi 250 djem.

Kjo gjendje është e papranueshme, jo vetëm për ekzekutivin dhe agjencinë, por kjo gjendje duhet të jetë e papranueshme për shoqërinë e Kosovës. Kjo agjenci e cila ka marrë mbështetje të fuqishme prej të gjithë anëtarëve të komisionit në atë kohë, në emër të grupeve parlamentare, unë sot mendoj që duhet t'i japim edhe njëherë një mbështetje me një kërkesë shumë të drejtpërdrejtë, që në të ardhmen e afërt ky le të merret më shumë me memorialët, se sa me tenderët, se po shihet qartë këtu se ka shpallur atë tender, ka shpallur këtë tender dhe shumë pak merret me gjendjen ekzistuese reale.

Sidoqoftë, unë nuk jam më anëtar i atij komisioni. E kam lexuar me shumë kujdes këtë raport dhe mendoj që këtij raporti duhet t'i japim një rast pa dashur të hyjmë se çfarë gjendjeje ka, a ka korrupsion a s'ka, unë mendoj që janë organet kompetente.

Unë personalisht do ta votoj me një sugjerim që në të ardhmen e afërt gjendja të ndryshojë pozitivisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Duke lexuar raportin e Agjencisë, të cilin po e diskutojmë tani dhe duke i dëgjuar diskutimet këtu në këtë Kuvend, vetvetiu të imponohet një temë, të imponohet një rezon dhe të imponohet një përsiatje jashtëzakonisht e pakëndshme dhe mjaft meditative, që të ngjallë trishtim.

Në fabulat tona kemi rastin e ngritjes së kështjellave, të cilat kanë shërbyer për sigurinë e banorëve të zonës, ose rasti dhe shembulli tjetër, ngritja e urave, që kanë shërbyer për kalimin e lumenjve dhe natyrisht, puna që është bërë ditën, aty dikush për të vështirësuar jetën e banorëve të zonës, i ka rrënuar natën.

Tani, tek lexojmë raportin e agjencisë dhe tek dëgjojmë dhe shohim shembujt e diskutimeve në këtë Kuvend, ne shohim se jo vetëm natën që rrënohen lapidarët si shenja të shenjtja, por edhe ditën. Dhe, ajo çka sot është për të ardhur keq, se krejt kjo ndodhë para nesh, para institucioneve tona dhe të gjithë rrimë, meditojmë dhe analizojmë tashti, shajmë dhe shprehim keqardhje, që është për dhimbje dhe pjesë e kësaj dhimbjeje jemi edhe ne protagonistë të gjithë këtyre ngjarjeve.

Raporti është mirë të kalojë dhe masat të merren nga të gjitha institucionet përkatëse në të gjitha nivelet e përgjegjësisë, që duhet të kërkojë llogaridhënie edhe që duhet të nxjerr para përgjegjësisë deri edhe më të rëndat, që me këtë rast do të duhej të mos i shpëtoi askush që e meriton të përgjigjet.

Me pak fjalë, kësaj radhe edhe për arsyen se agjencia ka jetë të shkurtër, ka filluar në mesin e vitit të kaluar dhe tani, natyrisht që ndoshta ka munguar edhe një eksperiencë për analiza dhe për mbikëqyrje, por pa hyrë fare në analizë të mëtutjeshme, raporti do të duhej të votohej, ndërsa përgjegjësia do të duhej të nxirrej dhe të nxjerrin para përgjegjësisë të gjithë ata që janë fajtorë për këtë gjendje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tahiri e ka fjalën.

XHAHER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Memorialët dhe varrezat e dëshmorëve, pa diskutim që janë përmendore të një të kaluar tonë historike, që duhet të shërbejnë për të na rikujtuar nëpër atë se nëpër çka ka kaluar populli ynë.

Për fat të keq, nga ajo që shohim në këtë raport vërej se ka një mungesë totale të vizionit, si nga ana e Ministrisë, ashtu edhe nga ana e Agjencisë, se si t'u qasen këtyre memorialëve.

Për gjendjen e memorialëve, varrezave të dëshmorëve, sigurisht që edhe me fotografi e tregoi kolegu deputet dhe e shohim të gjithë ne, çdo ditë, por se mungon një vizion se si këto memorialë të trajtohen, kjo është e qartë edhe nga raporti që kemi sot para nesh.

Në fakt, unë mendoj se në çdo memorial do të duhej të ishte një ciceron dhe pranë çdo memoriali dhe ky ciceron do të duhej të kishte për detyrë që të shpjegonte historitë e njerëzve, që janë të varrosur në ato varreza, që të shpjegonte jetën e tyre, për të gjithë ata vizitorë të cilët i vizitojnë këto memorialë, jo vetëm për të kujtuar të kaluarën, por edhe për të gjetur si burim inspirimi, sigurisht, edhe për të ardhmen. Por, kjo do të ishte me interes të veçantë për të gjithë ata njerëz që janë të interesuar për luftën dhe përpjekjet e këtij vendi dhe këtij populli, për të arritur lirinë dhe pavarësinë.

Nga ajo që shoh në këtë raport, vërej për fat të keq, edhe njëherë po e them, se krejt lufta bëhet në mes ministrisë dhe agjencisë për të menaxhuar paranë publike, për të shpallur tenderë dhe rrjedhimisht për të keqpërdorë paranë publike e fatkeqësisht, krejt kjo në dëm të memorialëve dhe të varrezave të dëshmorëve.

Kjo është tërësisht e papranueshme dhe për fat të keq, sikur kjo të mos mjaftonte, grupi parlamentar i shumicës në këtë Kuvend dhe Komisioni Funkcional rekomandojnë që ky raport të mos aprovohet. Jo që duhet të aprovohet ky raport, por ky raport duhet t'i dërgohet Prokurorisë, sepse në këtë raport nga persona zyrtarë të këtij vendi ka pretendime se një institucion, siç është Ministria e Planifikimit Hapësinor, pa qenë e autorizuar, ka shpallur tender në vlerë mbi 1 milion e 400 mijë euro, ndërkohë që vetë

agjencia ka menaxhuar një buxhet prej rreth 760 mijë eurove, pra po flasim në total për një shumë të shpenzuar nga taksat e qytetarëve të Kosovës, prej mbi 2 milionë eurove.

Dhe, kjo duhet, dhe me një raport që ka plotë pretendime për korrupsion dhe për keqpërdorim të detyrave zyrtare dhe autorizimeve. Prandaj ky raport, jo vetëm që duhet të aprovohet në këtë Kuvend, por duhet të merret nga Prokuroria e shtetit dhe të hetohen të gjitha pretendimet në të për korrupsion.

Ndërkohë që ne vërtet, edhe si institucione edhe si shoqëri, duhet të merremi shumë seriozisht me përmirësimin e gjendjes së memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, kudo në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se më lejohet edhe mua t'i them dy fjalë, pikërisht i nxitur nga diskutimet.

Ne, vërtet po diskutojmë për diçka shumë të dhembshme, domethënë varrezat e dëshmorëve dhe memorialët, por unë dua të them që më mirë është të diskutojmë, që ta zgjidhim këtë problem ashtu siç e kanë të zgjidhur të gjitha vendet përreth dhe të gjitha vendet që kanë varreza dëshmorësh.

Ne kemi, sa komuna kemi në Kosovë, ku ka dëshmorë e unë mendoj që është koha e fundit që ta kalojmë një ligj, i cili përcakton parcelat e varrezave të dëshmorëve në të gjitha komunat dhe të mos jenë të ndarë nëpër fshatra, sepse pothuajse secili fshat i joni ka varrezat e dëshmorëve të vet dhe përmendoret mund të vendosen në vendet ku kanë rënë.

Dhe, kuptohet varrezat qendrore të jenë në Prishtinë dhe jo të shpërndara. Unë besoj që varrezat qendrore duhet të jenë me figurat qendrore të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sa i përket tenderëve, unë nuk dua të besoj që ka asi njerëzish që mendojnë për tenderë për të pasur përfitime përmes varrezave të dëshmorëve, por unë dua edhe diçka të them, që kur ta ngarkojmë dikë, duhet t'ia plotësojmë me detyrë kushtet për të punuar.

Dhe, ndoshta do të duhej të shqyrtojmë edhe njëherë farë lloji qeverish që janë krijuar në emër të bordeve në Kosovë, të cilat kanë buxhet të vetin, të cilat e dimë të gjithë rrugën se si zgjedhën dhe si emërtohen, që ato borde të kenë rroga dhe paga dhe të jenë nëpunës të shtetit dhe jo të jenë qeveri më vete.

Ky është mendimi im, për t'u ikur debateve edhe më tutje lidhur me mundësitë e korrupsionit nëpër bordet që i themelon Parlamenti dhe agjencitë që i themelon Qeveria.

Pra, unë mendoj që nëse nuk themelohen varrezat, nuk bëhen varrezat e rretheve në të gjitha qytetet dhe varrezat qendrore në Prishtinë, ashtu siç janë gjithkund dhe në qoftë se, nëpunës të caktuar ose punonjës të caktuar nga kuvendet komunale ose komunat me buxhetin e shtetit nuk caktohen për t'i mirëmbajtur këto varreza dhe nuk japin llogari

para shtetit, është problem që ne të diskutojmë për varreza të veçanta, sepse kështu e kemi gjendjen.

Nga kjo që dëgjova deri më tani, unë mendoj që kjo do të ishte një zgjidhje më e lehtë dhe më e mirë edhe për shtetin e Kosovës edhe për familjarët e dëshmorëve edhe për shokë dhe bashkëluftëtarë të tyre, të cilët fatmirësisht i kanë mbijetuar gjithë luftës dhe me të drejtë po shprehin shqetësimet e tyre. Faleminderit që më dëgjuat.

Fjalën e ka zonja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Kryesues, jo replikë me zotin Selimi, veç një informacion shtesë, meqë u përmend komuna e Skenderajt, unë e përmenda në fjalën time, që komuna e Skenderajt për tetë vjet me radhë, do të thotë ka punësuar një roje, i cili është përkujdesur për këto memorialë. Është një djalë i Llaushës, Ruzhdi Geci, i cili për tetë vjet ka punuar që të përkujdeset për memorialin e Marinës. Mirëpo, në momentin që ne si Kuvend kemi miratuar Ligjin për memorialë në vitin 2013, të gjitha kompetencat komuna ia ka kaluar Agjencisë për menaxhimin e komplekseve memorialë.

Dhe, jo që komuna nuk ka pasur gatishmëri që të përkujdeset, mirëpo që janë bartur kompetencat nga komuna te Agjencia për Mirëmbajtjen e Memorialëve dhe e njëjta Agjenci ka deklaruar që Ministria e Planifikimit Hapësinor nuk i ka bartur asnjë memorial përveç memorialit të Prekazit, nuk i ka bartur kompetencat tek agjencia. Dhe, kjo agjenci është përkujdesur vetëm për memorialin e Prekazit, meqë ai drejtori Blakaj ka deklaruar se nuk ka buxhet. Dhe, përderisa nuk rregullohet çështja e buxhetit, ne nuk duhet të kemi telashe me mirëmbajtjen e memorialëve, siç ka ndodhur deri më tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Për sqarim të kolegëve deputetë, për çështjen e memorialëve dhe Ligjit për memorialët, në Kuvend dhe në Komision ka ardhur dhe drejtori i Agjencisë. Neve na ka prezantuar një biografi të takimeve të tij me ministrin e Mjedisit dhe kontaktet që ka pasur dhe çështjet të cilat ai ka dashur t'i zgjidhë.

Në momentin, që ne në mars kemi miratuar ligjin, drejtorit të Agjencisë kur ka ardhur në çështjen e intervistës për t'u zgjedhur drejtor, shumë pyetje që iu kanë bërë nga komisioni, ju kanë bërë edhe se si do ta menaxhosh çështjen e komplekseve memorialë.

Drejtori ka thënë që unë do ta zgjidh këtë çështje. Ne i kemi treguar drejtorit që nuk ke buxhet, nuk ke mundësi t'i kesh projektet të cilët Ministria i ka shpallur në oferta dhe nuk ka mundësi t'i bartë brenda viti buxhetor, ai ka thënë që unë do ta zgjidhi me ato që i ka.

I kemi treguar që i ka vetëm tre punëtorë, ai ka thënë unë do t'i zgjidh të gjitha çështjet. Prandaj, të gjitha këto që i ka thënë ai i ka vetëm nga dëshira dhe një vullnet që kinse të ketë mundësi aty. Pra, ligji nuk e lejon bartjen e projekteve, përveç projektit të Prekazit,

që ju ka bartë që ajo ta menaxhojë. Kur e ka pasur këtë projekt të Prekazit, ai edhe në këtë projekt ka bërë gabime, të cilat janë tmerrësisht të gjykueshme, ose jo të pranueshme.

Kur ai ka shpallur një ofertë për çështjen e ujit, mirëmbajtjes me ujë të Prekazit, varrezat e dëshmorëve atje, ai për tetë kilometra ka shti një gyp, ku herën e parë ka anuluar një tender që ka qenë me 600 mijë, ndërsa herën e dytë, të njëjtës kompani, e cila ka bërë ankesën ia ka dhënë për 800 mijë. Kjo tregon se është një keqpërdorim, po ashtu i drejtorit të Agjencisë.

Por megjithatë, unë do të them që të gjitha komplekset memorialë, nuk ka pas mundësi. Drejtori është për katër muaj ditë ka pasur mundësi ta arsyetojë veten dhe punën e tij, që është me tre veta. Ai ka marrë menaxhim për vite të tregojë çka ka pasur të bëjë.

Mendoj që përgjegjësi e tij ka qenë që ai të tregojë për tre muaj çfarë pune ka mundur të bëjë në komplekset memorialë. Për tre muaj ai tregoi që ka bërë keqpërdorimet më të mëdha, po nëse do të vijë më tutje, ai do të jetë ndoshta një keqpërdorues edhe më i madh.

Unë dhe komisioni kemi marrë qëndrim brenda komisionit me shumicën e votave absolute, ku edhe ka qenë një propozim edhe i Fatonit, i grupit “Vetëvendosje”, që është i paqartë, është i paplotë, është i paarsyetuar ky raport dhe ky raport t’i kthehet Agjencisë dhe ai të merret me plotësimin, me veprat që ka mundur t’i realizojë, me ato që ka mundur t’i mirëmbajë, me ato që duhet t’i mirëmbajë dhe jo të merret me çështjen e tenderëve, kush i ka dhënë apo kush nuk i ka dhënë, apo të merret me Ministrinë pse nuk po ia jep, ose pse ia ka dhënë, ose pse nuk e ka lëshuar buxhetin, ose pse duhet t’ia lëshojë buxhetin.

Ai nuk është marrë me këto dhe ne kemi konsideruar, që kjo është një shkelje që ai ka bërë dhe për këtë ne kemi kërkuar që Kuvendi të mos miratojë këtë raport, t’ia kthejë atij dhe ai të merret me çështjet dhe ta bjerë një raport me punën që ka bërë, në daç me kompleksin e Polacit në daç me Marinën, në daç me Prekazin, në daç me Mejen apo Kosharen, megjithatë ai është dashur të merret me këto çështje e jo të merret me kush ka tenderë e kush do të japë tenderë.

Prandaj, kemi kërkuar dhe kërkojmë që të mos miratohet ky raport, sepse nuk i plotëson, nuk është i qartë dhe ka nevojë intervenime drejtpërdrejt atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haradinaj dëshiron ta bëjë edhe një replikë të vogël.

DAUT HARADINAJ: Zoti kryesues,

Nuk po dua t’ia kthej Naitit, por kam qenë në komision kur është zgjedhur drejtori i Agjencisë dhe drejtori i Agjencisë në pyetjen se si do ta ushtroni ju funksionin e juaj të agjencisë, përgjigjen e ka pasur: ato kompetenca mi jep ligji.

Dhe, ne po flasim për një ligj, atë që e thatë edhe ju vetë më herët që duhet të shikohet në çdo komunë, që të bëhet evidenca e të gjitha. Ju them sinqerisht, e kam lexuar me shumë

kujdes atë ligj. Nuk ka vend në Kosovë që nuk është pjesë e ligjit, ama nuk ka vend, të paktën që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në historinë e fundit, nuk ka vend në Kosovë, që nuk është i evidentuar nga komunat dhe janë dorëzuar të gjitha, janë harmonizuar. Po ashtu, në kuadër të Ministrisë janë përfshirë në ligj dhe tani ato kompetenca ju kanë bartur agjencisë. Tek kompetenca që kujt i takon menaxhimi i financave për implementimin ose ndërtimin e komplekseve memorialë, këto unë mendoj që janë organet kompetente të cila duhet ta zgjidhin.

Ajo që është fakt i vërtetë, pikërisht ministri Gashi ka kërkuar që këto kompetenca për shkak të situatës së ndjeshme, ose ndjeshmërisë së kësaj situate, t'ju them më troç, duhet t'i kalojnë një agjencie të pavarur që është në kuadër të Parlamentit, për shkak se në Parlamentin e Kosovës janë të gjitha grupacionet politike dhe askush nuk ka të drejtë t'i ndajë politikisht vlerat historike të cilat i kemi ne.

Arsyeja e vetme pse neve i kemi dhënë mbështetje ka qenë pikërisht kjo, që të mos thirremi politikisht në vlerat ose sakrificën tonë, por kjo të bëhet pikërisht në Parlament ku do të marrin pjesë të gjitha grupet politike parlamentare dhe i kemi dhënë mbështetje, unë besoj, me të drejtë.

Kështu që edhe njëherë po them, ky raport nuk është perfekt, ka defekte, kam edhe unë personalisht vërejtje, për shkak se unë mendoj që drejtori Blakaj nuk është prokuror. Edhe unë nuk e di kush ia kadhën atë të drejtë atij të konstatoj se aty ka korrupsion, ai duhet të thotë që ka dyshime për korrupsion, por sidoqoftë, ky raport në rast se nuk votohet, po ashtu një kolegut të LDK-së do t'ju them, që në rast se nuk votohet, ky nuk e merr formën për organet e drejtësisë. Në rast se votohet, atëherë ky është bazë për ta qar më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit!

Më shumë po diskutohet çështja e memorialëve në nivel vendi, në përgjithësi se si po trajtohen ato, se sa çështja e këtij raporti. Dhe, ne këtu sot jemi thirrur që të trajtojmë raportin, me të cilin drejtori i kësaj agjencie e thotë qartë, nuk ka thënë që ka afëra korruptive, por ka thënë se ka dyshime për afëra korruptive.

Dhe, ne këtu mund ta sqarojmë, sepse u tha edhe nga kolegu Dauti, që në njëfarë forme ai nuk mund ta luajë rolin e prokurorit. Realisht, edhe ne si deputetë të Parlamentit nuk mund ta luajmë rolin e prokurorit.

U tha edhe nga disa kolegë deputetë tjerë këtu, nëse ka pasur afëra korruptive, me keqardhje do të thotë kur janë në pyetje edhe varrezat e dëshmorëve, atëherë pse jo edhe Prokuroria e shtetit është duke na dëgjuar neve këtu, edhe organet e gjyqësisë po na dëgjojnë edhe qytetarët e Kosovës po na dëgjojnë, le të sqarohet problemi mes të drejtorit dhe njëkohësisht mes edhe Ministrisë ose ministrit përkatës, në këtë rast.

Unë thashë, që ministrin e kemi pasur në dy seanca, po ashtu në dy seanca e kemi pasur edhe drejtorin e kësaj agjencie. Ata janë munduar t'i japin sqarimet nga këndvështrimi, qoftë nga ministria dhe qoftë nga agjencia dhe kësaj çështje mendoj që duhet t'i vjen fundi, sepse problemet e tilla të krijuara, qofshin në mënyrë individuale në mes drejtorit dhe ministrit, do të thotë ne si deputetë të Parlamentit, e thashë edhe një herë, s'mund ta luajmë rolin e gjyqësisë ose të prokurorit, në këtë rast. Nëse ka pasur le të vërtetohen, le të argumentohen. Mirëpo këtu në raport shkruan qartë se dyshohet për afëra korruptive, prandaj mendoj që edhe raportin si i tillë ne si grup Parlamentar, e thashë në fillim, duhet miratuar dhe më tutje janë organet tjera përgjegjëse të cilat merren me shqyrtimin e ankesave apo të aferave të cilat janë paraqitur në këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse u diskutua shumë rreth kësaj agjencie e pashë të arsyeshme t'i them edhe unë dy- tri fjalë në lidhje me këtë çështje.

Meqenëse e kam kryesuar një komision, Komisionin për Buxhet e Financa, ne si Komision kemi qenë kundër miratimit të ligjit për memorialët e Kosovës, sepse nuk kemi qenë të pajtimt që të formohet një agjenci për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës dhe t'i raportojë Kuvendit, sepse ka pasur edhe kosto shtesë buxhetore dhe nuk e kemi parë të arsyeshme që të miratohet. Megjithatë, vullneti i deputetëve ka qenë që të miratohet një ligj i tillë që parasheh themelimin e kësaj agjencie për menaxhimin e komplekseve memoriale dhe tash po shqyrtojmë raportin vjetor dhe raportin financiar të kësaj agjencie.

Unë dua t'ua kujtoj deputetëve që kjo agjenci ka funksionuar nja 3 – 4 muaj se s'ka pasur më shumë kohë për të funksionuar. Me rishikimin e buxhetit është paraparë buxhet për drejtorin dhe 3 punëtorë të cilët është dashur të barten nga Ministria e Planifikimit Hapësinor. Kjo agjenci ka funksionuar tek pasi është miratuar buxheti që ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese dhe është kthyer. Domethënë, ka zhvilluar aktivitetin vetëm drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Memorialëve, sepse 3 punëtorët nuk janë bartur nga Ministria gjatë vitit 2013.

Ne mund të hedhim lloj-lloj akuzash dhe problemesh të cilat janë paraqitur, sepse vetë drejtori i Agjencisë i ka nxitur këto debate në bazë të raportit të cilin e ka sjellë këtu.

Kjo agjenci i ka pasur pra të ndarë mjete për buxhet, mjete për t'i shfrytëzuar për mallra e shërbime, i ka pasur 10 mijë euro, që i ka shpenzuar diku 88%, e ka pasur buxhetin në total që e ka harxhuar prej 72% dhe thashë që ka funksionuar vetëm drejtori i kësaj agjencie.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar raportin financiar dhe në bazë të asaj çka është planifikuar është vërejtur që nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet të cilat janë planifikuar dhe Komisioni për Buxhet e ka miratuar raportin financiar të kësaj agjencie.

Mirëpo, meqenëse këtu u diskutua shumë edhe për varrezat, dhe u përmendën varrezat në Skenderaj, të dëshmorëve, e të tjera, e të tjera, unë dua ta them edhe një gjë. Po qe se shkojmë dhe i vizitojmë varrezat në Prishtinë, ne shohim aty që janë ndërtuar këto varreza në Prishtinë dhe secili që shkon aty do ta ndiejë veten keq, sepse nga varrezat e dëshmorëve të cilat janë ndërtuar në Prishtinë, janë të përjashtuar nga ndërtimi varrezat e dy heronjve të shpallur të Kosovës, Jashar Salihut dhe Xheladin Gashit - Plakut. Domethënë, ato dy varreza të këtyre dy heronjve janë përjashtuar nga rregullimi i varrezave. Dhe, dikush duhet këtu të ndihet keq që është marrë me planifikimin e ndërtimit, meremetimit të varrezave të dëshmorëve dhe nuk e di qysh merret një vendim për t'u ndërtuar, për t'u meremetuar varrezat dhe përjashtohen varrezat e ish- gjeneralëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe heronjve të shpallur nga presidentja e Kosovës, si heronj të Kosovës.

Prandaj këtu është një çështje që kërkon debat, kërkon diskutime, kërkon analiza të kësaj çështjeje dhe fundi i fundit nëse ka keqpërdorime në fusha të tilla për të gjithë atë që ka bërë keqpërdorime le të veprojnë institucionet të cilat janë kompetentë për të verifikuar keqpërdorimet dhe për të verifikuar edhe forma tjera korruptive të cilat kanë mund të ndodhin.

Nëse gjithkund mund të ndodhin keqpërdorime dhe dukuri negative, tek varrezat e dëshmorëve është dashur që njerëzit të jenë vërtet, vërtet të ndërgjegjshëm që këtu mos të ndodhin gjëra jo të mira, sepse janë diçka e shenjtë në të cilën lidhet historia e kombit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë po ndihem keq nga diskutimet, sinqerisht po ju them. Dhe nuk e di, edhe unë nuk e di çka ka ndodhur, por megjithatë s'dua ta hap këtë debat. Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Desha edhe një herë të theksoj që Kuvendi e ka themeluar Agjencinë. Është caktuar drejtori i Agjencisë. Ajo që del nga raporti është që drejtori i Agjencisë nuk ka arritur t'i kryejë detyrat të cilat ia ka caktuar Kuvendi.

Në arsyetimin e tij, ai thotë që jam penguar nga ministria përkatëse në realizimin e detyrave të tij.

Në këtë kuptim raporti është i plotë, sepse thotë të gjitha ato që i ka bërë drejtori gjatë punës së tij katër mujore, prandaj edhe mendoj që si raport i tillë duhet të miratohet, edhe pse mendoj që ka shumë paqartësi se kush mban përgjegjësinë për faktin që nuk është funksionalizuar si i tillë.

Nëse vërtetohen ato që i thotë drejtori sa i përket dyshimeve për korrupsion, me këtë duhet të merret prokuroria. Nëse ai ka thënë të pavërtetën sa i përket dyshimeve për korrupsion, merr gjithashtu përgjegjësi para ligjit dhe dënohet për mashtrim të Kuvendit.

Ajo që bie në sy këtu është që në njëfarë mënyre drejtori i Agjencisë i bën ftesë Kuvendit duke thënë: situata është shumë e rëndë, unë s'po arrij t'i kryej detyrat të cilat mi ka caktuar Kuvendi. Prandaj mendoj që Kuvendi duhet t'i japë një përgjegjësi, duhet të përcaktohet se çka kërkon prej Agjencisë dhe kjo është arsyeja pse i bëra disa rekomandime të cilat ndoshta do të ndihmonin që të dalë e vërteta rreth kësaj situate. Jam shumë i bindur që edhe ju, që jeni të pranishëm këtu nuk e dini se cila është situata në agjencinë për të cilën po flasim. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë s'di kush për cilin agjenci e di qysh është situata, po zoti Hasani, çka deshe? Replikë apo ke diskutim? Replikë.

NAIT HASANI: Faleminderit!

E kam marrëveshjen mes Agjencisë, drejtorit të Agjencisë dhe Ministrisë e anëshkruar më 14.1.2014. I gjithë raporti flet për 2013. Dhe ky hyn edhe për 2014. Do të thotë drejtori i Agjencisë nuk e ka kuptuar ligjin, këtu është çështja më e rëndë. Ai flet për marrëveshjen më 14.1. më 10.1.2014 dhe tregon për marrëveshjet, për takimet, për të gjitha ato që i ka bërë më 2013. Nuk ka mundësi drejtori i agjencisë t'i marrë projektet të cilët janë në menaxhim në vazhdimësi, këtë nuk e lejon kodi buxhetor. Ai ka folur.

Po e thashë edhe më herët dhe e them edhe një herë që një ujësjellës për ujitjen dhe mirëmbajtjen e kompleksit të Jasharajve atje, ka qenë i kontraktuar nga ministria me 600 mijë euro, është prishur nga një kompani që ka intervenuar dhe në ofertën e dytë që e ka hapur drejtori i Agjencisë i ka marrë ofertat që i ka kundërshtuar me 850 mijë euro. Do të thotë këtu e kemi dyshimin se drejtori i agjencisë është i implikuar në të gjitha këto lojëra dhe ai nuk e ka bërë raportin, por është marrë me çështjen e tenderëve, nuk është marrë me mirëmbajtjen e komplekseve memorialë. Prandaj, komisioni ka kërkuar sqarime shitesë prej tij dhe t'i plotësojë, ai nuk ka dashur të merret me këtë çështje, por është marrë me akuza ndërmjet ministrisë dhe komisionit.

Kërkoj që raporti të mos miratohet, t'i kthehet agjencisë, ta plotësojë me dokumente me të cilat ai është marrë, me të cilët është marrë me menaxhim, çka ka menaxhuar ai për 3 muaj. Ai le të na tregojë, të mos të na tregojë neve, ka pasur mundësinë apo s'ka pasur mundësinë t' i bëjë me 3 veta atje që i ka pasur. Këtë e ka ditur që nuk ka mundësi t' i ketë me 3 veta dhe nuk ka mundësi t' i realizojë të gjitha...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë vetëm desha ta theksoj një fakt që ne si Kuvend nuk duhet ta paragjykojmë përgjegjësinë e askujt dhe aq më shumë të njerëzve që i kemi zgjedhur vetë këtu, sepse bëjmë keq. Një paragjykim i përgjegjësisë së tillë i bie para aktit të kryer institucionet që janë përgjegjëse me ligj dhe me Kushtetutë për atë punë.

Prandaj ju kisha lutur që këtë punë duhet t'ia lëmë ne organeve kompetente të cilat do të merren me siguri me këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tahiri, e ke kryer diskutimin.. Po tërë kemi histori o burrë! Kryetari i komisionit foli çka foli. Jo burrë, sa herë që të na bie ndërmend, s'po e marrim fjalën. Nuk ka tjerë të paraqitur. Nuk ka kuorum.

(Ndërhyrje)

Po qysh t' i thërrasim me çka? Çka të bëj. 49 veta jemi. Unë s'kam asnjë kompetencë, as t' i thërras as t' i detyroj, por ta zbatoj Rregulloren, mund t' i detyroj t' ua ndalë mëditjet. Po, sa të vjen kryetari.

Pika e dhjetë e rendit të ditës, është prapë raport:

10. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013.

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit funksional zoti Nait Hasani, do ta bëjë arsyetimin e raportit me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetët po më duket janë të interesuar ta lëshojnë sallën, sa po e shoh, interesimi ka ra.

Komisioni për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe Kanalizimeve dhe ka dhënë përkrahjen dhe mbështetjen që të miratohet ky raport. Është më i mirë se i vitit 2012, është më i mirë dhe më i avancuar për plotësimin e kushteve dhe standardeve të cilat kërkohen për ujin dhe kanalizimet, prandaj kërkon nga Kuvendi që të miratohet dhe me një kërkesë që të avancohet edhe më tutje kjo çështje e ujit dhe e kanalizimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së zoti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina dhe konsideron që ky raport është raport i mirë dhe kërkon nga deputetët që të miratohet raporti i kësaj zyre të rregullatorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Kanalizim për vitin 2013 i prezantuar vlerësohet të jetë si një raport më i avancuar se vitet e kaluar, mirëpo nuk do të thotë kjo se janë eliminuar tërësisht problemet me të cilat ka punuar ky institucion, siç janë faturimi, pajisja e qytetarëve me ujëmatës si dhe përqindja dhe ndryshimi i lartësive të shumave të arkëtuara në përgjithësi.

Ndërsa sa i përket humbjeve të ujit, ende vazhdon një gjendje jo e kënaqshme në të cilën duhet punuar në të ardhmen.

Megjithatë raporti është vlerësuar pozitivisht dhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës do ta votojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ky raport paraqet një gjendje që e kemi në funksionimin e këtyre kompanive. Në nivel sektori kemi edhe mos përmbushje të faturimeve që janë rreth 18%. Po ashtu edhe sipas raportit, në nivel sektori ka tejkalime të shpenzimeve që janë negative e shkojnë 25%.

Mbulueshmëria e shpenzimeve me ujë të pastër arrijnë mbi 80%. Faturimi i ujit gjatë vitit 2013 është afër 58 milionë metër kub, ndërsa uji i pa faturuar është 77 milionë. Po ashtu e kemi një gjendje jo shumë të mirë edhe në Ibër-Lepenc, ku të gjithë treguesit janë negativë.

Megjithatë ky raport është i mirë, paraqet një gjendje reale që e kemi në këtë sektor, paraqet një impenjim të këtij stafi që punët të përmirësohen në vazhdim dhe vërtet të punohet mirë në përpjekje për ta përmirësuar një gjendje që është evidente.

Problem i madh është si duket, që paraqitet vetë, edhe këtu është mungesa e ujit të pijes dhe mungesa e hulumtimeve, e punëve që duhet të bëhen për t'u furnizuar qytetarët me ujë të pijes i cili për fat të keq këtë vit, para rënieve të këtyre reshjeve ka qenë një gjendje shumë alarmante dhe shumë e rëndë. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Duke pasur parasysh se uji, ujësjellësi dhe kanalizimi përbëjnë aspekte të rëndësishme për jetën, kualitetin e jetës, shëndetin e njeriut dhe ambientin, raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim është i rëndësishëm për të gjithë ata që kanë interes të njihen me gjendjen dhe problemet me të cilat po ballafaqohet ky sektor.

Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim sjell të dhëna interesante për dy fusha kryesore, për situatën rreth ujit dhe kanalizimit dhe për organizimin e kompanive rajonale të ujësjellësit.

Për mua është shumë shqetësues fakti që në shumë komuna si Gjilani, Mitrovica apo Prizreni, mbulueshmëria me ujësjellës është akoma shumë e ulët, diku prej 57 deri në 65%.

Të mos ofrojmë shërbime ujësjellësi për 43% të banorëve si në Gjilan, vërtet është skandal edhe për ndërmarrjen që ofron atje shërbime, edhe për Qeverinë që nuk po sjell rezultate, edhe për Rregullatorin që lejon diçka të tillë.

Kanalizimi i ujërave të zeza është problem shumë serioz. Ne akoma nuk kemi rrjet për kanalizim që përfshin nevojat e banorëve. Për shembull në Pejë, vetëm 42% e banorëve mund të shfrytëzojnë shërbimet e kanalizimit. Madje, edhe në vetë kryeqytetin e Republikës së Kosovës, vetëm 79% e rrjetit të nevojshëm të kanalizimit është instaluar dhe funksional.

Ajo që do të prisja nga raporti e që mungon janë të dhënat lidhur me trajtimin e ujërave të zeza. Raporti nuk e thotë asnjë fjalë për trajtimin e tyre. Mjerisht ato përçudnojnë në shumë raste në lumenj, të pakolektuar duke kthyer lumenjtë në ujë të keq, në lumenj urinash e fekalesh të cilat në forma të ndryshme kthehen përsëri në sisteme të ujit të pijes, për shembull përmes puseve private.

Duke pasur parasysh këtë gjendje besoj që nuk ka nevojë të flasim për pasojat e ndotjes së ambientit dhe rrezikun e sëmundjeve që sjell kjo gjendje.

Testet bakteriologjike dhe kimike tregojnë që uji që ne e pimë nuk është gjithnjë i sigurt. Kur është fjala tek uji nuk mjafton siguria prej 75%, por ajo duhet të jetë gjithnjë 100%.

Analiza e raportit sjell një fakt shumë interesant. 57% e ujit që ne e prodhojmë në Kosovë nuk faturohet. Thjeshtë uji humbë, nuk dihet kah shkon dhe nuk e paguan askush. Edhe pjesa e faturuar prej 43% nuk paguhet e tëra. Nga pjesa e faturuar 22.27% e ujit nuk inkasohet. Pra, prodhojmë shumë ujë, më shumë se gjysma humbë dhe gati gjysma e gjysmës nuk inkasohet fare.

Nga kjo situatë dalin disa probleme që KRU-të nuk kanë njohuri se ku shkon uji i prodhuar, mungojnë mekanizmat e kontrollit dhe nuk janë efikase në fushën e inkasimit.

Nga trajtimi që ne i bëjmë ujit del se uji në Kosovë është krejt i pavlefshëm për shkak të humbjeve, për shkak të çmimit të ulët dhe për shkak të inkasimit të pjesshëm.

Ne kemi çmimin më të ulët në rajon të ujit për përdorim shtëpiak. Çmimi i ulët për një burim natyror të kufizuar, trajtimi jo serioz i tij, harxhimet pa masë aty ku ka do të lënë pasojat të shpejta për ujin dhe do të ndikojnë në çmimin e ujit i cili mund të jetë në një kohë të ardhshme më i shtrenjtë se nafta.

Zyra e Rregullatorit ka bërë një varg rekomandimesh të cilat janë të mira, por shumë të përgjithshme dhe nuk obligojnë asnjërin palë, as Qeverinë, as komunat dhe kuvendet komunale e as kompanitë rajonale për të ndërmarrë hapa konkretë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit kryesues!

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar raportin. Raporti është raport i mirë, pasqyron gjendjen reale dhe të njëjtin do ta përkrahim.

KRYESUESI: Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, meqenëse kjo zyrë është e obliguar që bashkërisht me raportin vjetor të dorëzojë edhe raportin financiar.

Në bazë të analizës së raportit financiar shohim se kjo organizatë buxhetore ka realizuar buxhetin në total prej 95,31%. Kategoria e shpenzimeve komunale ka pasur nivel më të ulët të realizimit prej 71,10%, ndërsa në kategorinë paga dhe mëditje buxheti është realizuar 99,61% si dhe në kategorinë mallra dhe shërbime 92%. Po ashtu është vlerësuar se në asnjë nënkategori ekonomike nuk ka pasur tejkalim të buxhetit, çka do të thotë që buxheti është shpenzuar në bazë të dinamikës së planifikuar.

Të hyrat e realizuara të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim janë në vlerë 326 276 euro. Në kategorinë të hyrat nga shitja e shërbimeve licenca, të hyrat janë në nivel më të ulët në krahasim me planifikimin për 6 738 euro, ndërsa në kategorinë gjobat tjera nuk ka figuruar se ka të hyra të planifikuara, megjithatë janë realizuar 2 460 euro.

Për të gjitha çështjet të cilat kanë qenë në fokus të interesimit nga ana e deputetëve në Komisionin për Buxhet e Financa janë dhënë sqarime të duhura nga personat kompetent të Zyrës për ujësjellës dhe kanalizim dhe pas marrjes së sqarimeve nga ana e këtyre përfaqësuesve të kësaj zyre, Komisioni për Buxhet dhe Financa unanimisht e ka përkrahur raportin financiar dhe ka rekomanduar Kuvendin që të bëjë miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Unë mendoj ta ndërprejë seancën, për nesër e lëmë.

(Ndërhyrje)

Jo, jo s'kemi çka të bëjmë fjalë kot. Nuk ka kuptim, tri raporte. Pra, nesër fillojnë në orën 10:00. Mirupafshim!

* * *

E martë, 6 maj 2014

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 5 maj 2014

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po fillojmë me votimin e raporteve që na kanë mbetur pa u votuar dje. Po i kryejmë raportet dhe votimin e fshehtë dhe u kthehemi ligjeve.

Në sallë janë të pranishëm 71 deputetë. Votojmë për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Votimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi për votim është shtyrë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 64 vota për, 2 abstenime dhe asnjë kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Votimi i raportit vjetor për vitin 2013 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi për votim është shtyrë.

Në sallë janë të pranishëm 75 deputetë. Lus regjinë dhe juve kolegë dhe kolege që të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 38 vota për, 25 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor për vitin 2013 të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Votimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013

(Reagime nga salla.)

Kur t'i kryejmë këto, kthehemi. Po në këto kemi mbetur, o burrë!

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi për votim është shtyrë.

Në sallë janë të pranishëm 75 deputetë.

Lus regjinë dhe ju, të nderuar deputetë, të përgatitemi për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se me 69 vota për, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2013.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Ahmet Isufi. Nuk është këtu. Kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013 dhe konsiderojmë që i plotëson kushtet për miratimin e këtij raporti. I ftojme deputetët ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka paraqitur para komisionit dhe para Kuvendit një raport, i cili, si të gjitha agjencitë tjera, e përshkruan punën e tij dhe aktivitetet.

Fillimisht dua të them që kjo agjenci paraqet si sfidë qëndrimin dhe kryerjen e aktiviteteve në objekt privat. Dhe, në këtë rast dua të them që, me sa më kujtohet, në vitin 2008 kryeministri Thaçi i pati dhënë një urdhër atëherë Ministrisë së Shërbimeve Publike që të gjitha institucionet qeveritare të akomodohen në objekte qeveritare, e kjo gjë tash e gjashtë vjet nuk ka ndodhur. Dhe, kjo agjenci nuk është e vetmja që e zhvillon punën dhe

aktivitetin në objekte private, por kemi edhe agjenci tjera të shumta. Andaj, nuk di se kujt po i konvenon kaq shumë që paratë e taksapaguesve të shfrytëzohen për qiradhënie.

Caktimi i zyrtarëve mbrojtës të të dhënave personale, si në organe publike, ashtu edhe në ato private, agjencia thotë që ishte mjaft e suksesshme. Mirëpo, në brendi të raportit prapë flitet për angazhimin e agjencisë për rëndësinë e caktimit të zyrtarit mbrojtës dhe thuhet që më tepër kanë pasur sukses në institucionet private sesa në ato publike.

Me theks të veçantë, ngecjen e caktimit të zyrtarit mbrojtës në komuna, e kjo të bën të mendosh pse institucionet private janë të interesuara që t'i mbrojnë të dhënat personale, ndërsa institucionet publike nuk mund të binden se sa është i nevojshëm caktimi i zyrtarit mbrojtës të të dhënave personale.

Gjithashtu, problemi i vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me këtë fushë, pak a shumë të re në vendin tonë, është gjithashtu një sfidë, sepse kemi nivel të vogël të të arriturave të kësaj agjencie për vetëdijesimin e qytetarëve, sepse nuk ekziston një ligj që i mbron qytetarët në këtë aspekt.

Gjithashtu, rritja e vogël e numrit të ankesave drejtuar agjencisë pasqyron njohuri ende jo të mjaftueshme lidhur me të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat ua garanton ligji në fjalë.

Një gjë që e thotë raporti, e që nuk ka pasur nevojë ndoshta edhe ta përkrahë në këtë material, është: “Në raport theksohet se të punësuarit në agjenci nuk ushtruan veprimtari politike, përkundër zgjedhjeve lokale, që u organizuan në vitin e kaluar”. Nuk di se kush e ka bërë këtë verifikim të këtyre punëtorëve të kësaj agjencie se a kanë pasur aktivitet politik a nuk kanë pasur, kur e dimë fare mirë që vetë kryeshefi është një person politik. Përndryshe, agjencisë i mbetet shumë punë për të bërë, sepse është një agjenci e ri, një ligj së voni i miratuar në Kuvendin e Kosovës, andaj duhet pak më shumë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe mendon që ky raport duhet të votohet në këtë seancë.

Në raport, në të cilin janë përfshirë edhe sfidat që kjo agjenci i ka përshkruar dhe njëkohësisht i ka, ashtu siç i përmendi edhe zonja kolege më herët, vërtet kjo agjenci është përballur me sfida dhe sfidat më kryesore janë përfshirë në këtë raport.

Kështu që si grup parlamentar mendojmë që ta votojmë këtë raport dhe njëkohësisht do të duhej që Qeveria të bënte më shumë për ta, sidomos në ndihmën për këtë agjenci për kapërcimin e sfidave.

Njëkohësisht, më lejoni që edhe në emër të Komisionit për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së të kërkoj nga deputetët që ta mbështetin këtë raport. Pra, komisioni e ka shqyrtuar këtë raport dhe të gjithë anëtarët e komisionit e kanë votuar aprovimin e këtij raportit në seancë. Kështu që edhe në emër të komisionit, kërkoj nga deputetët që ta mbështetin.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është paraqitur. AKR-ja, jo. Vazhdojmë me diskutimet. Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se raporti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013, edhe në bazë të Kushtetutës dihet se shqyrtohet me një vit vonesë, mund të themi se ka qenë e mundur që ky raport të jetë më i mirë, mirëpo, në fakt, në bazë të raportit i cili është prezantuar, jep mundësinë që ky raport të votohet, mirëpo me shpresë që raporti i vitit 2014, kur të vijë në Kuvendin e Kosovës të jetë një raport më efikas. Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje këtij raportit.

KRYESUESI: Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për zotërinjtë ministrat që janë këtu të pranishëm,

Përshëndetje për të gjithë kolegët,

Unë desha vetëm të ndërlidhem me raportin se ne e kemi trajtuar si grup parlamentar dhe u deklarua Ramizi që e mbështetim. Pra, është një agjenci që është e re, por ka pasur suksese dhe rezultate të dukshme, dakordohem me parafolësin që ka sfida të mëdha dhe besoj që do t'i përballoj. Por, desha vetëm një sqarim: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk është më në objekt privat. Ka disa muaj që është e vendosur te Ministria e Punëve të Jashtme dhe besoj që është një çështje më pak ngarkesë për Qeverinë dhe për Buxhetin e Kosovës. Kështu që ata janë të vendosur aty dhe është informacion që besoj ka 4-5 muaj do të duhej të jenë të njoftuar, jo vetëm deputetët, por edhe opinioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrat e pranishëm,

Kolegë deputetë,

Unë kisha dy çështje për t'i trajtuar këtu, njërën e ezauroi dhe e konsumoi kolegu Elmi.

Është e vërtetë se shumica e Administratës Shtetërore që ka qenë në ndërtesa private është zhvendosur dhe krejt çfarë pasur mundësi të akomodohet në ndërtesat e institucioneve shtetërore është bërë, e një pjesë natyrisht që ende është ndonjë nga këto administrata nëpër ndërtesa private. Po ky institucion, Agjencia për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale është akomoduar mjaftë mirë dhe natyrisht që kaq muaj vazhdon me punë të suksesshme dhe komode.

Shqyrtimet që ia kemi bërë në grupin parlamentar këtij raporti më ka lënë përshtypje pjesa e zvogëlimit të ankesave të qytetarëve në lidhje me punën e kësaj agjencie mjaft të ndjeshme dhe jashtëzakonisht të rëndësishme.

Ajo çka është me rëndësi të nënvizohet në këtë raport është që qytetarët gjithnjë e më pak dhe madje shumë pak kanë adresuar ankesa te kjo agjenci dhe ky është një fakt se kjo agjenci ka filluar për së mbari dhe bënë një punë serioze dhe të përgjegjshme, e cila duhet të vlerësohet dhe të përgëzohet. Kështu që ky fragment në raportin e kësaj agjencie është pjesa që duhet vlerësuar dhe natyrisht që duhet përgëzuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Raporti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013 është një raport i hartuar mbi të dhënat reale, i cili paraqet qartë sfidat dhe përparësitë që ka pasur kjo agjenci gjatë punës së tij në vitin 2013.

U pajtuam të gjithë se është një fushë e re edhe vetë qytetarët kanë nevojë më tepër të dinë për ekzistencën dhe fushëveprimtarinë e kësaj agjencie. Mirëpo, shihet qartë se rezultatet e këtij raporti janë të preکشme dhe puna e kësaj agjencie ka bërë që me praninë e informatave në vende të caktuara, por edhe në rrethe të caktuara, të bëjë ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve, në përgjithësi.

Kur e mora fjalën, pikërisht desha të njoftoj që tashmë kjo agjenci nuk është në ndërtesë private, por, megjithatë, me që u tha nga kolegët e mi, nuk dua ta përsëris, por shpresoj shumë që efikasiteti i punës së këtij raporti është parë nga deputetët. Nuk di çka do të ketë një raport tjetër që të jetë efikas. Puna e tyre ka qenë shumë efikase dhe shumë e pranishme në çdo institucion tjetër dhe në çdo rast që është paraqitur për shkeljen e të dhënave personale, ose për cenimin e integritetit privat të çdo personi që ka bërë ankesë ose thjesht që e ka dërguar një shkresë në këtë agjenci. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kam përshtypje që ne nuk po e dimë as domenin e veprimit të kësaj agjencie. Ne e kemi një agjenci kundër korrupsionit që duhet t'ia japim të gjitha, edhe në qoftë se e pimë një gotë ujë më shumë, dhe e kemi një agjenci, e cila i mbron të dhënat dhe realisht Agjencia Kundër Korrupsionit t'i nxjerrë krejt në publik, prandaj nuk e di kah i mbron ky të dhënat.

E dyta, në shtetet demokratike mbrohen shumë të dhëna. Edhe diagnoza e një të sëmuri në qoftë se mjeku e bën publike, ai jep llogari para gjyqit. Edhe gjithçka që është private, kjo agjenci i mbledh të dhënat dhe i ruan. Ajo agjencia tjetër ka të drejtë vetëm në qoftë se dikush është i dyshimtë ta bëjë atë. Unë nuk di se çfarë të dhënash po mbron kjo

agjenci, ç'është e vërteta. Por, ne mirë që e kemi agjencinë, por këto dy agjenci duhet parë ligjërisht si mund të funksionojnë, kur njërit duhet t'i jepen të gjitha të dhënat dhe tjetri duhet t'i mbrojë këto të dhëna, dhe ai që i merr këto të dhëna i bën publike.

E dyta, nuk i kemi të gjitha agjencitë me zyre, siç u tha, sepse dy agjenci janë në ndërtesën e Kuvendit dhe s'kanë zyrë tjetërkund dhe i kanë zënë zyrat e deputetëve.

Dhe, i kemi zyrat e Presidentit ose Presidentes, për të cilën duhet të kujdesemi që t'i bëjë zyrat e veta jashtë ndërtesës së Parlamentit.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për dhe 9 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013.

Si të doni ia bëjmë. A ta bëjmë votimin e fshehtë, apo ligjet? Atëherë ligjet. Është kërkesë për të shkuar me ligjet.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Pajaziti, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nëpërmjet grupit punues dhe institucioneve tjera e ka trajtuar në lexim të dytë këtë projektligj.

Me miratimin e këtij projektligji kjo fushë rregullohet sipas praktikave më të avancuara dhe është e harmonizuar po ashtu edhe me ligjet e BE-së dhe ligjet tjera në fuqi në vendin tonë dhe po ashtu u është përshtatur rrethanave në Kosovë.

I lus deputetët dhe grupet parlamentare që ta mbështetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 60

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 61

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 62

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 63

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 64

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 65

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 66

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 67

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 68

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 85 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 75 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-220 për masat antidamping dhe masat kundër balancues.

Pika e shtatë e rendit të ditës, e mbetur nga dje:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetin Gëzim Kelmendi që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Në mungesë të Gëzimit, qenka caktuar Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2014, e shqyrtoi Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, të rikthyer në komision me vendim numër 781 të seancës së Kuvendit, më 13 shkurt 2014. Komisioni, pas shqyrtimit të raportit me amendamentet e datës 29 janar 2014, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2014, e hartoi raportin plotësues, ku e ndryshoi amendamentin 19.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 16. ..., 2014, me shumicë votash e miratoi raportin përfundimtar për projektin për skemat e pensionit të financuara nga shteti dhe e procedoi për miratim në Kuvend. Ndërkohë pak kemi diskutuar me deputetin Sabri

Hamiti, i cili e ka riformuluar amendamentin 7. Është mirë të merret në konsideratë se a mund ta marrim si amendament dhe të votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas...

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Po. Për çka?

FATON TOPALLI: Në lidhje me ligjin.

KRYESUESI: Për ndonjë amendament po, por për ligjin tash...

FATON TOPALLI: Jo, por mendoj që u fol në emër të komisionit, unë jam pjesë e tij dhe nuk pajtohem me atë që ky ligj i përmbush ato që kërkojnë pensionistët. Ligji, po dua ta them edhe këtë, këtu edhe një herë para gjithë juve, që ky ligj nuk sjell asnjë ndryshim përmbajtësor. E dyta, nuk përmbush nevojat e pensionistëve të Kosovës, nuk përmbush nevojat për një jetë me dinjitet. Ky ligj nuk është as ndihmë sociale, nuk është as pension, nuk është asgjë. Ky ligj nuk i krijon bazat për të pasur pensione të mirëfillta, sepse po të kishim dashur t'i krijojmë bazat për pensione të mirëfillta ne do të duhej ta kishim krijuar një fond për këtë çështje.

Ka më tepër se 100 vjet që në vendet perëndimore zbatohet parimi i solidaritetit ndërmjet gjeneratave. I njëjti parim zbatohet edhe në vendet në rajon, pra nuk është diçka e pamundshme. Thjesht, për shkak që kjo Qeveri nuk ka interes të merret me pensionistët fare, e ka rregulluar këtë çështje nëpërmjet skemave, të cilat paguhen nga shteti, e të cilat në njëfarë mënyre janë vetëm lëmoshë, janë vetëm ndihmë sociale, por nuk krijojnë bazat e nevojshme për pensione.

Mendoj që ne edhe si popull kemi nevojë t'i krijojmë kushtet që pensionet të jenë pensione të mirëfillta, e jo të luajmë me emra. Lajmi për pensionet që kemi, që do të krijojmë një ligj për pensionet, do të duhej normalisht të ishte një lajm i mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës, por përkundrazi ky është një lajm shumë i keq, sepse ne vetëm po e përmendim, vetëm po e bëjmë emrin pension, ndërsa në përmbajtje nuk po ndryshojmë asgjë. Thjesht, ne me këtë ligj po e ngarkojmë kot Buxhetin e Kosovës dhe nuk po përpiqemi që së paku si vendet në rajon nëpërmjet solidaritetit ndërmjet gjeneratave ta rregullojmë këtë çështje. Duke pasur parasysh se popullsia e Kosovës është një popullsi shumë e re dhe më e re ja në Evropë, mundësitë janë shumë të mëdha që edhe ky ligj t'i krijojë bazat për një pension të mirëfilltë të atyre që gjatë gjithë jetës kanë punuar për këtë çështje.

Vota kundër, vota domethënë...

KRYESUESI: Nuk je në temë, ne jemi në ligjin të cilin e kemi kaluar. Të lutem...!

FATON TOPALLI: ... Të lutem, ne po flasim për një çështje shumë të rëndësishme dhe ju kisha lutur që më lejoni ta përfundoj, jam gati para përfundimit - vota kundër as nuk e rrit, as nuk e zbeh çështjen e pensioneve. Nëse votojmë kundër këtij ligji, së paku do t'i japim shans dhe një mundësi një qeverie të ardhshme që ta bëjë, dhe një parlamenti të ardhshëm që ta bëjë një ligj të mirëfilltë kundër pensioneve. Të gjithë ju që votoni kundër, besoj se do ta keni më lehtë kur shkoni në shtëpi t'i shikoni baballarët dhe nënat tuaja, gjyshet dhe gjyshërit tuaj. Vota kundër këtij ligji është votë për pensione të mirëfillta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë shpresoj që do të zbulojmë naftë në Kosovë dhe atë që po themi se është e pasur me ar dhe argjend krejt Kosova, të fillojmë ta nxjerrim dhe ta shpallim popullin e Kosovës të pensionuar të përjetshëm, me rroga më të mëdha se në Kuvajt. Kjo puna e pensioneve është bërë përrallë, për çdo ditë nga një ligj për pensione. Ankesa ka gjithkund. Nuk ka replikë, por ne të vazhdojmë me amendamentet. Nuk kam hapur debat. Votojmë!

Amendamenti 1

Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë me elektronikë. Në sallë janë 77 deputetë. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum për vendimmarrje. Edhe një herë e votojmë. Amendamenti 1, Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

E lëmë të pushojë!

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionin për Buxhet.

Votojmë me elektronikë. Kush e do fjalën? Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit,

Komisioni për Legjislacion ka propozuar këtë amendament për precizim ligjor, mirëpo Komisioni FunkSIONAL nuk e ka parë të arsyeshme ta marrë, kështu që vendos seanca. Domethënë është çështje e teknikës legjislative dhe përshtatshmërisë ku thuhet çka njihet si pension dhe ideja është që si pension të njihen të gjitha ato kontributet tona deri në vitin '89, pastaj do të jetë një amendament tjetër 89/99. Por, deri në vitin 89, sipas

Gazetës Zyrtare të asaj kohe. Kjo është ideja e propozimit juridik se ku bazohen këto pensione. Çka konsiderohet pension kontributdhënës, domethënë duhet referuar diku. Këta nuk e kanë pranuar, nuk e di pse. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Hadërgjonaj, për amendamentin.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka përkrahur amendamentin 5 që ndërlidhet njëkohësisht edhe me amendamentin 14, i Komisionit për Legjislacion. Arsyet pse ky komision nuk e ka përkrahur kanë qenë në atë se ka vlerësuar se amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion për periudhën 15-vjeçare si dëshmi për ta gëzuar të drejtën në pension e krijon një kosto shtesë të pakalkuluar buxhetore, që do ta rrezikonte implementimin e këtij ligji dhe njëkohësisht do ta rrezikonte edhe marrëveshjen e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar sa i përket vlerësimit të koston buxhetore për zbatimin e këtij ligji.

Në bazë të informatave me shkrim, të cilat i kemi kërkuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të cilat na i ka sjellë në komision, që është zbatuese e këtij ligji, thuhet se edhe Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor, numër 0112483, Gazeta Zyrtare e Kosovës së atëhershme, minimumi i stazhit kontributdhënës është përcaktuar në 15 vjet. Komisioni ka vlerësuar se ligji do të binte në kundërshtim edhe me rregullativat e mëparshme, por njëkohësisht do të binte edhe në kundërshtim me marrëveshjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar, prandaj ka rekomanduar që ky amendament të mos votohet dhe po ashtu edhe amendamenti 14, që njëkohësisht ndërlidhet me amendamentin 5. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Amendamenti 5 ka të bëjë me përkufizimin se çka konsiderohet pension kontributdhënës, ndërsa amendamenti 14 ka të bëjë me të drejtën e pensionit kontributdhënës dhe mënyra se si është propozuar është në kundërshtim me të gjitha konventat dhe me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Nuk mund t'ia kufizosh atij që ka punuar 14 vjet e 364 ditë t'i thuhet ti nuk ke të drejtë në pension. Kushdo që ka dhënë kontribut në Fondin Pensional të Kosovës, edhe pse ai fond më nuk ekziston, sepse e ka marrë Serbia, i garantohet e drejta e pensionit të përshkallëzuar në bazë të kontributit që ka dhënë. Nëse ka dhënë kontribut një vit, i takon për një vit, nëse ka dhënë 5 vjet - 5 vjet, nëse 15 vjet - 15 vjet, nëse 25 vjet - 25 vjet, por nëse e vëmë prag 15-vjetëshin, ajo është problematike, sepse e mohon të drejtën e pronës. Kontributi pensional është e drejtë pronësore, sepse është ndalur nga kontributet tua, nga e drejta jote e punës, prandaj mendoj se është problematike kjo si po e trajtojnë këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e keni fjalën, për amendamente.

KYMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Arbeni i dha sqarimet shumë mirë. Unë desha të ndërlihem me zonjën Hadërgjonaj që tha se prishet marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe foli për kostot buxhetore. Ne nuk duhet të na kujtohet marrëveshja dhe marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar kur është fjala për Ligjin për pensionet dhe ligjet tjera me rëndësi vitale, sepse kur jemi në kohë fushate, dhe kryeministri, kryetari i partisë suaj, absolutisht nuk po e merr parasysh Fondin Monetar Ndërkombëtar, prishjen e marrëdhënies me ta dhe respektimin e rregullave. Kështu që ky është argument komplet i pabazë, që ne duhet ta kemi parasysh Fondin Monetar Ndërkombëtar. Shikojini vetëm vendimet e muajit të fundit dhe mandej flisni për Fondin Monetar Ndërkombëtar.

KRYESUESI: Për amendamentin! Lëre Fondin Monetar Ndërkombëtar, për amendamentin në qoftë se ke diçka. Safete, a ke shtesë diçka?

SAFETE HADËRGJONAJ: Meqenëse e kryesoj një komision, dhe në komision kemi votuar kundër këtij amendamenti, unë jam e obliguar t'i paraqes qëndrimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne nuk e kemi marrë kokë më vete këtë vendim, kemi kërkuar informatat e nevojshme edhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të cilët na janë përgjigjur me kërkesat që i kemi bërë si komision dhe kemi ardhur në përfundim që ky amendament ka kosto shtesë buxhetore dhe ne jemi të obliguar t'i tregojmë Kuvendit që ka kosto shtesë buxhetore dhe Kuvendi mandej të vendosë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk e pata në plan të diskutoj për këtë temë, por duhet të sqaroj diçka. Ajo çfarë ka bërë Komisioni për Legjislacion është ta eliminojë një mundësi të diskriminimit. Nuk mund një Komision për Buxhet dhe Financa, që e ka për obligim t'i shohë financat e shtetit, të thotë po e eliminojmë prej një skeme një kategori të caktuar për t'i ruajtur mjetet e buxhetit. Mund të jetë jodiskriminues, le t'i ulë krejt, por nuk mund të thotë që një pjesë që ka ekzistuar dikur po anashkalohej. Domethënë, esenca e problemit është që pa këtë provizion që ka hyrë, mund të ketë elemente diskriminuese për pensionistët. Kjo është krejt çka tha edhe zoti Gashi dhe të tjerët. Nuk ka diçka tjetër këtu. Nuk mund të thirret dikush, edhe njëherë po them, në ruajtje të buxhetit, duke pasur një element diskriminues aty. Nuk bën ashtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Do të përpiqem ta jap edhe unë kontributin tim ndërmjet këtyre dy debateve në emër të komisioneve dhe të dy arsyetimet kanë rezon, por unë e lus Komisionin për Buxhet dhe Financa që të ketë edhe vullnet, përveç rezonit, dhe ta pranojë arsyeshmërinë dhe arsyetimin e Komisionit për Legjislacion, i cili është mjaft i arsyeshëm dhe jashtëzakonisht i arsyetuar. Kështu që këtu duhet të gjendet një kompromis dhe duhet të deklarohet dhe të deklamohet edhe një vullnet më shumë i Komisionit për Buxhet dhe Financa që të harmonizohen këto arsyetime, të cilat të dyja e kanë bazën, e kanë logjikën e tyre, por natyrisht që arsyetimi i Komisionit për

Legjislacion është mjaft domethënës dhe duhet të merret në konsideratë nga Komisioni për Financa dhe Buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë besoj se përfaqësuesit e komisioneve do të duhej të jenë të përgatitur që menjëherë t'i thonë vërejtjet që i kanë ndaj njëri-tjetrit, e jo ka 5 herë të paraqite. Megjithatë, fjalën e ka zoti Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë mendoj ka të drejtë në fitimin e humbur dhe ky Kuvend nuk ka të drejtë ta cenojë këtë të drejtë, apo ta kufizojë. Njerëzit që e kanë humbur punën e vet, mundin e vet, paranë e vet, ata kanë të drejtë që ta bëjnë një kërkesë të tillë dhe kjo është e drejtë e ligjshme. Mendoj që këtë amendament duhet ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, nënkryetar!

Mendoj se pensionistët edhe deri më tani janë të diskriminuar me pensionet e ulëta që i marrin dhe tani me këtë rritje, pensionet prapë janë të ulëta, andaj në këtë rast mendojmë që nuk duhet të diskriminojmë më shumë dhe duhet të përkrahet Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Safete, nëse i ke edhe dy fjalë se... Ok! Në rregull, atëherë. Safetja i ka edhe dy fjalë, le t'i thotë. Edhe zonja Bajrami dëshiron të flasë.

SAFETE HADËRGJONAJ: Ju lutem, këtu po kërkohet të punojmë në bazë të vullnetit. Vullneti është diçka tjetër, e realiteti është diçka tjetër, se ne kemi vullnet t'i rregullojmë shumë çështje, të bëjmë shumë punë, por këtu në nenin 8, paragrafi 1, 2 të riformulohet si vijon: ka propozuar Komisioni për Legjislacion. Duhet të ketë stazh pensional kotnributdhënësi sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 01, Gazeta Zyrtare e Kosovës, më 26/83, para datës 1.01.1999. Në këtë ligj që është referuar Komisioni për Legjislacion, po ashtu stazhi kontributdhënës është i përcaktuar 15 vjet. Unë e thashë edhe më përpara - ne kemi kërkuar informata, kemi ardhur në këtë përfundim si Komision për Buxhet dhe Financa, kurse vendimin përfundimtar e merr seanca, meqenëse ne kemi vlerësuar se ky amendament ka kosto shtesë buxhetore.

KRYESUESI: Zonja Bajrami e ka fjalën!

KYMETE BAJRAMI: Kryesues! Kam vërejtje si po e drejton seancën! Zonja Hadërgjonaj nuk e kërkoi fjalën...

KRYESUESI: Ndalja fjalën! E ndërpres debatin. E hedh në votim

(Reagime nga salla.)

KRYESUESI: E hedh në votim. Është kryetare e komisionit dhe ka të drejtë të sqarojë. Edhe Arbeni ka të drejtë sa herë të dëshirojë të sqarojë. Nuk ke nevojë të u nervozohesh.

Kjo është punë procedure. Për inat as për qejf askujt nuk ia jap fjalën. Kisha shkuar diku tjetër tash, më mirë do të ishte të jem diku tjetër.

Votojmë amendamenti 5. Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe Komisionit për Buxhet. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 59 vota për, 7 abstenime, 6 vota kundër, miratohet amendamenti 5 i Komisionit për Legjislacion.

Amendamenti 6

Janë dy propozime. a) Komisioni Funkcional dhe b) Komisioni për Legjislacion. A do dikush të flasë? Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Këtu u bë pak tollovi që të jenë të qartë edhe deputetët. Tash është momenti kur njihet kjo e drejta për të gjithë që kanë dhënë kontribut. Domethënë, amendamenti thotë: neni 12, paragrafi 2 të fshihet për 15 vjet. Domethënë, ajo fjala për 15 vjet kontribut fshihet dhe kushdo që ka dhënë kontribut, ministria përkatëse e nxjerr skemën, e përcakton kush ka dhënë 1 vit, kush 3 vjet, kush 5 vjet, ua cakton sa u takon me akt nënligjor dhe nuk ka pse të bëhet tërë kjo luftë pa nevojë. Po më duket e paarsyeshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dikush tjetër? Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Në fjalën time të mëparshme desha të ik gjuhës elektorale që u dëgjua nga parafolësit e mi, por tani edhe një herë dua të nënvizoj që në Komisionin për Legjislacion e kemi parë gjithë materien jashtëzakonisht seriozisht dhe e kemi debatuar me mjaft përgjegjësi. Të gjitha arsyetimet që i kemi dhënë dhe propozimin që e kemi bërë janë të pranueshme, të përpunuara, të analizuara dhe e thërras seancën që ta votoj çdo propozim tonin.

KRYESUESI: Zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit kryesues!

Po më duket se jemi duke folur për amendamentin 6, të cilin e ka propozuar Komisioni Funkcional. Po më duket, ne e kemi kufizuar brenda një viti, nuk i kemi lënë hapësirë ministrisë përkatëse të nxjerrë akt nënligjor ndoshta edhe më vonë se një vit. Ne e kemi kufizuar me vitin. Unë besoj që ne e kemi formuluar më mirë se Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryesues që ma dhatë fjalën për amendamentin, por unë e kërkoja fjalën edhe në fillim të seancës. Më fal që po devijoj ndoshta, kur u diskutua për Ligjin e pensioneve, sepse në komision kemi diskutuar gjatë. Plot dy vjet ky ligj po sillet në Kuvend dhe unë mendoj se është shumë më mirë të kalojë ligji dhe duhet

patjetër të kalojë, sepse ministria po pret nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me Zvicrën, me Austrinë dhe shumë qytete tjera, ku i kemi edhe bashkëqytetarët tanë atje.

Nuk është ndoshta ligji më i përkryer, por është shumë më i mirë. Ky ligj nuk po pengon edhe rritjen e pensioneve dhe për amendamentin tash po flas. E di ju kërkoja falje, por nuk ma dhatë me kohë, dhe për amendamentin Komisioni Funkcional e ka kufizuar kohën në një vit, ndërsa Komisioni për Legjislacion ka lënë hapësirë të pakufizuar. Andaj unë ju ftoj ta votoni amendamentin e Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Po, edhe kjo nuk është pjesë e pikës ndoshta, por parafolësja e përmendi çështjen e Zvicrës dhe të vendeve tjera sa u përket pensioneve. Dua t'u them deputetëve që nuk është fare e vërtetë që me këtë ligj plotësohen kushtet për t'u krijuar pensionet për arsye se, nëse e marrim shembull, Zvicra ka kërkuar që të pastrohen lista, të dihet të cilët janë qytetarët që jetojnë dhe ata që nuk jetojnë, gjë që nuk kemi bërë as me listat e votimit. Pastaj, janë edhe disa kërkesa tjera, të cilat nuk janë realizuar, kështu që mos e lidhni ligjin me çështjen e pensioneve të Zvicrës, sepse nuk ka të bëjë me këtë çështje dhe, e dyta, edhe po të ishte deri në fund kështu, nuk mund t'i rregullojmë ligjet, të cilat një pjesë i krijojnë përparësi, ndërsa pjesës tjetër i krijojmë mangësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kisha preferuar replika. Nuk ta përmendi emrin. Po mirë, zonja Mustafa. Po ia jap të drejtën për kundër-replikë.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta kolegu e di më mirë se ishte shtetas i Zvicrës, por Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale na ka sqaruar në komision se pse po has në këto pengesa. Një ndër kriteret që duhet të plotësohet është edhe Ligji për pensionet e financuara nga shteti dhe Ligji për sigurime shëndetësore, i cili ka kaluar në Kuvend. Andaj, thashë edhe një herë, nuk është ndoshta ligji më i mirë, por është ligji i cili na duhet për të gjithë dhe ky ligj nuk po pengon edhe të rriten pensionet. Gjithashtu, shumë ligje i kemi pasur në plotësim-ndryshim, mund edhe ky të plotësohet dhe ndryshohet, por tash për tash ky është ligji më i mirë dhe u duhet pensionistëve. Edhe pensionistëve në vend, edhe pensionistëve që i kemi jashtë shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Unë nuk dua ta vazhdoj polemikën, veç desha të them që ky është ligji më i mirë që di ta bëjë PDK-ja, përndryshe të gjitha vendet e rajonit, të gjitha vendet e Evropës, e kanë një fond të solidaritetit, ku gjenerata e cila është e re, tani për gjeneratën e vjetër. Kjo ndodh gjithkund në vendet e civilizuara, në vendet që kuptojnë diçka nga sigurimet. Kjo Qeveri nuk mund të sjellë ligje më të mira, prandaj me kaq po e përfundoj.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe Norvegjia rezervat e naftës i ruan për gjeneratën më të re, po unë po e hedh në votim se përnjëmend është e tepërt, nuk ka nevojë. Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Është hera e dytë që po përmendet kjo çështja e solidaritetit vetëm sa për një sqarim, zoti Topalli është 15 vjet vonë. Ka qenë dashur për të vendosur në vitin 2000 për këto që po kërkon ky për shkak se sot të punësuarit paguajnë për veti në Trust edhe nuk mund t'ju kërkojë të paguajnë edhe për veti edhe për gjeneratën e vjetër.

Kjo është arsyeja pse prej fondeve të Qeverisë jepen pensionet, se nuk mund t'u kërkojë njerëzve të paguajnë dy herë. Domethënë, në vitin 2000 është vendosur kjo punë, 15 vjet më vonë jemi. Nëse duam të kthehemi 15 vjet përpara ndoshta edhe do të ishte më mirë unë nuk po them që nuk ka logjikë të ketë sistem të solidaritetit kur të punësuarit paguajnë për ata që janë në pension, por këtë e kemi kaluar shumë moti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia ke përmendur emrin zotit Topalli, e ka të drejtën në replikë.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Unë po i kthehem edhe njëherë asaj që thashë më herët, është një parim shumë i thjeshtë, punëdhënësi dhe punëmarrësi paguajnë së bashku dhe krijojnë një fond përmes të cilit paguhen pensionet.

Ne, në Kosovë kemi popullsi shumë të re, më të re në Evropë kështu që kemi një numër shumë të vogël të njerëzve që marrin pensione në krahasim me vendet tjera. Ky parim i solidaritetit zbatohet shumë thjeshtë, gjenerata e cila tani punon pagan për gjeneratën e cila është tani e pensionuar. Pra një parim shumë i thjeshtë i cili zbatohet gjithkund, zbatohet prej kohës së Bizmarkut në shtetet e Evropës Perëndimore. Pra, sa i përket vitit 2000 kjo nuk qëndron, sepse edhe në kohën e Bizmarkut ia kanë filluar prej zeros, domethënë, ka një moment kur fillohet, kështu që s'ka asnjë arsye që ky parim të mos zbatohet edhe tek ne edhe s'ka asnjë argument serioz i cili flet kundër një parimi të tillë solidaritetit që e bëjnë të gjitha vendet që janë pak a shumë normale.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Po më duket që ndoshta unë kam qenë i paqartë për të qenë shumë korrekt në fjalor kështu, për të njëjtën gjë po flasim, Për ta bërë këtë çka po kërkon deputeti Topalli duhet ta heqim Trustin Pensional, se nuk mund t'u thuash punëdhënësve edhe punëmarrësve, paguani edhe për Trust Pensional edhe për Fond të Solidaritet që ky po e quan. Nuk bën ashtu, ose duhet njeri ose tjetri.

Vendimet për trust janë marrë shumë moti edhe nuk mund të kthehemi mbas tani, kjo është arsyeja pse shteti duhet të paguajë për pensionistët që nuk kanë qasje në Trust, edhe duhet të paguajë edhe duhet t'ju rrisë pensionet.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Më nxiti ky debati i fundit, në fakt mendoj që zoti Gjini nuk po e thotë ashtu siç është çështja, me ose pa qëllim, nuk e di.

Sepse, një fond i ri i solidaritetit ndërmjet gjeneratave, i cili do të binte domosdoshmërisht në shtyllën e parë të pensioneve, pra njëra prej tri shtyllave që i kemi në sistemin pensional sot në Kosovë, as nuk e përjashton e as nuk e prek shtyllën e dytë që është Trusti i Kursimeve Pensionale, pra ku kursimet janë të obliguara për pension.

Këto dy shtylla mund të bashkëjetojnë me njëra-tjetrën edhe bashkëjetojnë nëpër vendet e ndryshme. Varësisht prej demografisë vendet edhe marrin vendim për atë se si e rregullojnë pensionin. Për ta qartësuar këtë, pensioni nuk është as lëmshë as që lidhet me kontributin domosdoshmërisht financiar të cilin e jep qytetari. Pensioni në fakt është e drejtë që e gëzon qytetari dhe shteti vendos me vullnet të vetin duke i pasur parasysh edhe rrethanat e veta se si do të realizojë këtë të drejtë për qytetarët e vet.

Dhe, për Kosovën kjo e drejtë më së miri do të realizohet meqenëse e kemi sistemin tashmë të implementuar tre shtyllës, që shtyllës së parë t'ia shtojmë fondin e solidaritetit mes gjeneratave e jo ta lëmë si shtyllë e cila paguhet nga tatimet e shtetit.

Tash të thuhet që nuk bën t'ju kërkojmë qytetarëve që të paguajnë edhe për solidaritetin edhe për shtyllën e dytë, atëherë po ua heqim atë pjesë të tatimeve që e paguajnë qytetarët prej nga vilet buxheti i shtetit i cili pastaj paguan pensione.

Dhe, mos të harrojmë një gjë, te kontributet shoqërore, Kosova është e fundit në Evropë edhe në rajon, pra më së paku ne paguajmë kontribute shoqërore. Ta shtosh një kontribut shtesë këtu, i cili do të ishte edhe për gjeneratat aktuale të pensionistëve, po pastaj do të përdorej si fond edhe për moshat më të reja kur ata do të vinin në pension, nuk është se e pengon ekonominë, përkundrazi e ndihmon ekonominë, sepse në njërin anë e liron shtetin ose buxhetin e shtetit nga barra e pensioneve dhe nga ana tjetër e krijon me kalimin e kohës një fond i cili do të ishte i përdorshëm edhe për investime në ekonomi dhe i cili do të paguante pensionet dinjitoze për qytetarët e vendit.

Dhe, për fund, kjo do të ishte edhe më mirë, sepse nuk do të hynte në marrëveshjet me FMN-në, sepse nuk do të ishte barrë e buxhetit. Pra do të ishte një fond i cili është ekskluzivisht i përdorur për pensione e jo një fond i cili financohet nga buxheti i shtetit si një zë buxhetor në të cilin pastaj Qeveria vendos nëse do t'i gjuajë më shumë pare, apo do t'i gjuajë më shumë në asfalt dhe t'i marrë nga pensionet. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk dëgjova për cilin amendament. Në fund teori kemi të gjithë, gjithë kemi mendime, gjithë kemi mësuar edhe në libra edhe kemi praktikën tonë.

Mirë është të ndaleni, a jeni për variantin “a” ose “b”? Në qoftë se bëhet kjo është më mirë. Zoti Ardian Gjini e ka kërkuar replikë në fjalën tënde.

ARDIAN GJINI: Po më vjen keq prej Kuvendit ta zgjat kështu, por prapë unë i them goxha qartë çështjet kur flas për këto se tentoj t'i them qartë edhe nuk i pësjtjell hiç.

Ajo çka po thotë Visari është: mos ju jepni pensionet prej buxhetit, por merrni të punësuarve edhe punëdhënësve edhe krijoni fondin, por merrni dy herë, kështu po thotë. Unë e di që politikat që i prezanton zoti Ymeri janë goxha shumë biznes-friendly ta them një fjalë në anglisht, nuk kam dyshim në atë punë, por ne i kemi pak më ndryshe. Nuk mund t'ju marrësh punëdhënësve edhe të punësuarve dy herë për të njëjtën temë edhe të thuash që po i stimuloj bizneset. Nuk mund ashtu.

Buxheti i Kosovës duhet të paguajë derisa të përmbillet cikli që e kemi për Trust, kurrkush nuk paguan dy herë, Visar, kurrkund në botë, nuk paguhet dy herë për një vi.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë zoti Ymeri. Këta janë paraqitur edhe disa, por ata që kanë folur s'e marrin fjalën. Po kanë drejtë në këtë, unë çka kam të bej.

VISAR YMERY: Shumë shkurt kryesues se po më duket është kah iu humb durimi deputetëve.

Veç një pyetje e kisha shtruar për këta që po thonë që nuk bën t'ju marrim dy herë, ne a i marrim paret prej buxhetit edhe buxheti prej nga financohet, a financohet prej tatimeve? Po. Domethënë na po ua marrim po ashtu qytetarëve, sepse buxheti nuk financohet prej dika tjetër, prej tatimeve.

Pra, a paguan ti tatim a kontribut, për qytetarin është njëjtë, është pagesë të cilën e jep për një brez i cili ka kontribuar më herët. Është shumë e qartë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi studiuar specifikat demografike në vend dhe gjithë kjo materie që iu ka ofruar Kuvendit është një nga formulimet nga më të avancuarat dhe nga më të pranuarat, kështu që lus seancën që ta kalojë dhe ta votojë, sepse nuk mund të merret asnjë shembull tjetër më specifik dhe asnjë formulim më praktik se sa që neve kemi ofruar me këtë ligj.

Kështu që jo rastësisht dhe më befasoi konstatimi i zotit Topalli kur tha që ky është ligji më i mirë i PDK-së që ka ofruar. Në fakt, kemi ofruar edhe ligje tjera më të mira, por për momentin ose ka qenë xhelozia ose i ka munguar koncentrimi dhe analiza e tij për të vlerësuar kështu siç vlerësoi tani.

KRYESUESI: Halit ti bëre njëfarë, e përmende emrin tash e bajsh me shëndet po për cilin variant je o burrë, cilin ta votojmë, "a", ose "b-në", për cilin je?

Jepja Halitit edhe njëherë fjalën. Pra s'po sqaroni çka po doni të votoni vetëm po tregoni që dini. Zoti Topalli e ke fjalën për replikë.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Jo, desha veç të shtoj që përveç këtij Ligjit për pensione ka edhe ligje tjera që sipas pikëpamjes së PDK-së janë shumë të mira, për shembull Tribunali, Ligji për EULEX-in edhe një varg ligjesh tjera.

KRYESUESI: U krye debati edhe ju lus, unë e kam për detyrë t'ua jap fjalën deputetëve sipas Rregullores. Jo kurrkujt s'ia mora.

Kush s'ka qenë në temë ia marr fjalën. Për FMN-në nuk kemi qenë duke diskutuar.

Në rregull, në rregull është. Votojmë amendamentin e 6, me elektronikë: nën "a" propozimin e Komisionit FunkSIONal, votojmë tani.

Në sallë janë 78 deputetë. 36 vota kundër, 2 abstenime, 33 për. Nuk miratohet varianti "a".

Votojmë variantin "b". Votojmë tani. 48 vota për, 16 kundër, 4 abstenime, miratohet varianti "b" i Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

Amendamenti 7, është paraqitur nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

E keni fjalën, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar i Kuvendit dhe drejtues i seancës, Kolegë deputetë,

Tash jemi te një amendament 7, në të vërtetë ka dy amendamente që lidhen me nenin 8. Një amendament është i Komisionit për Buxhet me përkrahje të komisionit funksional, një është i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahje- thotë të këtyre komisioneve.

Çështja është unë dua ta bëj të qartë këtë herë edhe për opinionin e interesuar edhe për deputetët, t'i përkujtoj që ky ligj është kthyer pikërisht për këtë problem, në lexim të dytë. Le të dihet, le të dihet historia se nganjëherë të gjithë s'e kanë kujtesën e fortë, shënime s'po mbajnë e po i harrojnë.

Ky ligj është kthyer për këtë çështje dhe kjo çështje nuk rregullohet as me amendamentin e Komisionit për Buxhet, në njëfarë mënyre tentohet të rregullohet me variantin B të Komisionit për Integritet Evropian, po as ky nuk e rregullon.

I pari e heton, po thotë: duhet të ndërtohet me ligj tjetër dhe ky ligj është kthyer pikërisht për këtë ide, i dyti e ka një formulim që i ka dy paragrafë, i 6-ti i ofrohet problemit, po formulimin e ka të papranueshëm, ndërsa i 7-ti është procedural.

Prandaj, zoti kryesues dhe kolegë e kolege dhe opinion i interesuar, çështja ka të bëjë e thjeshtë e qartë, t'u pranohet stazhi i punës dhe të konsiderohen pensionistë kontribut-

dhënës të gjithë ata që në vitet '90 e kanë mbajtur gjallë arsimin e Kosovës, shëndetësinë dhe veprimtarinë e tjera.

Unë e di që ka njerëz që nuk i njohin mirë vitet '90 si ... ose kanë qenë shumë të rinj, se kanë qenë të rinj edhe i kanë përjetuar në mënyrë tjetër si nxënës, të tjerë kanë që kanë punuar, po unë kam para meje një zonjë, Flora Brovinën që bile është dëshmitare e punës së vështirë në lëmin ku ajo ka punuar me burrnoret e veta të famshme të shëndetësisë.

Pra, unë propozoj që kjo çështje të thjeshtësohet dhe të votohet një amendament i cili thotë thjeshtë, shkurt e shqip: "Me këtë ligj u njihet stazhi i punës i pensionit kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë e tjerë që kanë punuar në sistemin ose në institucionet e Republikës së Kosovës".

Kjo nuk paragjykon as masa, as veprime nënligjore se ato janë punë që bëhen dhe çështja bëhet e qartë. Unë mendoj që nuk ka logjikë përtej kësaj. Për këtë qëllim unë kam biseduar me përfaqësuesin e Komisionit Funkcional, Fikrim Damka, kam biseduar me shefin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Gjini, kam biseduar me dy përfaqësues të lëvizjes "Vetëvendosje" dhe amendamenti im, unë e kam formuluar, pra është amendamenti im paraqitet edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Unë po i thërras, kam biseduar, më falni edhe me kryetaren e Grupit të Aleancës për Kosovën e Re. Pra, i thërras edhe PDK-në dhe grupe të tjera që të votohet, sepse ky është i saktë ajo që kërkohet dhe është më së paku që t'u pranohet atyre njerëzve që i kanë mbajtur sistemet më të mëdha të jetës sociale edhe kulturore besa edhe nacionale në vitet '90. Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

KRYESUESI: Faleminderit! Është propozim, do të thosha, jashtë procedural, domethënë nuk i plotëson kushtet sipas Rregullores. Unë jam qind për qind dakord me propozimin e zotit Hamiti, sepse është i mirë është në interes të ligjit.

Por, meqenëse koha për t'u paraqitur është e përcaktuar me Rregullore, unë kërkoj që vërtet ta mbështesim, por ta bëjmë me rregulla shmangien nga procedura për ta pranuar si amendament të tretë nën "c" propozimin e profesor Hamitit.

Pra, është në rregull atëherë mund të diskutoni, por unë mendoj që është propozim i mbështetur nga grupi parlamentar, është mbështetur edhe dhe është diskutuar dhe unë mendoj që është i arsyeshëm si propozim.

Keni të drejtë për të diskutuar për propozimin. Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Kamera do të më kapte edhe nga ai vetë aty, nuk e bëra për vëmendjen tuaj, por këtë prezantim dhe këtë arsyetim që po paraqes tani po e bëj për opinionin.

Neve këtë çështje në grupin parlamentar e kemi trajtuar me kryeministrin dhe jashtëzakonisht me përgjegjësi është shtruar dhe me ndjenja është arsyetuar nga shumë deputetë, sepse është një materie shumë e rëndësishme edhe është periudhë jashtëzakonisht e vlerësuar që ka qenë e trajtuar deri tani jo në mënyrë të merituar.

Nuk ka qenë në fokusin tonë deri kur ka ardhur ky projektligj dhe kryeministri madje ka propozuar një ligj të veçantë për këtë materie, por tani doni t'i anashkalojmë procedurat, neve e pranojmë, e përkrahim dhe e mbështesim propozimin e zotit Hamiti, sepse është edhe vullneti ynë, është edhe diçka që neve e kemi trajtuar, por kemi dashur këtë materie, këtë fushë ta mbulojmë me një ligj të veçantë. Ky ka qenë ide e kryeministrit, por tani ne i anashkalojmë procedurat dhe e mbështesim kështu përzemërsisht dhe madje, madje e deklarojmë se është vullneti i grupit tonë parlamentar ky që e ka përkufizuar kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë s'mund t'ua marr fjalën, zoti Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Shumë shkurt, pa shumë fjalë është e vërtetë që kemi biseduar me zotin Hamiti dhe edhe e mbështesim këtë amendament dhe e mbështesim shmangien në mënyrë që amendamenti si u formulua të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë jam e obliguar ta paraqes rekomandimin që është marrë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rekomanduar që të mos përkrahet amendamenti i Komisionit për Integritet Evropian për arsye se parashihet që me akt nënligjor të përcaktohen kushtet dhe kriteret për pension kontribut- pagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur tepërc teknologjike pa bazë ligjore në periudhën e vitit '89- '99.

Duke pasur parasysh faktin se iu njihet e drejta në pension kontribut- pagues të gjitha kategorive të larguara me dhunë nga puna, është propozuar që me ligj të veçantë të përcaktohen kriteret dhe kushtet, të identifikohen dhe verifikohet numri i përfituesve dhe në këtë formë të arrihet të bëhet një përlllogaritje e saktë e kostos buxhetore në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm. Ky ka qenë rekomandimi i Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, me propozim të zotit Hamiti dhe Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoj që me një votim elektronik, kërkojmë 2/3 e atyre që janë prezent për shmangie, të votohet propozimi që të futet edhe një amendament i ri nën "c" i cili realisht u diskutua edhe më parë edhe për të cilin votojmë tani.

Në sallë janë 76 deputetë, pra duhet të votohet me 2/3 për të kaluar në Parlament. Votojmë tani.

Faleminderit! Miratohet propozimi. Me 66 vota për, 3 kundër, asnjë abstenim.

Kemi tre amendamente, do të thotë kemi amendamentin e 7, kemi tri propozime: nën “a” është... jo unë nuk mund t’i kaloj , pa i votuar këta, ju votoni kundër nëse doni. Është procedurë.

Nën “a” votojmë tani. Nuk kalon. Propozimi nën “b” i Komisionit për Integritet, votojmë tani. Nuk kalon. Propozimi nën “c” i zotit Hamiti i mbështetur nga Grupi Parlamentar i LDK-së, votojmë tani edhe grupet tjera.

Me 66 vota për, 2 abstenime, asnjë kundër, miratohet amendamenti numër 7, varianti “c” i zotit Hamiti. Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën lidhur me...

SABRI HAMITI: Unë vetëm i falënderoj të gjithë deputetët, të gjitha grupeve parlamentare që kanë bërë një vlerësim i cili është përtej një detyrimi dhe është vlerësim edhe moral edhe vlerësim nacional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim s’ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim s’ka. Miratohet.

Amendamenti 10. Komisioni funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë me elektronikë apo ka dikush diçka të thotë. S’është paraqitur askush. Votojmë me elektronikë amendamentin e 10, votojmë tani.

Me 53 vota për, 7 vota kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti i 10.

Amendamenti 11. komisioni funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Zonja Hadërgjonaj e ka kërkuar fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Më duhet ta shpjegoj edhe një gjë, unë e dhashë në fillim arsyetimin që neni 1, e votuat rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe derisa e keni miratuar nenin 1, rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, duhet ta votoni edhe amendamentin 10, amendamentin 11 dhe amendamentin 12 të Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse ndërlidhen me amendamentin 1, që është miratuar këtu, përkundër nëse nuk votohen në harmoni këto të katër amendamente ata bien në kundërshtim njëri me tjetrin.

Po më vjen keq që nuk po i shikojnë amendamentet, ndoshta po bëhet edhe keqkuptim mandej në votim.

KRYESUESI: Amendamenti i parë nuk është miratuar. S'ka pasur kuorum në vendimmarrje dhe... Nëse duan ta kthejnë për së dyti në votim, në rregull. Por, unë nuk ...

Edhe është dashur për t'u paraqitur te amendamenti i 10-të dhe jo te i 11-ti, përcille se... Vazhdo, zonja Hadërgjonaj nëse ke diçka.

SAFETE HADRËGJONAJ: Nëse nuk është votuar amendamenti 1, që nuk pat kuorum për ta votuar, atëherë mbetet sikur në projektligj dhe prapë këta amendamenti 10 dhe amendamenti 11 dhe amendamenti 12 bien në kundërshtim edhe me ligjin që mbeti tash sikur në ligj, meqenëse nuk është miratuar amendamenti 1.

KRYESUESI: Unë vetëm me mocion e kthej mbas. Amendamenti 10 u votua, në qoftë se doni ta ktheni edhe njëherë ta votoni, njëshin në fakt, ne mund ta kthejmë, por për këtë duhet të votojmë.

Amendamenti 11, Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë tani. Mbetet sikur në ligj.

Amendamenti 12, Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë tani. Edhe ky amendament mbetet siç ka qenë në projektligj.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 14, Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa. Zoti Gashi e ka kërkuar fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Këto amendamente lidhen me njëri- tjetrin dhe tash veç po vjen duke u rumbullakësuar, sepse amendamentit të 4-të ia njohëm të drejtën, amendamenti 6 thamë që rregullohet me akt nënligjor dhe tashmë amendamentin 14 po themi që kushdo që ka dhënë kontribut pensional e gëzon këtë të drejtë, pastaj rregullohet me akt nënligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

A me elektronikë? Më falni, pra! Prapë kthehemi te amendamenti 14. Më falni, se u desh ta votojmë me elektronikë.

Komisioni për Legjislacion pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë tani! Mbetet si në projektligj.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

S'po votojnë o burrë, çka të bëj. Tash, me zor s'mund t'i detyroj të me votojnë.

Amendamenti 14, po e votojmë edhe njëherë pra, pasi që po kërkon të gjithë ta përsërisim, i Komisionit për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe Komisionit për Buxhet dhe financa. Votojmë tani! Nuk kalon.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 21, Komisioni Funkcional, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Zonja Bajrami e ka kërkuar fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Kryesues,

Unë e kam vetëm një pyetje, kështu për procedurë. Të lutem shumë, kur po votojmë me elektronikë nuk po kalojnë amendamentet, kur s'po votojmë me elektronikë, po thonë që po kalojnë. Ne s'po kemi kuorum. Unë këtë nuk e kam të qartë, qysh po e dini që po kalojnë?

KRYESUESI: Faleminderit! Ne kemi kuorum në sallë, po nuk po duan të votojnë me elektronikë. Janë qëndrime politike të grupeve të deputetëve dhe unë nuk mund t'ua ndryshoj.

Ne po vazhdojmë me elektronikë. 79 deputetë janë në sallë. Votojmë amendamentin e 21-të. Unë po pyes kush është kundër, sepse është një amendament, që s'ka alternativa tjera. A ka kundër? S'ka. Edhe abstenim s'po ka dhe unë po i kaloj. Është për interes të shpejtësisë, sepse nëse ndalemi ne në secilin amendament ta diskutojmë, nuk e di kur e shpërndajmë Parlamentin pastaj.

Amendamenti 21, Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë tani. Nuk kalon.

Amendamenti 22, Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Votojmë tani. 52 vota për, 5 abstenime, 4 vota kundër, miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani. Konstatohet se me 68 vota për, 9 vota kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës:

12. Emërtimi i një anëtarë në Bordin drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhje dhe emërim të një anëtarë të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur listën e kandidatëve për votim, si në vijim:

1. Lekë Zherka,
2. Ardi Shita dhe
3. Flamur Keqa.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonjën Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill të vitit 2014 ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë në Bordin drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe ka vlerësuar se janë respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale në shpalljen e konkursit, intervistimit dhe përzgjedhjes dhe propozimin e kandidatëve për emërim nga Kuvendi.

Po ashtu, komisioni ka vlerësuar se në bazë të analizës së biografive të kandidatëve shihet se të gjithë kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore të parapara me nenin 4 të Ligjit për fondin pensional të Kosovës, kanë përvojën profesionale dhe përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve në Kosovë, që është kushti kryesor në këtë rast dhe i plotësojnë kushtet tjera formalo-juridike të pranuar me nenin 4 të Ligjit për fondin pensional të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit emërimin e njërit prej anëtarëve në Bordin drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës me mandat trevjeçar.

Gjithashtu, kandidatët e propozuar nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të qenë anëtarë të Bordit, drejtues të Fondit, siç përcaktohet me nenin 4.12 dhe 4.13 të Ligjit për fondet pensionale, gjë që është konfirmuar edhe nga Komisioni për Përzgjedhje në bazë të testit i përshtatshëm dhe i duhur, që i është bërë kandidatëve.

Meqenëse, kandidatët e propozuar nga komisioni përzgjedhës për emërimin e Bordit drejtues të fondit të kursimeve pensionale i plotësojnë kushtet formalo- juridike të parapara me nenin 4 të Ligjit për fondet pensionale, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit miratimin e propozimit të Komisionit për Përzgjedhje për emërimin e një anëtari në Bordin drejtues të fondit të kursimeve pensionale të Kosovës, me mandat trevjeçar, siç e përcakton ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se në pajtim me nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Kuvendi duhet të zgjedhë një anëtar me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe të votojë me votim të fshehtë, si në vijim.

Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri kandidat nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, kandidati me më së paku vota hiqet nga lista dhe Kuvendi voton prapë në rundin tjetër për dy kandidatët e mbetur.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

I ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komisionin votues. Zoti Reçica, kë e keni në emër të grupit parlamentar?

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon deputeten Blerta Deliu-Kodra.

KRYESUESI: Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Zoti Beqiri kënd e propozoni për komision?

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar! Ne propozojmë deputetin Salih Morina.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Morina. “Vetëvendosje”, zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Unë e propozoj deputeten Albana Gashi.

KRYESUESI: Zonja Gashi. AAK-ja, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Deputetja Teuta Haxhiu propozohet për anëtar të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Teuta Haxhiu. Koalicioni për Kosovë të Re?

SUZAN NOVOBËRDALI: Nënkyetar, jemi marrë vesh që unë të jem anëtare e Komisionit votues.

KRYESUESI: SLS-ja, s'është. "6+"-i? Nuk është. Ku kanë shkuar këta? Atëherë, këta që janë zgjedhur...

(Ndërprerje e incizimit.)

I ftoj deputetët, sepse kemi ta bëjmë një votim formal për ta miratuar komisionin. Nuk i kemi edhe dhjetë deputetë. Ku janë deputetët?

Atëherë, unë propozoj 10 minuta pauzë, derisa të bëhen gati dhe të kthehen deputetët në sallë.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, në orën 15 kthehemi në sallë, s'ka kuorum, nuk mund të votojmë, s'mund t'ia fillojmë.

(Ndërhyrje)

Po zilja po bie, nuk janë. Sa veta janë në sallë?

(Ndërhyrje)

S'mund të filloj pa kuorum.

Në rregull! Lus komisionin që të zënë vendin, pasi po thoni që janë këtu deputetët dhe votojmë.

Më falni, por në qoftë se nuk janë 61 deputetë në sallë, ne s'mund ta votojmë komisionin.

(Ndërhyrje)

Duhet të jenë 61 deputetë, që të votohet. Për prezencë, ne jemi duke i numëruar, por s'i kemi.

(Ndërprerje)

(Mbledhjen e drejton, kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Në sallë kemi 63 deputetë, na duhet një votim formal për komisionin.

Kush është për? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka.

Abstenim s'ka.

Pra, miratohet komisioni dhe e vazhdon punën.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: E ftoj zotin Jakup Krasniqi, të votojë i pari si kryetar i Kuvendit!

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Nait Hasani, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Ismet Beqiri, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Dëshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Jasmina Zhivkovic, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Shaip Muja, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Serbica Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Haljilji, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Millosavljeviq, Petar Miletic, Rada Trajkovic, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanovic, Sevdije Lama, Skender Hyseni, Boban Todorovic, Sreten Ivanovic, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqu, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti dhe Xhavit Haliti.

Komisioni do të fillojë të bëjë numërimin e votave.

BLERTA DELIU - KODRA: Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, e pavlefshme, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Flamur Keqa, e pavlefshme, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, E pavlefshme, Flamur Keqa, e pavlefshme, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, E pavlefshme, e pavlefshme, Lekë Zherka, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Ardi Shita, Ardi Shita, e pavlefshme, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Lekë Zherka, e pavlefshme, E pavlefshme, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Ardi Shita, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Lekë Zherka...

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit votues që të na sqarojë lidhur me rezultatin.

BLERTA DELIU- KODRA: Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit numër 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar

me vendim të Kuvendit, më 6 maj 2014, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 6 maj 2014, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 68 deputetë. Të pavlefshme janë 15 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Lekë Zherka i ka fituar 19 vota;
- Ardi Shita i ka fituar 3 vota;
- Flamur Keqa i ka fituar 31 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit numër 04-L/101 për fondet pensionale të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar vota të nevojshme.

Votimi përsëritet me kandidatët që kanë fituar më së shumti vota. Janë 2 kandidatë.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, lus Administratën që t' i përgatisë fletëvotimet dhe të përsërisim edhe një herë votimin.

(Ndërhyrje)

Ata që janë le të votojnë. Po mirë, s'mund t' i bëj unë tash 90, por ata që janë votojnë e ata që s'janë s'votojnë. S'mund ta ndërprejmë votimin në gjysmë. Ne kemi votuar komisionin, konstatojmë, kush fiton - fiton, kush s'fiton - s'fiton.

(Ndërprerje)

Në rregull, atëherë e lëmë votimi të mbahet në orën 15, marrim pauzë meqenëse Grupi Parlamentar i PDK-së paska mbledhje. Me siguri është edhe koha e drekës dhe po e lëmë për pasdite.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Vazhdojmë me votimin e dytë. Lus komisionin që ta zërë vendin e vet, përkatësisht anëtarët e komisionit. Fillojmë me votimin:

Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat

Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkovic, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shiniq, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Milosavleviq, Petar Miletiq, Rada Trajkovic, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanovic, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todorovic, Sreten Ivanovic, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq...

Të nderuar kolegë, ju kisha lutur që t'i zini vendet. E kemi një delegacion të Arabisë Saudite që do të ulet sipër, duhet t'ua bëjmë një përshëndetje. T'i përshëndetim me duartrokitje, apo si të doni ju.

...Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqi, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti dhe Xhavit Haliti.

Ju lus t'i zini vendet! Më lejoni që në emrin tuaj, të nderuar deputetë, dhe të Parlamentit, në përgjithësi, ta përshëndes Grupin e Miqësisë ndërmjet dy parlamenteve, Parlamentit të Arabisë Saudite dhe të Kosovës, që ka ardhur në një vizitë miqësore. Dihet mbështetja që Arabia Saudite ia ka bërë Kosovës dhe në emrin tuaj dua ta përshëndes pjesëmarrjen e tyre në sallë. Faleminderit!

Gjithashtu ju kërkohet ndjesë se jemi në procesin e votimit dhe nuk do ta dëgjoni ndonjë debat të veçantë. Vazhdoni, komisioni!

Fjalën e ka komisioni për të bërë numërimin publik.

BLERTA DELIU-KODRA: Flamur Keq, Lekë Zherka, Flamur Keq, Lekë Zherka, Flamur Keq, Lekë Zherka, e pavlefshme, Lekë Zherka, Lekë Zherka, e pavlefshme, Flamur Keq, Flamur Keq, e pavlefshme, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keq, e pavlefshme, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Lekë Zherka, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, e pavlefshme, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Lekë Zherka, Flamur Keq, Lekë Zherka, Flamur Keq, Flamur Keq, e pavlefshme, Flamur Keq, e pavlefshme, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Flamur Keq, Lekë Zherka, e pavlefshme, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keq, Flamur Keq, e

pavlefshme, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, Flamur Keqa, e pavlefshme, Flamur Keqa, Lekë Zherka, e pavlefshme, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Lekë Zherka, e pavlefshme, Flamur Keqa, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Lekë Zherka, Flamur Keqa, Flamur Keqa.

KRYESUESI: Zonja kryetare, e keni fjalën që ta shpallni rezultatin.

BLERTA DELIU-KODRA: Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 6 maj 2014, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në rundin e dytë në mbledhjen plenare, të mbajtur më 6 maj 2014, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 84 deputetë, të pavlefshme janë 12 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

Lekë Zherka i ka fituar gjithsej 22 vota, kurse Flamur Keqa i ka fituar gjithsej 50 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Flamur Keqa emërohet anëtar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë zotit Keqa i urojmë punë të mbarë.

Dhe, vazhdojmë me pikën katërmëdhjetë të rendit të ditës:

14. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Në sallë janë 55 deputetë. Bjerini ziles, thirrini deputetët në sallë!

I kemi edhe dy pika të rendit të ditës që i kemi lënë, dy pika që na i ka shtyrë dje Ademi.

Zoti Grabovci, a ke të thuash diçka për dy pikat e rendit të ditës?

Mirë! Atëherë e përfundojmë seancën, meqenëse pikat e rendit të ditës që kanë qenë të planifikuara nuk janë të gatshme. Kryesia e thërret mbledhjen e ardhshme. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*